

Shënimet e një gruaz

ROMAN



**TEODOR
KEKO**

Shënimet e një gruaje

– *Ia kushtoj zonjes Xhuljeta Shkurti (Keko)*

*'Dhe mos kujtoni se ky zakon ka sjellë
njëmijë të zeza vetëm në Olinth dhe jo gjetiu!'*

(‘Filipiku i tretë’ i Demostenit)

Do të ishte pa dyshim mrekulli e magji bashkë, po të mos e fiksoja këtë fjali të oratorit të lashtë në leximin gjysmë përgjumësh të pasmesnatës. Mirëpo sytë atje u ndalën, në atë rresht të strukur diku mes faqesh dyzetradhëshe dhe unë mbeta sakaq vetëm me natën, me natën e ftohtë e të zezë, të mbushur me dialogje fshesaresh e lehurina qensh. Pastaj ia nisi një shi i shtruar, nga ai që lakmojnë bujqit, dhe gjumi u mërgua përfundimisht prej meje. Tani që zhurmërinë e njëtrajtshme të shiut nuk e ndërprisin dialogjet e fshesareve dhe lehurinat e qenve të strukur nëpër strehë, ishte e pamundur të vazhdoja të hamendësoja në ishin të dehura ato gra të vrazhda e me zë të çjerrë nga duhani, ankintare ndaj drejtorit të luajtur mendsh, që u kërkonte libreza mjekësore, e se cilës racë i përkisnin lehësit e palodhur. Ashtu, në bosh, u mora një hop me shimatësit dhe sinoptikësit. Kot më shkoi mendja te kryespecialisti i sinopistikës dhe mendova në flinte apo jo në këto çaste historike për të, po të marrim parasysh se në Tiranë binte shi pas dhjetë muajve, mirëpo nuk shpëtoja dot, e as e zotëroja dot veten. Ligjërata e Demostenit mbi shkatërrimin e Olinthit prej shpifarakëve të Filipikut po më gërryente plotësisht dhe unë e ndjeva se ai shkatërrim i qetë dhe gjakftohtë nuk mund të largohej diçka, pa i matur, të paktën, hollësisht dimensionet e katrahurës.

Atë çast m'u duk se lëvizi dhoma, pata përshtypjen e rënies së tërmetit dhe brofa ndenjur në shtrat. Mirëpo nuk ndihej as rënkim i mbytur i tokës, as zhurmë qelqurinash e as abazhuri i madh nuk vej e vinte majtas e djathtas. Qën-

droja gjithmonë ndenjur, me duar të lëshuara në prehër, me ato parandjenja të hirta e melankolike që po më gërryenin pak nga pak ditë e natë e natë e ditë, si krimbi i duruar dërrasat e parketit. Nga një melankoli e tillë pati vuajtur edhe Bruti 2000 e ca vjet të lëna pas dhe unë mbeta një kohë e shtangur nga kjo vetëtijë e mendimit. O botë hyjnore, belbëzova nëpër dhëmbë, a ke ndryshuar ndopak këto 2000 vjet?

Figura ime e zbehtë, e reflektuar në pasqyrën përballë, e stérhequr nga trishtimi, u valëvit diçka majtas-djathtas. O botë...

M'u kujtua frika e Nausikës nga thashethemet tek capitej pas asaj qerreje bashkë me Uliksin, shpifarakët e Demostenit, 23 plagët e Cezarit dhe Jagua, pastaj Ana ime dhe, si përsërita rishtaz gjysmë e letuar 'O botë hyjnore, a ke ndryshuar ndopak këto 3000 vjet?', nuk pata më as më të voglën dëshirë pér t'iu përgjigjur vetes.

I sëmuri duhet lavdëruar kur arrin të pyesë hapur vreten!

Koha e shkuar

- Dava prostitute! - u hodha e thashë me të më kapur veshi emrin e Ana Likës.

Ka qenë korrik i '85-ës. Unë sapo isha kthyer nga aksioni në Lukovë, ku u poqëm si në saç nëpër atë vapë përcëlluese, dhe tani më duket jo çudi, se çudi s'ka, por budallallëku im më i madh shqiptimi i kësaj fraze, që s'dua as ta nëpërmend më. Nëna ime i ka urryer gjithmonë fjalët e ndyra, duket ajo ruante me fanatizëm kredon 'një gjë që thuhet edhe bëhet' dhe, merret vesh, ku e shpinte kjo logjikë e thjeshtë. Dikur ajo e rrahu aq shumë vëllain tim, sa i la blana në krahë e kofshë, vetëm se i pata kallzuar se ai kishte përdorur fjalë të ndyra kur po luante me shokët në oborr. Ishim fare kalamaj në atë kohë dhe mua m'u shkrep ta gënjeja nënën duke i shpifur për vëllain thjesht e cytur nga xhelozia sepse ai nuk më përfillte fare në oborr mua. Vëllai është me karakter dhe hakmarrës. Ti do bëheshe shitës shembullor, i thoshte babai, se nuk le njeri pa ia dhënë kusurin deri më një. Të nesërmen e shpifjes, me të ikur prindërit në punë, shitësi shembullor më bëri një zgjim original nga gjumi. Më vdiq në dru, aq sa ulërimat e mia rrezik janë dëgjuar deri në mal të Dajtit e do të kenë trembur çobanët e shkretë! Edhe shenjën në vetull kujtim nga ajo e rrahur e kam. Dhe nuk u ngop vetëm me aq, por më kërcënoi se do më fuste brenda në kazanin e lavatriçës dhe do ta ndizte pastaj atë, po të mos i thoshja nënës se një ditë më parë kisha shpifur e se ai nuk pati nxjerrë kurrë nga goja asi fjalësh. Unë, e mbaruar nga frika, me një sy në mes të ballit si Polifem e tjeterin te mjekra, jo vetëm e

zbatova urdhrin, por e çova autokritikën në skajshmëri, kur dënesa e lëpiva lotët me gjuhë, duke thënë rrokjendarazi:

- Ai nuk ka folur fjalë të pista, edhe sepse ka një javë që nuk flet dot, ngaqë ka kafshuar gjuhën! ... Po unë nuk dëgjoj shumë mirë nga veshët. Fjalën 'urime', për shembull, e dëgjoj 'urinë'; fjalën 'mur' e dëgjoj ashtu ...

- Ashtu? - briti nëna, e tmerruar plotësisht nga portreti im i shkalafitur dhe këtë herë iu vërsul vëllait duke rrëmbyer një varëse këmishësh, për fat, plastmasi. Ajo e kishte bindje se unë gënjeja pikërisht tanë, nga frika mos im vëlla më rrihte përsëri me të ikur prindërit në punë. Atëherë, duke dëgjuar zhurmën e goditjeve në trup të vëllait dhe heshtjen heroike të tij, kuptova se shpifja qenka e keqe mbi të këqia, ajo i ngatërroka keq gjërat: njeriut që nuk kryente ligësira, iu ngjit nofka 'rrugaç', kurse shpifëses i mbeti për medalje ndershmëria! Dhe që atëherë diçka më tërhiqtë gjuhën përbrenda mos dërdëllisja kot.

Megjithatë, atë fillim korriku arrita dhe e shqiptova tof-jalëshin 'dava ...'. Merita, kushërima ime e dytë, mbetet unikale për lëvrimin e bisedave me këto karaktere e tema. Ajo, historikisht, ka përgojuar e do të përgojojë gjysmën e Tiranës dhe është tepër e vështirë (tepër e vështirë, për mos dashur të dukem kategorike, ëë!) të gjendet në kryeqytet një femër apo një mashkull me sado pak reputacion, që ajo mos ta ketë pranguar në gojën e saj me ndonjë histori banale. Unë e di si buka që ha se një dentiste braktisi në mënyrë demonstrative bashkë me të fejuarin mbrëmjen e madhe të Vtit të Ri te hotel 'Tirana', ku pati siguruar një tavolinë qendrore pas përpjekjesh heroike, vetëm se dalloj me të hyrë në sallën e madhe Meritën të ulur në një nga tryezat e fundit. 'Edhe ajo më duhej, tha më pas ajo bukuroshe e brishtë, të hyja në gojën e Meritës! Unë mezi shpëtova nga llafet kur u fejova, t'i ndizja prapë me dashje... Zot na ruaj!'

Kështu ndodhi, sepse Merita kjo qe! Mirëpo mallkuar goftë harresa dhe tangërlëku, që unë vajta e u tregova idiote atë ditë të mallkuar vere, kur desha t'i dëshmoja se

dija diçka, nuk haja bar, pra, dhe thashë ashtu serbes fare për Ana Likën 'dava ...' ashtu, se s'dua t'iа përmend fjalën.

- Vërtet, më qafsh, prosti është? - ulëriu duke kërcyer syshkëlqyer si ndonjë marsiane nga karrigia e kashtës ku qëndronte e ulur këmbë mbi këmbë.

Më erdhi mu në hundë. Ia ndjeva erën e rëndë të gojës me dhëmbë që i lante vetëm kur kishte festa familjare me përvjetor të plotë, dhe pohova me kokë e lumtur që ajo llapaqene kishte ende ç'të mësonte, prandaj nuk ia vlente kësisoj të mbahej si zonjë aq e rëndë.

Historikisht jam tallur me Meritën, kur kam pretenduar seriozisht se ia kam parë me sytë e mi e ia kam prekur me duart e mia skedarin, ku ajo mbante skeda të rregullta thashethemesh për çdo qytetar të vlerësueshëm të Republikës. Por kjo paskësh qenë krejt e vërtetë, sepse vitin e kaluar, kur atë e ndau i fejuari, shkak u bë pikërisht burimi i pashtershëm i thashethemeve që Merita ruante në skedarët, duket të pafundëm. Ajo arriti ta futë në sherr e bela atë djalë zotni me gjysmën e punonjësve të klinikës ku ai punonte dhe, me ç'më ka hyrë në vesh, edhe sot e kësaj dite, kur nderin e vuri njëfarësoj në vend e u justifikua disi, ish i fejuari i Meritës vazhdon të kërkojë me ngulm transferimin në një vend pune tjetër.

Ndarja e vjetshme e tij me Meritën në gjykatën e vjetër e me suva të rëna e me punëtorë ndërtimi nëpër korridore ishte një tragjedi-komedi nga ato që ndodhin një herë në njëqind vjet, si për ta pasuruar me ngjarje historinë, në vitet e saj të qeta e pa trazira. Kuptohet, fisi im mbante anën e Meritës në ballafaqimin e drejtpërdrejtë me palën akuzuese dhe mbronte me zjarr virgjinitetin shpirtëror, mendor e fizik të saj, aq sa nëna e Meritës ulëriu me sa fuqi ruante në mushkëri:

- Ai i ka rrëmbyer pushin e virgjërisë vajzës sime! Unë dua pushin këtu!

Mirëpo dhëndri qëlloi njeri me logjikë të fortë, pa nerva, si çdo anatomo-patolog, dhe e shpartalloi gjakftohësisht sulmin tonë, kur filloi t'u tregonte sulmuesve më aktivë në

seancën gjyqësore se sa iu viente lëkura individualisht dhe farefisnisht, sipas rrëfimeve piktoreske që i kishte bërë Merita për secilin nga ne. Ai bënte zanatin e tij kur dëshmonte. Na shtriu me radhë në tryezën e tij të punës dhe na e bëri autopsinë, duke na i tundur para syve edhe zorrët e barkut. Dolën në shesh burra që kanë braktisur nënën, që ngrenë dorën ndaj grave, pijanecë me mëlçi të zmadhuar, anonimistë profesionistë, ndonjë dashuri ilegale, divorc i mbyllur në çastin e fundit e ndonjë tjeter në prag dhe im atë, i skuqur e i kërleshur nga ç'dëgjoi, kishte thënë duke ikur i pari si i marrë nga salla e gjyqit:

- E qartë, faji është i kësaj mizeries sonë!

Kështu i dorëzoi armët fisi ynë, duke ndukur thonjtë me dhëmbë e duke numëruar kokulur pllakat e sallës së gjyqit, megjithëse, për hir të së vërtetës, duhet pranuar edhe ndihma që i ofroi bujarisht atij mashkullit të shkretë gjykatësja, një nuse e re dhe e bukur me hollakërinë e saj, që i kërcyen keq kacabunjtë e s'iu ulën më, kur mori vesh në sallë të gjyqit se edhe ajo nuk pati shpëtuar pa u përgojuar nga Merita. Gjykatësja, bashkëshorte e një fytyre tepër të njobur në kryeqytet, akuzohej për ndjenja të tepërtë xhelozie ndaj të shoqit, aq sa, sipas Meritës, nga tmerri se mos i shoqi e tradhtonte me ato këngëtaret apo aktoret, me të cilat punonte, kishte arritur deri t'i binte në gjunjë e t'i përgjërohej drejtorit të estradës ta pranonte të punonte çdo mbrëmje pa pagesë si suflere në trupë.

Gjykatësja u tregua e kulturuar, kur iu drejtua me ton Meritës:

- Si nuk të vjen ndoht nga vetja?!

Ama, duke rrotulluar stilografin mekanikisht nëpër gishërinj, se si i kishte vetëtirë një dritë në sy, që tim vëllai i pati ngjarë me një thirrje të shpirtit të njeriut prehistorik për ta ngrënë me gjithë lecka e komça armikun përballë.

Im atë nuk është njeri që ecën jashtë vijave të bardha. Ka qenë gjithmonë i rregullt me rregullin si vetë rregulli dhe përgjithësisht ka qëndruar larg zonave të ndezura, që të ngrohin po t'ua nderësh duart dhe të përcëllojnë po t'i

prekësh i ndjellë prej kënaqësisë së çastit që të afrojnë. Megjithatë e megjithëkëtë karakter të tjin të lexueshëm, nëna ime ia qepë sytë ca kohë me dyshim dhe i shfrynte brinjas duke i përplasur në kalim dyert:

- Pse kërceve përpjetë e krise e ike atje në gjyq, apo u trembe mos nxirrte ai dhëndri ndonjë xhevahir edhe përtyn, që ne nuk ta dimë akoma? Se, ruajna zot, ç'nuk po na dëgjojnë veshët!...

Unë kisha harruar shumë. E pata nënvliftësuar Meritën.

2

Kështu, pra, nisi lidhja ime e drejtpërdrejtë me Ana Likën. Në të vërtetë urat u hodhën pak më herët, pavarësisht se si portret unë do ta njihja shumë më vonë atë. Ana e kishte mbaruar fakultetin atë vit që unë fillova studimet, kështu që nuk arrita ta shoh ndonjëherë figurën e saj në mjediset studentore. Flitej se ishte femër tronditëse, bile, nja dy vjet në anketat gojore të plazhistëve të Durrësit që shpallur 'mis plazhi'. Të gjitha këto hollësi i mora vesh pak muaj para bisedës me Meritën. Se si u përmend në kursin tim gjatë një pushimi emri i Ana Likës dhe nja dy vajza u hodhën dhe e quajtën 'prostitutë'. E quajtën kështu sepse kjo Ana kishte qenë e fejuar njëherë me një goxha mashkull dhe pastaj, për habinë e të gjithëve, e pati braktisur shpërfillurazi vetë, sepse, qe hedhur në auditor një nga vajzat, dalloi mospërputhje seksuale me ish të fejuarin. Pastaj biseda mori ngjyra piktoreske dhe një veshje të pistë ... Që të njohësh mospërputhjen seksuale duhet të njohësh përputhjen njëherë, pat plotësuar me ton pedagogjik Eli, që na u deh ca ditë më pas me verë në ishull të Lezhës dhe për pak sa nuk iu hodh në qafë banakierit të atjeshëm ...

Ai ka lekë, o budallaçka, na jargavitej neve në tavolinë, ai është burrë, jo këta trokët, që nuk i hyjnë në punë as dreqit! ...

Ne ishim mekur së qeshuri në auditor dhe mbajtëm brinjët me dorë kur Eli pati trashur zërin mes bankave për të imituar në gjyq gjykatesin e divorcit të Anës:

- Ju, vajzë, pse dëshironi të ndaheni nga i fejuari juaj?
- Po, - hollonte në çast zërin Eli e gëlltitej njëherësh, - nuk më gudulis këtu brenda!

- Si, moj, nuk tē gudulis? - trashej zëri prapë ...
Ja, këtë histori banale i tregova atë ditë Meritës, pasi
kërceva dhe shqiptova atë fjalinë si idiote.

Historinë e harrova më vonë, dhe ishte e kuptueshme ta
harroja sakaq. Ana Likën as e njihja, as më njihte, e as
isha gjeni tē mbaja mend gjithë ç'thuhej rrugës pér tē njojur
e tē panjohur. Bile, edhe kur u njoha me Anën, as më
shkoi nëpërmend se si e pata përfolur dikur pas shpine e
ç'marrëzira kisha lejuar tē fliteshin pér tē. Jo vetëm se Lika
është një mbiemër i përhapur e se njeriu mund tē hasë një
tufë me Ana Lika, por pér faktin se thashethemi pér tē
u bë sa pér tē kaluar kohën në mënyrë tē kulturuar e
argëtueshëm. Mua ajo më qe fikur, me emër e me histori,
nga kujtesa. Kështu që, kur e takova, dorën ia dhashë pa
asnjë pendesë dhe e pashë në kokërr tē syrit pa iu druajtur
kurrfarë faji.

3

Nganjëherë mallkoj fatin tim të keq që më njoju me të, atë ditë e orë fatale. Mallkoj njojen tonë që lindi atë intimitet vrasës, atë intimitet që ka krijuar tërë botën tonë, atë që unë dikur e quaja momentin më të madh të krijimit të njeriut, të lindjes, të ekzistencës, të vdekjes. Po të eci me logjikën e asaj studentes që e mbushte bllokun me filozofime të tillë, duhet ta mbyll këtë kapitull duke kopjuar fjalë për fjalë nga blloku im i hershëm: A ka gjë më të bukur se vdekja? Unë iu dhashë asaj! ...

• Po nuk është faji im fajtori. Në gjithë atë kurs studentësh të sapodiplomuar, patjetër njërsës nga ne do t'i caktohej vendi i punës në qytetin ku punonte Ana dhe ishte krejt e pamundshme të banoje në një qytet me një nga ato fare pak bashkëpatriote të tuat e të mos afroheshe me të. Shorti më ra mua të dilja atë fundgushti përvëlues e trullosur nga zyra e dekanit, me atë shkresë në duar që pak ditë më pas do të më fuste në një kompartiment treni e do të më conte në qytetin e Anës.

Ishte një ditë me diell përvëlues, ku nuk gjeje hije të fusje kokën. Nuk njihja asnë njeri për be në këtë qytet, të përgjumur, me kuaj, si dritë e kuqe semafori, që çapiteshin në mes të rrugës kryesore ku edhe bufi e merrte vesh menjëherë se quhej herezi të bleje e të haje akullore e pashoqëruar, siç isha unë. Kisha me vete hije të trupit vetëm një telefonatë të bërë nga Tirana në adresë të shefit të kulturës të rrethit, që im atë nuk di si e peshkoi, por që qëlloi fatlume. Shefi as nuk më la t'i kërkoja të banoja në ndonjë apartament me pesë-gjashtë vajza, ku pastrimi bëhej

me grafik dhe gatimi si në konvikt. Ai duket e vlerësoi tamam atë telefonatën e uruar dhe mendoi se pas meje fshiheshin interesa miqsh të fortë, prandaj më tha fare shkoqur:

- Apartamente të qeta, për ty, këtu nuk ka, përvëc njërit. Atje aktualisht banon e vetme një ekonomiste, një Ana, Ana Lika, por ajo, qëkur u largua banuesja tjetër, nuk ka pranuar kërkend të futet në banesën e saj. Unë nuk të ndihmoj dot, - ngriti me keqardhje supet, - përpiku njëherë vetë ...

Befas më ra në kokë dhe m'i këputi gjunjët gjithë ajo vapë përvëluese shtatori në një qytet bregdetar.

- Kur nuk iu dëgjon ju, s'besoj të më pranojë, - thashë e trishtuar.

Dhe e urreva atë çast Anën! M'u duk tepër i poshtër egoizmi i saj. Ishte vërtet e neveritshmë të plasesha në një apartament dhomë e kuzhinë, ku banonin edhe pesë vajza të tjera, t'i ngushtoja ato edhe më, kurse një farë Ana Lika të rehatohet e vetme në një apartament të tillë.

Shefi më shihte me keqardhje, sikur të ma kishte hetuar gjithë atë lodhje të tmerrshme që më mbërtheu papritur.

- Unë nuk të ndihmoj dot, - tha përsëri me atë ngritje supesh, - kontrata e banesës është lëshuar me emrin e saj dhe ligjërisht ne nuk kemi të drejtë t'i futim me zor dikë tjetër brenda. Pastaj, - shtoi ai, - as ty nuk të intereson ta detyrojmë me përdhunë të ta hapë derën. Do të ishte torturë të banoje në një pëllëmbë vend me dikë që të urren, apo jo?

E kuptova se as bëhej fjalë për veprime të kësaj natyre. Pikërisht në atë kohë hyri pa trokitur në zyrë një tip i gjatë. Kushedi sa e pikëlluar dukesha në portret, se e pashë t'i bënte shefit një shenjë me kokë 'po kjo'?

- Ka dëshirë të sistemohet te Ana Lika, - i ra shkurt shefi dhe për nga reagimi i tjëtrit e kuptova se ata të dy qenë marrë vesh deri në një pa qenë nevoja t'i tirrnin gjatë shpjegimet.

I porsafuturi m'i nguli sytë sikur deshte të më peshonte

181125 A E
181125 A E
54667

sa më viente lëkura dhe unë u bezdisa nga paturpësia e tij. I kam urryer ata tipa që të vardisen pa ta dëgjuar zërin ende, ata tipa që habiten nga çdo femër, a thua s'kanë kundruar kurrë një qenie të tillë më parë. Po isha gabuar, se ai nuk ëndërronte ndërkohë. Përkundrazi. Filloj të më pyeste për gjeneralitetet e mia, për fakultetin që kisha mbaruar, për vendin e punës. Më në fund, si u mendua një hop, tha me ngadalë e me mundim:

- Po të jap unë një letër për Anën. Shko takoje. Mbase të pranon.

Mori një fije të bardhë nga tavolina përballë dhe unë e pashë mirë se ai u pendua disa herë deri kur maja e stilografit preku fijen për të shkruar germën e parë. Pas një heshtjeje të gjatë e torturuese për mua, ai e gjeti fjalën e duhur, u ndie gërvima e majës së stilografit dhe guxoi e shkruajti 'Sh. Ana ...'. E firmosi letrën me rrudhje buzësh, e pa edhe një herë nga fillimi në fund, si të deshte ta griste atë fletushkë katërqind copash, dhe ma zgjati.

- Për hajér, - tha, - po të pranoi, do t'iа kaloni mirë!
- Faleminderit, - ia ktheva.

Kështu u njoha me Anën, përmes një rekomandimi të firmosur në fund me mllef nga një i panjohur. Sot më duket se atë ditë kam filluar zanatin e varrmihësit. Ai i hap varret pa e ditur se cili do të varroset brenda tyre.

4

Në derën e lyer me bojë vaji ngjyrë bezhë dikush kishte shkruar me laps ‘Ana, po shkoj të ble bukën. Nuk vonohem. Xh.’ dhe unë trokita pa asnje ndjenjë pendese. Nuk e njihja banuesen e apartamentit dhe, duke mbajtur rekomandimin shtrënguar në dorën e majtë, m’u duk vetja si postiere. Vapa më kishte shtënë një plogështi të plotë, të mjaftueshme që mos ta vrisja mendjen në do më pranonte apo jo Ana në apartamentin e saj. Uroja vetëm që të mos hasja në ndonjë psikopate, me të cilën s’merrej dot vesh një qytet i tërë. Besoja shumë se do kisha të bëja me tipin e dytë dhe pata një ndjenjë hutimi kur m’u shfaq në derë një brune e bukur me flokët rica-rica. I thashë si me drojtje se kërkova Ana Likën dhe ajo, duke më ftuar brenda, tha pa ndonjë entuziazëm:

- Unë jam!

Kështu e mbaj mend takimin e parë me të dhe as që më shkonte nëpër mend se ajo ishte ‘dava prostituta’ e atyre mospërputhjeve banale. Ç’ditë ka qenë ajo! Asgjë nuk parashikoja dot, bile gjithçka më dilte së prapthi. Mendoja se do të dialogoja me një skizofrene, në derë më doli një bukuroshe e qetë, imagjinoja një egërsirë, më doli një indiferente, kujtoja se do të vizitoja një apartament të palyer, me ca copëra revistash të prera e të gozhduara nëpër mure si në konviktet e vajzave e me ndonjë rezistencë të shqyer reflektori të vendosur në mur bri shtratit, si luksi më i madh i banesës, dhe hyra në një shtëpi të pastër e të mobiluar normalisht. Mendoja, duke kërkuar me rekomandim në dorë atë apartament, se banuesja priste për vite të

tëra me ankth transferimin pranë shtëpisë prindërore në kryeqytet dhe preferonte të gogësintë në shtrat me ndonjë libër gjysmë sentimental te koka. Mirëpo u gabova të-rësish. Që në koridor ndihej vendimi i Anës për të hedhur rrënëjë në këtë qytet buzë detit. Linoleumi i gjelbër mbulonte dyshemenë, kurse në mur ishte montuar një portmanto e gërshtuar me bibliotekë. Pastaj kuzhina paqtore me pushtetin e ngjyrave të çelëta, me muret e lyera në gri, me bufenë e punuar me dru bredhi e të shpërndarë copa-copa në mur, me kolltuqet e rëndë të veshur me pelush bezhë, me tapetin gri dhe oxhakun e mrekullueshëm përbal-lë, të veshur me mermer të zi. M'u duk sikur gabimisht kisha hyrë në një nga ato dekoret e Kinostudios dhe vetveti u tërroqa për të hequr këpucët në korridor. E fiksova mirë gjithçka, jo si femër që e ka huq të vërë re, por si nevojtare, dhe më trishtoi ajo mirëqenie. Ma mbylli gojën, siç ia mbyll oreksin të uriturit tavolina e shtruar në mënyrë madhësh-tore. Mendova në çast se kot, fare kot trokita në këtë derë. Këtu banonte ndonjë maniak pas plaçkave, që shihet gjithë natën ëndrra me qilima, me bufera e plaçkurina dhe që nuk i dilte e keqja po t'ia shkelte njeri me këpucë tapetin. Dhe kështu kreva instinktivisht veprimin e heqjes së këpucëve.

- Ç'bën? - u habit ajo duke më mbajtur krahun.

- Po heq këpucët, - ia ktheva me ndrojtje, - pse ta bëj pis tapetin.

Kukurisi.

- Atëherë hiq edhe fustanin, se do ta kesh me pluhur ngaa këllirat e sediljeve!

Hyri para meje në kuzhinë dhe shtoi pa kthyer kokën:

- Mos i hiq! Unë për të shkelur mbi to i kam shtruar. Këtu nuk është vitrinë dyqani!

Po duket e ndjeu mëdyshjen time të vazhdueshme për të mos hyrë me këpucë në kuzhinë dhe u kthye e më tërroqi për krahun, pa m'i shqitur sytë për disa çaste. Më pyeti se nga isha dhe kur iu përgjigja 'nga Tirana', u rrudh në fytyrë. Mua nuk po më pëlqente hiç kjo vizitë dhe u bëra gati t'ia mbathja nga sytë këmbët. M'u krijua përshtypja se tek

Ana Lika duhet të përsëritheshin për javë këto vizita lutje përgjéruese dhe po më forcohej çdo çast e më tepër përsh-typja se ajo po më poshtëronte qëllimshëm me lirinë e shprehjeve e të lëvizjeve të saj.

- Shenjë e keqe që një kryeqytetase kërkon të heqë këpucët, - më tha.

- Pse? - e pyeta pa e fshehur habinë.

Qëndronim përballë njëra tjetrës dhe mua më kujtohet shumë mirë ja, kjo lëvizje e saj; u detyrua ta tërhiqtë trupin diçka prapa për të hapur duart horizontalisht pa më prekur mua.

- Shumë e thjeshtë. Rrojmë jo sipas takatit, por sipas dëshirës së opinioneve të rreme. Përdorim dy mjedise, njërin për vete e tjetrin për vizitorët. Njerëz kot fare! - përfundoi duke u rrudhur. - Si ai çifti me 20 qindarka në xhep, që i shkatërrroi me xhiro rrugët e Tiranës për të kursyer!

Pata një përqethje pas shqiptimit të ftohtë të asaj fjalisë lakonike ‘njerëz koti’.

Edhe kohë më pas, kur unë njoha Ilirin dhe i tregova se nata e Vtit të Ri në lokal kishte qenë më tepër një paradë mode, ajo do ma priste fjalën me neveri:

- Njerëz koti!

Mua më duket trishtim i madh të jesh njeri kot. Vjet, kur vdiq babai i Silvës, fqinjës sonë, unë vura ulërimën në varreza e s'pushoja dot, kur Ana tha me qetësi makabre për njeriun që po zbrisnin në varr:

- Njerëz koti!

I vdekuri e pati mohuar vajzën e vet, me të marrë vesh se ajo dashuronte një djalë me origjinë nga Malësia. E kishte flakur nga shtëpia Silvën pa i dhënë as rrobat e trupit. Atëherë ishte ngritur familja e djalit edhe më e inatosur nga përbuzja dhe kishte thënë në kor:

- Atyre nuk iu pëlqen djali jonë? As neve nuk na pëlqen vajza e tyre!

Kështu çifti i ri përfundoi befas në një garsonierë të zbrazur, me akustikë të shkëlqyer, dhe djali, një trombist

gjakftohtë si vetë gjakftohtësia, ku rafsha e mos u vrafsha, pati marrë një copë qymyr dhe kishte vizatuar në mure bufenë, televizorin, frigoriferin ...

Ne shkuam një pasdite me Anën për vizitë tek ata dhe unë nuk do ta harroj, rezik dhe në u sklerotizofsha, kur urdhëronte djali:

- Silva, hape pak televizorin!

Ajo prekte një nga rrathët e vegjël në mur, pastaj ulej dhe shihte nga ekrani i vizatuar naivisht, si prej një fëmije, pa i shkëputur sytë asnjë çast. Skenat zhvilloheshin me humor, por unë e di si i kam mbajtur lotët e mbledhur në fyt.

T'i dija gjithë ç'do të ndodhnin më pas atë ditë, në apartamentin paqtor, me siguri do të vija ulërimën dhe nuk do të mbetesha vetëm te përqeshja, kur ajo tha shpengueshmë:

- Njerëz koti!

Koha e tashme

Më në fund unë hyra në kuzhinë me gjithë këpucë, natyrisht, duke ecur në skajet e tapetit, si ata akrobatët majë telit në cirk, dhe u ula në një nga kolltuqet e thella e të rehatshme. U ula aq skajshëm, sa vetëtimthi m'u kujtua nëna. Kur ishim të vegjël, mua dhe vëllait na ishte ndaluar kategorikisht ulja në kolltukët e dhomës së pritjes, sepse ndejtja jonë atje do të zhbroste mbulesat dhe do t'i bënte pis ato. Pakkush ulej mbi to, kështu që, me rregullën e famshme e prishpunëse të Konfucit, armiku i armikut tim diçka është për mua e me radhë, ato konsideroheshin të pastra. Në të vërtetë, kur i lava, pas nja dhjetë vjetësh që ua kishim veshur kolltuqeve, ato të kallnin krupën, aq pisillëk nxorën. Vëllai atë kohë ishte njëzet vjeç. Ai deklroi seriozisht kur po hanim darkë se veshjet e kolltuqeve përhapnin përmes fuzionit një erë jo fort të njojur, ose, më saktë, një aromë që njeriu i mençur bën sikur nuk e nuhat kur e ndien në mes të shtëpisë dhe jo në W.C. Mbaj mend se im atë u nxeh atë natë me nënën.

- Formalja është zgjyrë! - proverboi ai kategorikisht. - Ato që lan përditë janë njëqind herë më të pastra e më të reja nga mallrat e pluhurosura e të dala boje e me të ndyra miza të vetrinave!

Ai bënte gjithmonë sherr me nënën për këto gjëra. Donte ta lyente shtëpinë çdo vit me gëlgere, le të dukeshin muret dritë. Ishte partizan i dezinfektimit.

- Mos përto të dezinfektosh, - thoshte, - sepse fiton ajër dhe pastërti. Ku ka pastërti, ka shëndet. Ku ka shëndet, ka lumturi, - shtonte sipas huqit të tij tradicional për të

formuar e thirrur në ligjëratë proverba. - Po përtove, - futet mikrobi në familje dhe nuk shkulet për njëqind vjet! ...

Mua më trishtojnë keqas këto kujtime. Im atë mbetet një demokrat i madh në marrëdhëniet që vendos me sendet, ama, me frymorët ... Më mirë mos dilje në një qafë me të. Partizan i dezinfektimit, i ajrit të pastër, në shtëpi mbante fronin e patriarchut alla Lek Dukagjini, kurse për të bërë vajza një shëtitje mbrëmjeje në ajër të pastër, duhet të merrte një dhjetë dhjeta në shkollë brenda javës e të sillej si skillave teorike gjatë kësaj jave në shtëpi. Ndoshata prandaj unë e kam parë gjithmonë me dyshim pastërtinë e shtëpive. Edhe shtëpia e Anës dukej e pastër. Të paktën, atë ditë, nuk vura re ndonjë skutë të dyshimitë prej nga varen si penjtë zinxij fijet e merimangave. Më vonë do shihja se ajo ia hynte pastrimit themelor të apartamentit ditëve të shtuna, kurse gjatë javës pluhurat i fshinte duke nxjerrë ajrin me zhurmë nga bulçitë e fryra.

Ngaqë nuk dija ç'të thoshja, rrotulloja sytë kuturu nëpër kuzhinë, pastaj u kujtova për letrën që mbaja në dorë dhe ia zgjata me një ndjenjë angushtie.

- Ma dhanë këtë letrën për ju, - i thashë duke u përtypur.

E mori, e hapi pa ndonjë kuriozitet të dukshëm dhe i kaloi një vështrim vertikal. Kurse im atë i ka lexuar gjithmonë me kujdes këto letra. Ai nuk i flakérinte tutje, siç veproi Ana pas leximit. Ka qenë shef shpérndarjeje im atë. Kjo përkujdesje groteske nuk i pëlqente vëllait tim. Unë atëherë mendoja se këto pusulla i shkaktonin alergji, pasi i përngr Jasonin për nga funksioni me kamerdaret e shpëtimit, por tani vonë zbulova se mospëlqimi ishte urrejtja.

- Kjo tregon se, - më tha një natë gjithë mllef, - plakun tonë edhe po ta bëjë një punë së prapthi, s'e prekin dot, sepse ai, fap, nxjerr pusullat!

Im atë nuk u ka shkelur kurrë në kallo shefave, ama, urdhrat, këtu ka vënë veton, ka dashur t'i marrë me shkrim. Dhe gjithë jetën s'i ka hyrë gjemb në këmbë, aq sa mua më duket se edhe fiku i detit nuk e shpon dot atë! Më parë unë kam dyshuar, por tani jam e bindur se fatin tonë e

paracaktonte ai pikërisht me fuqinë magjike të atyre letrave fare të vockla e që të krijojnë përshtypjen se janë aq pa vlerë, sa nuk të hyjnë në punë as për t'i përdorur për të ndezur një zjarr të rëndomtë! Ne studiuam në shkollat që zgjodhi babai, vëllai u emërua në Tiranë, ndërsa unë në një bazë ideale, prej së cilës martesa do të më hidhte si me katapultë në Tiranë, ku i kisha edhe dokumentet. Kur ishte ndonjëherë në qejf, padreja jonë deklaronte duke ecur lart e poshtë nëpër kuzhinë me duart thellë në xhepat e pantallonave, si një aktor antik:

- Juve s'duhet t'iu dhembë koka sa të jem unë gjallë!
Lidhni një litar një kilometër të gjatë në këmbën e kalit të Skënderbeut, bëni një rrëth të plotë rrëth monumentit dhe brenda perimetrit të këtij rrëthi, jo në vizë, ëë, do t'i keni edhe qendrat e punës, edhe shtëpitë!

- Rroftë babai! - tallej vëllai duke brohoritur me zjarr.

Ai e nuhaste një orë larg ironinë, s'ishte njeri që e hante sapunin për djathë, por në këtë rast nuk xhindosej. Vetëm të cingëriste kinse nervat tek pyeste me një zë ironik si nga katedra:

- Po pse, kush të rrojë tjetër, more budalla?

Ne kemi brohoritur shumë në jetë, kurse ai, them unë, vështirë ta ketë bërë ndonjëherë këtë. Edhe në ka qenë i detyruar ta bëjë, nën zë ka brohoritur për vvetveten. Ka prindër që èndërrojnë t'i kenë fëmijët të shkathët në jetë, me shpirt iniciative, me kurajo e guxim për të çarë përpëra pa patericat e mikut a të prindit, që t'i ndryshkin gjunjët e të lenë sakat kur thyhen. Im atë është një më hu e një më kërcu me këta. Ai mbeti teoricien i paepur i teorisë së nënshtimit ... Po të jem unë më i zgjuar se sa ju, ju duhet të më bindeni pa llafe, që të rroni mirë e të mos thyeni hundët në ndonjë kanal, ndryshe ju përfundoni vetë drejt e në gojën e ujkut ... Këto fjalë kam filluar t'i dëgjoj qëkur ai konstatoi se unë kisha hyrë në kohën e pubertitetit.

Pusulla qëndronte e flakur në tryezën e ulët para kolltuqeve dhe unë e ndava mendjen se ajo nuk u përfill. Po

mendoja oraret e nisjes së trenave drejt kryeqytetit, kur Ana hepoi kokën prapa dhe tha duke rrudhur buzët e tulta:

- Nga njihesh me Stefanin?

Ngrita supet e çuditur.

- Cilin Stefan?

- Këtë, pra, që të ka dhënë letrën!

Atëherë u kthjellova. Babai veç do të hungëronte 'idiotja', për të vlerësuar objektivisht reagimin tim. Ai do të ishte i mendimit se përgigjija më me vlerë do të qe një 'e njoh' e paplotësuar më tej, e mistershme për tjetrin, pa përcaktuar asnjë shkallë të njohjes e detyrime të ndërsjellta. Po ai ishte shumë larg ato çaste. Nuk rrezatonte dot aq larg babai dhe kjo më çuditit tërësisht kur e konstatova.

- Nuk e njoh, - iu përgjigja Anës duke u skuqur.

E shava në çast veten për përgjigjen e dhënë, sepse, me sa dukej, thellë brenda meje duhet të jetonte taktika e babait, pasi m'u krijua një idhësirë në gojë, siç i ndodh njeriut kur mendon se e shqeu me duart e veta fatin e tij.

- Ai erdhi në zyrën e shefit të sektionit të kulturës, kur unë u ndodha atje e mërzitur, ngaqë nuk po gjeja një vend të mirë për të banuar dhe ... Më mëshiroi, si duket, - u përpoqa të buzëqesh.

Buzëqeshi edhe ajo.

- Nuk të pëlqen mëshira?

Dhe pa më lënë kohë të përgjigjem, vazhdoi:

- As mua! Ka njerëz që hiqen sikur janë të sëmurë, të varfër, vetëm t'i mëshirosh pakëz ...

U kthye brinjas në kolltuk, u zgjat drejt bufesë, uli në tryezën e vogël një pjatë me çokollata, cigare, një shishe me pijë të përgatitur vetë dhe, duke u ngritur të merrte gotat, tha:

- Kafe s'kam! ... Mua më neveriten ata që ankohen gjithë ditën. Tipa kot fare!

Kurse unë vetëm tundja kokën si kalë. S'dija nga t'ia mbaja. Nuk e njihja aspak dhe as që kisha idenë se si mund ta deshifronte kuptimin e tundjes së kokës sime. Mbase me ndonjë 'po' servile. E dëgjoja dhe më kujtohej mbledhja e

fundit e rinisë në kurs, kur ne u mblozhëm për të caktuar demokratikisht, vendet e emërimit të secilit. Ne vumë krite-
ret e shpërndarjes, thamë se vajzat e martuara apo shtatzana
do emërohen të parat në Tiranë dhe, pa filluar diskutimet
mirë, u ngrit një pispiruqe korçare, e fejuar sapo, dhe tha
si me turp:

- Më falni, po unë duhet të emërohem në Tiranë se jam
shtatzanë ca ditëshe ...

Në auditor ra një heshtje e rëndë. Dikush psherëtinte
'një vend pëllumbash më pak', dikush ... Atëherë Eli kërkoi
leje të dilte pak jashtë. Ajo u kthyte pas çerek ore dhe, pa
pritur të ulej në bankë, tha zëqëruar me vështrim nga
korçarja:

- Edhe unë dua të rri në Tiranë se jam shtatzanë disami-
nutëshe! ...

O zot i madh, më hypi e qeshura dhe shpirti im e di sa
kile kam harxhuar për ta mbajtur që mos lija nam duke
qeshur kot së koti përparrë një të panjohure që nuk më
dinte as emrin.

Ana më nxiti të merrja një çokollatë pa e zënë fare në
gojë letrën e Stefanit. Në ajër qëndronte një shurdhëri e
keqe, që të hutonte, të bënte epileptike, të kafshoje gishtin
në vend të çokollatës, në rastin më fatlum, kur dora nuk
përfundonte diku andej nga hunda. Duket e ndjeu turbul-
limin tim, sepse ia nisi me ato pyetjet shpëtimtare në raste
të tilla, që fillojnë nga shkolla e përfundojnë te familja. I
pëlqeu profesioni im dhe u bë e vëmendshme kur i tregova
se ciceronia e turistëve anglishtfolës në muzeumin e njohur
të qytetit qëndronte para saj.

Tundi kokën me një ndjenjë të dukshme kënaqësie.

- Domethënë, dokumentet i paske në Tiranë, Okej!

Kruajti kokën pranë tëmthit të majtë me një gisht, pastaj
më vështroi ftohtë me ato sytë e saj me bisht.

- Hap sytë nga ndonjë prapaskenë atje në muze!

- Pse? - kërceva unë, më tepër se paralajmërimi i saj më
ngjau me homologun e bërë ca orë më parë në Tiranë nga
im atë, bash kur treni po lëvizte në platformë.

- Për atë vendin e cicerones në muze sa nuk shpërtheu lufta civile në Komitetin Ekzekutiv!

Isha nisur me një barrë qejf që po i shpëtoja diktatit të tij dhe, ja, tani!

Me tim atë ajo ngjante vetëm në formë, kurse në përbajtje s'dilnin, lumturisht, në një qafë. Nuk ma priste mendja se do të mund të gjendej diku në lëmshin tonë tokësor, nga epoka e gurit e këtej, ndonjë luftë civile që të paskësh shpërthyer nga shkaku i zënies së një vendi pune. Qesha si budallaçkë dhe papritur e ndjeva veten fare pranë saj, sikur ta njihja, sikur ta njihja prej vitesh e të kisha hyrë në shtëpinë time.

- Ha-ha, - s'pushoja dot, - u bëra si Helena e Trojës! ... Pedagogu i letërsisë së huaj do të të vinte dhjetë në provim, po t'i jepje këtë përgjigje! ...

Qeshëm me lot.

- Për një hajvanllék të tillë?! - pyeste ajo duke fshirë lotët. - ... Paske humor anglez, duket gjuha ka bërë të vetën ...

Atëherë unë i tregova se si një shoqes sonë të kursit, e cila njihet përkompletësinë e saj idiote, deri te molekulat e atomet e gishtit të vogël, i ra në tezë në provimin e letërsisë së huaj edhe analiza kritike e romanit 'Thundra e hekurt' të Xhek Londonit dhe kur pedagogu e pyeti se ç'mesazhe përcjell te lexuesi ky roman, ajo u përgjigj serbes fare: shfrytëzimin mizor e të paskrupullt të qenve në botën kapitaliste e revizioniste! Atje qeni për qenin eshtë ujk! ... Pedagogu e vështroi ngultas shoqen tonë, si njeri i lënë nga mendtë, ia hapi vrullshëm librezën e notave gjithaq i tronditur e sy-pandarë, i këputi vetëtimthi një dhjetë në kolonën përkatëse dhe një firmë bri notës, pastaj ia rrasi dokumentin ndër duar asistentit për të vënë edhe ai firmën e tij. Ky i mjeri, një çunak ende i parrahur nga sekretet profesionale, e firmosi librezën gjithë llahtar.

- Po pse dhjetë profesor?! - arriti e tha pastaj nëpër tërë atë hutim të plotë.

- Që të qërohet një minutë e më parë nga auditori, - tha

pedagogu duke kërcitur dhëmbët, - sepse po na buisi ndonjë kontroll dhe na e gjen në përgjigje e sipër, më var mua mu në mes të sheshit ‘Skënderbej’! ...

Dhe Ana shqiptoi fill pas një pauze atë fjal që nuk e kam harruar deri më sot e që vështirë se mund ta shlyej ndonjëherë nga kujtesa:

- Ka shumë çudi, që, kur nuk i beson se kanë ndodhur, kthehen në fatkeqësi kombëtare!

Mbaj mend se pasi artikuloi fjalinë që mbaronte me togfjalëshin ‘Fatkeqësi kombëtare’, u ngrit duke turfulluar, shkoi te dritarja, hapi pak perden me një têrheqje të shkurter e të prerë të dorës së majtë dhe u shtriq. Trupi i saj dukej si një mjegull dridhëse nëpër dritën e diellit. Ishte i bukur. Çudi si u pati shpëtuar një bukuri e tillë syve të mblesëve të kryeqytetit! Ishte vërtet habi se si e kishin lejuar sekserët e mishit këtë bukuri të shtegtonte në këtë skutë pa ia vjelë kaparin e tyre, shpërblimin e merituar për zbulimin e madh. Edhe bukuria investohet. Leku ecën mirë tek i varfëri, bukuria tek i kamuri. Kurse ajo më foli pa e hequr vështrimin nga përtej dritares:

- Sot kam ditëlindjen ... Në të vërtetë e kam nesër, por këto tre-katër vitet e fundit e festoj një ditë më herët ... Do ta përballoja vetëm, por, ja, erdhe ti! ... A dalim të blejmë ndonjë gjë? Për festën e madhe, pra! - u tall buzërrudhur.

Ditëlindja! E, pra, dita e lindjes, festë humane! Po mua më duket e çuditshme kjo dreq ditë e shënuar! Bile ndodh të them edhe ‘më mirë mos ishte fare!’ ... Kur ne festuam në kursin tonë 20-vjetorin e Martinit, organizuam një darkë të madhe tek ai dhe u prefëm për qejf homerik. Mirëpo prindërit e tij hodhën rrënë në tryezë dhe nuk bënë këmbë jashtë apartamentit, që ne mos binim në gabime ideologjike e mos ndilleshim nga ndikimet e huaja. Dhe, meqë ata të rritur autoritarë i barazonin shfaqjet e huaja me qejfin dhe gëzimin e papranguar, ne, merret vesh, as bëmë qejf e as u gëzuam. Atë natë Martini tha atë të fortën, kur unë i urova 20-vjetorin:

- Unë jam dy vjeç e tri ditë e gjysmë, e dashur Ema, jo njëzet! Kaq kam jetuar! Të tjerat m'i kanë ngrënë ‘mos’-et e prindërve të dashur dhe të mësuesve të kujdeshshëm ...

E shihja Anën nga pas dhe vrisja mendjen: sa vjeç duhej të ishte kjo krijesë e qetë dhe e ftohtë në pamje, e vetmuar, si ata lumenjtë që rrjedhin në qetësi nëpër fushat e pafundme drejt detit ... Pastaj më kujtoheshin qejflnjëtë amatorë të shahut në park, me kutinë e lojës të hapur përpara, me duart grusht mbledhur në mjekër, pastaj turmat e llapagenëve gjoja kompetentë mbi shpinat e të dyve pa luajtur mirë gurët e parë, që nuk të lejojnë të luash siç di ta luash, por ta mbërthejnë dorën në hava me ca buzëqeshje mëshiruese dhe të urdhërojnë butësisht: jo atë gur, luaj kalin këtu! ...

Dhe unë Anës iu binda jo se më hante malli për të festuar një ditëlindje, por se s'më vinte për mbarë ta kundërshtoja.

Në rrugë kishte filluar era dhe ne ecnim diçka brinjas mos na shkatërrroheshin flokët. Pastaj u shkrimë fare në qendër të qytetit me afishen që lajmëronte shfaqjen e estradës së maturës me titullin e mrekullueshëm ‘Hajdeni se do kënaqeni’ dhe u mekëm e qeshëm me lot me titullin e premierës së estradës së qytetit, në afishen e stërmadhe tre metra më tej: ‘Kolektivi të tregon vendin!’

Anës iu shkathtësuan lëvizjet, u bë më e lirë, si të ishte një pemë e brishtë që gjallërohet papritur nga çdo erë, sado e lehtë, që fillon të fryjë. Pastaj e pushtoi një dell filozofik.

- Ky pejzazh është i mrekullueshëm, me këtë fëshfërimë gjethesh, me përkulje elegante filizash, veç po të bënин edhe njerëzit kështu, nis era - përkulu, dëgio një fjalë - të lumtë goja!, ashtu është, do ishim të pranishëm në kundrimin e pejzazhit më të mjerë!

Mua personalisht asnjëherë nuk më ka pëlqyer filozofia shkencore: Nuk më duket as konkrete e as e përjetshme. Filozofët sikur kanë lindur për t'i ngatërruar gjërat Përhembull në shkollë dikur lexova një material filozofik që shpjegonte qëndrimin skeptik të anglezit ndaj jetës, splinin e tij të njohur e kështu me radhë. Ai material ishte si

kriptogram, duhej të mendoheshe një orë për të zbërthyer kuptimin e plotë të një fjalie. Duhej fjalori për të zbërthyer termat ... Kurse Bajroni, të njëjtën gjë, e shpjegon shkëlqyeshëm me një strofë të vetme te Çajld Haroldi' i tij, të cilën ia recitova Anës:

S'qaj për gëzimet që humbas
Rrezikun që më vjen,
Po vetëm qaj se nuk le pas
Asnjë që lotin vlen.

- S'është ashtu, - më kundërshtoi Ana, - ti i interpreton gjérat sipas qejfit tënd. S'të pëlqen filozofia dhe thua ... Ehu! Do vdesësh shpejt! Kush nuk vret mendjen, vret veten!

Çudi, me këtë filozofi isha njohur qysh herët me gjyshen time, vetëm se ajo e shprehte me një konkretësi tjeter: truri i pavrare, trupi me plagë! ... Ne kemi bërë një krim deri tani që nuk i kemi mbajtur shënim në shtëpi thëniet e gjyshes sonë. Ajo lëshonte mrekullira dhe qëllonte aq larg, sa nuk ta priste mendja. Kur nënës sime i vdiq babai, të cilin gjyshja s'e donte hiç, tha ashtu si kot një mbrëmje, kur isha vetëm me vëllain në shtëpi: çudi, ç'djallin iu desh vdekjes i ati i sat ëme?! ...

Ana kukurisi me dorën para gojës, duke hyrë në një dyqan frutash dhe s'guxoi ta kthente më kokën nga unë deri sa e mbushi rrjetën me ca mollë të florinjta 'Gold'. Pastaj në librarinë e qytetit përballë hotel turizmit mua më zuri syri në vetrinën e librave të rinj veprat e Gorkit dhe vendosa t'ia dhuroj për ditëlindje Anës. Nëna ime, po ta merrte vesh se ç'dhuratë i kisha bërë shoqes, do shkulte flokët si ato vajtojcat profesioniste: 'po pse, moj, blihet 70 lek dhuratë se na mbushka tjetra 27 vjeç?! Sa vjeç të bëhet njeriu, aq lek i zgjidhe dhurata! ...' Mamaja ime është pakëz cingune. Ajo nuk e pranon hapur, por nuk ka besuar kurrë tek e ardhmja. Të kem unë ca para mënjanë, mendon, se ku i dihet ç'bën vaki nesër, pa lere ç'thonë njerëzit dhe

gazetat! ... Dhe mbledh qindarkë pas qindarke, bllokon lekun e shtetit dhe e shtyn të shkretin shtet drejt inflacionit artificial. Kur unë ia shpjegoj ndonjëherë të gjitha këto, ajo kërcen e tmerruar: 'Unë shpifkam inflacionin e shtetit shqiptar?! Unë bllokan kam investimet në socializëm? Pse, armike qenkat unë?!...'

Anës i pëlqeu grotesku: Në të vërtetë grotesku është i mrekullueshëm. Të paktën të le shteg për ngushëllimin e vetvetes, natyrisht, kur ke dëshirë ta bësh këtë. Thua me vete: unë qenkat nxitës inflacioni?! - Dhe, ja, tek e bën gjumin fill si qingj!

Atë pasdite na u shpif e qeshura dhe nuk ndahej dot, aq sa Ana, me të shkelur në një bërryl rruge me vizatime fëmijësh mbi vete, fshiu sytë me shami dhe psherëtiu:

- Mos na dalë e qarë gjithë kjo e qeshur!

Pastaj më tërroqi ngadalë për krahu drejt një reparti punim-druri.

- Dy minuta, - më tha.

Dhe pa më lënë kohë të pyes, lëshoi zërin drejt dy punëtorëve që po prisnin dërrasa në makineri:

- Salvadore!

Ajo i kishte hapur krahët, ndërkokë që thërriti emrin, dhe u përqafua me punëtorin që fuste dërrasat në sharrën e makinerisë. Tjetri i shihte e buzëqeshte, pastaj i thirri mendjes se me gjithë atë zhurmë s'mund të dëgjohej asnjë lloj bisede dhe nxitoi ta fikte elektromotorin. Ulërima e sharrës erdhë e u zbut, deri sa u zhduk fare, dhe atëherë u dëgjuat kukurisja e Anës. Ajo u përqafua përsëri me Salvadoren, kurse unë gati u rrëqetha nga delikatesa me të cilën u vu dora e madhe e Salvadoreve në flokët e dredhura të Anës. M'u duk sikur ajo dorë druhej mos thyente diçka të shtrenjtë e të shenjtë për të.

- Ç'bën? - e pyeti Ana.

S'më pati folur ende për Salvadoren, por unë e preva se duhej të binin gjak me njëri-tjetrin. S'jemi asgjë, do më sqaronte më pas, duke shtuar me një të qeshur gjysmë kumbuese e gjysmë tallëse: Konservatore! Përqafimi me

kushërin, dora me shokun ... Njeriu i mirë duhet më shumë se kushdo tjetër! ...

E vërteta është se kur u njoha me Anën, isha pakëz e mykur. Vija nga vitet '50 të babait dhe përcaktimi që më bëri ajo si konservatore ishte i saktë. Por, përsëri s'dua të marr mëkate të tepërtë mbi vete, nuk ishte faji im. Mua ashtu më edukonin. Sapo heroi ia kapte dorën heroinës në kinema, spektatorët ulërinin të lumtur: këta do të mar-tohen! ... Në shtëpi nëna me babain më porositnin: mos ia jep njeriu dorën, se të mori krahun! ... Në shkollë të thyenin njëzet nota në sjellje po të përqafoheshe me dikë shoqërisht, kurse shoqet të quanin ashtu ... Ehu, sëmundje e vjetër! Një shoqja ime e kursit, që u emërua redaktore e sektorit të jashtëm në televizion, ishte aq keq e infektuar nga kjo psikologji, sa nuk la puthje e përqafim e dhënie dore pa prerë në filmat e huaj që i ranë për hise t'i redaktonte. Aq pasionante është treguar në këtë profesion, sa edhe sot atë e tregojnë në rrugë si luftëtare antiseks!

Pyetjes së Anës 'ç'bën', Salvadorja iu përgjig thatë:

- Luftë me dërrasat!

- Pse nuk ke dalë nga shtëpia? - e pyeti ajo. - Thashë mos ke prerë ndonjë gisht!

- Ka frikë mos i bëhet xhelozë Maria, - qeshi nga prapa Salvadores djali i ri që punonte me të.

Salvadorja tundi dorën.

- Mos e dëgjo atë budalla! Maria të kujton, por nuk kemi pasë kohë me ardhë. Ngela në dyqan. Nuk e marr vesh ç'dreqin i bëjnë njerëzit gjithë ato korniza, sikur i hanë në vend të sallatës, i hëngërt dreqi.

Ana qeshi me atë 'i hëngërt dreqi'.

- Nuk ua ngjit, ti! U fut nga një gozhëdë listelave dhe ato zërthehen në krye të muajit ...

Salvadorja ngriti supet.

- Po prapë, shumë vijnë. Ja gjysmën e rregulloj unë të vijnë nga dy herë, po të tjerët?

Pastaj ndërroi në çast bisedë.

- Po ç'e mirë këtej?

Ajo u kthye nga unë dhe i bëri një shenjë me dorë Salvadorës drejt meje.

- Kam këtë shoqen sonte për darkë, ç't'i jap? Ti thua kornizat nuk hahen. Ke kapur ndonjë qefull të vockël? Salvadorja hapi krahët.

- E ç'më duhet mua që rrëfej zanatin, - pshëretiu, - bëj, o budallë, si ata zantlinjtë e vjetër!

Pastaj u kthye nga djali që zbardhte vazhdimisht dhëmbët pa i hequr duart nga xhepat e përparëses së punës.

- Ik te Maria dhe thuaji, më tha Salvadorja, më jep dy qefuj nga ata që futi sot në frigorifer. Dy më të mëdhenjtë, është, se na ngelet qejfi pastaj neve që i hamë! Këto janë vajza, - filloj të tallej me ne, - nuk duan të hanë shumë, se iu prishet linja, prandaj duan të kenë përpara dy peshq kiloshë, që t'u ngopet syri dhe t'u pritet oreksi. Kështu shpëtojnë nga dhjamosja ... Peshqit çoja drejt e te shtëpia, se s'është, si thoni ju, etike të dalë Ana me peshq sa një mace në dorë në mes të rrugës ...

Ai u kthye nga ne dhe vetëm atëherë u kujtua të më zgjaste dorën, pa ma ndarë vështrimin si prej inventarizuesi:

- Po këtë vajzën, nga e kemi?

Ana i tregoi me dy llafe ç'dinte për mua. E pashë që Salvadorja u bë edhe më i vëmendshëm.

- Do ta pranosh? Domethënë, - u gëlltit, - tek ti do banojë sa të qëndrojë këtej?

- Po.

Kurse mua as ma kishte zënë në gojë letrën dhe vendimin e saj.

- Unë Marien time nuk e lejsha të rrinte te ty!

Qeshën të dy me zor dhe befas pashë se ata ishin tjetër-suar.

- Do të ketë bela, kjo vajza! - pshëretiu Salvadorja.

S'kuptoja asgjë. Ishte shumë e çuditshme ajo bisedë që mua më dukej gati-gati e koduar.

- Njeri nuk e detyron, - tha Ana, - vetë erdhi. Mua më duket shoqe e mirë. Po deshi të rrijë, po s'deshi, rrugën të hapur e ka ... Ti je pak frikacak, Salvadore, pranoje! Kujton

se edhe prindërit e saj janë si puna jote.

Tjetri hapi krahët.

- Fjala është e poshtër, - tha, - po mbajti, me nder, erë mut, zere se je mbushur. Se mos do të vijë i gjithë qyteti në rresht të nuhasi prapanicën tënde. A e ka bërë, do thonë, e ka bërë! ... Ehu! Era e keqe i bën njerëzit të thonë: ai është i dhjerë!

Ana qeshi me të madhe.

- Boll! - i tha duke i rënë në sup.

Pastaj ia dha dorën edhe një herë.

- Kurse unë, Salvadore, mik vetëm ty të kam! Ika tani. Bëji të fala Maries dhe dilni!

Salvadoren e përvëloj shpirtmadhësie e tjetrës.

- Prit, - i tha, - unë kam hallin e kësaj vajzës. Ty s'të hanë as dreqnit! Ty me të futë në qypin e turshive, besa, i prish turshitë! Po kësaj, a ia mban peshku i kurrizit?

Ana qeshi, ndosha për ta qetësuar disi Salvadoren.

- Para katër vjetësh unë nuk kisha miq këtu, Salvadore. Sot kam njëqind. Nuk janë pak, ëë? Ata më bëjnë mik me gjysmën e qytetit. Kjo, që tani, i ka miq ata që më respektojnë mua. Eshtë llogari e thjeshtë, Salvadore! Mos ia qaj hallin, pra! Më mirë mësoi emrin!

- E kush u mor vesh me ty që të merrem unë sot! - tundi kokën pikëllueshëm ai dhe ne ikëm.

Po emrin atë ditë nuk ma mësoi. Nuk më pyeti dhe më vonë. Kur u bëmë miq tamam, ai më tha se atë pasdite nuk më pyeti se si e kisha emrin, ngaqë ishte i sigurt që do t'ia mbathja brenda javës nga apartamenti i Anës.

Koha e shkuar

Atë natë ia kaluam shkëlqyeshëm dhe pata përshtypjen se Anën e zuri pak vera, kurse mua më turbulloj liria. Ishte e para natë pa tutor, që e jetoja vetë jetën time. Atë natë mbasë u ndjeva për herë të parë njeri. Ana nuk deshi të më linte të kryeja asnjë punë nga përgatitjet e tryezës. Ne ishim dy vajza, s'kérkonim ndonjë salltanet të madh kulinar, aq më tepër se për t'u fërguar ishte vetëm peshku dhe patatinat. Mbaj mend se peshku ishte i mrekullueshëm dhe unë iu mburra se dija ta gatuaja njëqind herë më mirë se ajo. Bile, ia nisa edhe nga numërimi i llojeve të gatimeve me peshk, si të doja t'ia mbushja mendjen përfundimisht të pranonte të jetonte me mua. Kurse ajo qeshi dhe tha ngadalë:

- Për mjerimin e Salvadore, ky talenti yt! Ai do dalë tanë dy herë në javë për gjueti peshku ...

Qeshi edhe njëherë, e lëshuar tërësisht në kolktuk, dhe shtoi duke parë në tavan:

- Nuk do t'ia kalojmë keq bashkë. Unë përtoj të gatuaj, vetëm ëmbëlsirat bëj me qejf ...

Kështu tha, nuk do t'ia kalojmë keq bashkë, por pastaj futi gishtërinjtë në ricat e dendura dhe vazhdoi fare shkoqur:

- Vetëm ti mendohu mirë, do qëndrosh këtu, në apartamentin tim, apo do shkosh gjetiu, sepse nuk dërdëllis kot Salvadorja ... Mua nuk më kanë shumë për zemër këtu!

- Pse? - e pyeta zemërngrirë, sepse m'u duk tepër absurde dhe njëkohësisht ogurzezë shtesa e saj.

Ajo u rehatua mirë e mirë në kolktuk.

- Më quajnë femër jo fort të moralshme, - shqiptoi fare qetësisht, a thua bisedonte për ndonjë mace të lagjes.

Shtanga.

- E kush të quan kështu? - thashë dhe nuk më bënte zemra e goja ta shqiptoja atë fjalën që tha ajo.

Tundi dorën me një gjest të lodhur, veçse njëherësh edhe moskokëçarës, si të shprehte një 'aq më bën për gojët e liga!'.

- Histori të vjetra, - tha me zë të ngjirur.

Kështu, 'histori të vjetra', thonë rëndom njerëzit e lodhur, që janë rropatur e kanë humbur mijëra orë e ditë për të gjetur të drejtën e tyre dhe nuk e kanë gjetur kurrë. Kështu shkurt i bie bisedës edhe im vëlla kur flet për mosrealizimin në jetë të ëndrrës së tij për t'u bërë kimist. Kështu shprehem edhe unë kur më bie rasti të jap shpjegime për ndryshkjen e personalitetit. Këto janë historira të gjata e të pafundme dhe, siç ndjeva që e kisha prekur në plagë me pyetjen time, ndieva se mirë ishte ta ndërprisja sa më shpejt këtë temë bisede, që nuk bashkohej gjökundi me ditëlindjen, humorin dhe cilësinë e peshkut.

Befas zëri i saj u bë therrës:

- Edhe këtu, në qytetin turistik ku ti ke ardhur të punosh, krahës pozitivëve vegjetojnë dy kategori të tjera meshkujsh pisanjosë: një palë nuk duan t'u dalësh përpara syve, sepse i kanë gratë xhelozë dhe u tremben për vdekje sherreve të tyre në darkë. Sikur e kam fajin unë që jam kështu si më ka bërë nëna e që ata janë martuar me ca gra të shëmtuara e idiote, që i dinë burrat për shpendë, të gatshëm për të fluturuar orë e çast. Kaq idiote janë këto gra, sa njëra urren patatet e fërguara dhe spinaqin e zier, vetëm e vetëm sepse i shoqi i ha shumë! ... Kategoria tjetër të shohin paturpësish nga këmbët dhe të thonë, me nëntekst demek, nëntekst si puna e atyre parrullave që varen në rrugë, se po pate ndonjë hall si jabanhix që je, hajde drejt e tek unë, ta zgjidh në çast! ... E pse? Sepse kanë dëgjuar që kam qenë një herë e fejuar dhe jam ndarë me vullnetin tim apo kush dreqin e di ç'istori të sajtar dinë ata!

Më përvëluan në gjoks ato fjalë!

Dikur jam djegur një herë me ujë të përvëluar në të dyja këmbët. Ishte një tmerr i madh. Për ditë të tëra nuk ecja dot. Si duket, nuk shtrihej e mblidhej lëkura ... Ky tmerr m'u përsërit atë natë. M'u kujtua vetëtimthi dialogu im me Meritën, pastaj emri Ana Lika dhe gjithë atë natë nuk kam fjetur dot. Vendosa që të nesërmen të mbledh plaçkat e të zhdukesha nga apartamenti i saj, që më ngjante tani me një vart. Të nesërmen u kthjellova, vura fantazitë veç dhe nuk u largova nga Ana, veçse u betova për të gjitha gjërat e mia të shenja se nuk do leh kurrë më për gjëra që nuk i kam parë, provuar e dëgjuar me shqisat e mia. Hodha hobe sharjesh e mallkimesh mbi veten time dhe betimin për të mos futur kurrë më hundët në punët e të tjerëve e kam mbajtur edhe sot. Kjo më bëri të jetoj për disa kohë e lumtur, e pavarur dhe sfidante ndaj mizerieve, pa ndier pendesë e frikë për jetën që kisha jetuar.

2

Të nesërmen Ana u kthye tërësisht pa humor nga puna. Më pyeti me përtesë si e kisha kapërcyer paraqitjen para kolektivit të muzeut, pastaj tha se do shtrihej dhe nuk u ndie për një kohë të gjatë. Kështu do të ndodhë edhe një vit më pas, në ditën e lindjes së saj, edhe dy vjet më pas ... Vinte një telegram urimi nga nëna, një suvenir i thjeshtë për kujtim nga Stefani dhe ajo shprishej plotësisht. Më vonë e mora vesh se telegramet nëna ia niste fshehur babait. Ilegaliteti e mërziste Anën, e bënte idhnake. Edhe suvëni-ret e Stefanit, ilegale ishin. Ato ajo i shiste që të nesërmen në kinkaleritë ku njihte shitëset. Ne hanim drekë të hesh-tura, unë nuk e mërzisja me dëshirën tmerrësisht të më-ritshme për t'i ngushëlluar të tjerët kur ata s'ta kanë qejfin, pastaj, po të qëllonte kohë e bukur, vishnim rrobat e banjos dhe shkonim në plazh. Vetëm në këtë ditë ajo nuk hynte në det. Shihte gjatë, me përhumbje të plotë horizontin. Më dukej sikur ajo bisedonte me atë gri të largët e të mjegullt ku bashkohej natyrshëm e shkrihej në një masë të vetme qiellore apo ujore deti me qiellin. Më vonë u binda se ajo duhej të bisedonte me sendet, sepse nuk ndihej e vëtmuar, megjithë qëndrimin vetmitar. Dëgjonte në dhomën e saj deri vonë programe radiofonike dhe mua m'u formësua bindja se ajo nuk dëshironte të qëndronte vetëm për vetëm me veten e saj. Bota duhej të qe sjellë brutalisht me të, i vëtmi besnik i mbetej ajo valë radiofonike, herë e shkurtër, herë e gjatë, ajo valë radiofonike e ngarkuar me muzikë e lajme lloj-lloj notash e gjuhësh. Ajo valë nuk e dinte histori-në e Anës dhe as që i dilte koha të merrej me jetën personale

të saj. Ajo valë sillte muzikë në dhomën e Anës dhe e kthente atë në spektatore në një sallë magjepsëse koncertesh, ku këngëtarja e ka të pamundur të këndojet njëherësh, siç ia kërkon zanati, e të përgojojë gjithë ata që kanë ardhur ta duartrokasin në skenë. Kohë më pas, unë i thashë një natë gjyshes sime:

- Kam një shoqe të mirë në apartament, por ajo dëgjon radio gjithë natën ...

- Gjynah, çupa e zezë, - psherëtiu ajo,- kushedi ç'i kanë bërë që është hasmosur kaq keq ... Mbush veshët natën t'i ketë plot për ditën!

Ja, kështu u shpreh nanaja ime. Kur mua nuk më zinte gjumi, tingujt e mbytur nga muret e dyert vinin deri në kuzhinë, ku flija. Mbase, ngaqë tingujt vinin pak të përcduuar në ato orë të vona, qëllonte të më përngjasonin me një muzikë funebre. Më pushtonte një gjumë i turbullt, me ëndrra, dhe gjithmonë në këto raste do të fluturoja në një kishë ku organizohej një meshë e madhe. Gjëmonin përtmerr tinguj funebër, qanin njerëz dhe në mes qëndronte arkivoli. Nuk kisha arritur ta fokusojta kufomën e të vdekurit të shtrirë në arkivol, por kur ia tregova një herë Anës ëndrrën time të mundimshme, ajo më tha me një ton të përhumbur:

- As mos e diskuto që unë e kam vendin atje! Mëkati im i vetëm është se nuk pranova të bëhem ashtu, pasi ca ujqër ma ngjitën këtë epitet. Unë i kam fyter në sedër, në mëncurinë e tyre gjeniale. Po të bëhesha ashtu, do më kishin lënë të qetë prej kohësh ...

3

Një vajzë nuk e ka si në vaj fillimin e një pune të re. Megjithatë muzeu ishte vend i qetë, mes historisë e turistëve nga të katër anët e botës. Kisha të bëja vetëm me një njeri të mërkitshëm, që më vonë, pasi ta njihja diçka, do ta quaja pisanjos, i cili mbyllte gjithmonë brenda vetes enigma. Nuk më pëlqeu që ditën e parë të punës, kur drejtori më paraqiti në mbledhjen e shpejtë të punonjësve të muzeut, si vajzë të sjellshme, që rrjedh nga një familje luftarake dhe që e ka mbaruar fakultetin me rezultate të larta. Marku u hodh e shtoi se gjithashtu isha edhe simpatike dhe se kjo cilësi e vyer imja duhej të më shtohej në dokumentet personale ... Dukej i keq si karakter, i merrte të gjitha fjalët së prapthi dhe në një rast më pyeti me ironi therrëse:

- Si ia kalon me Anën?

Iu përgjigja 'shkëlqyeshëm' dhe ai shtoi se më pyeti fare kot, sa për t'u gjendur në bisedë, se, që unë kaloja mirë me Anën, bile, shkëlqyeshëm, kjo dukej në portretin tim. Unë, gjithmonë sipas pallavrave të tij, shkëlqeja e tëra, sikur kisha rënë në dashuri.

Aluzioni ishte i ndyrë. Mendova një herë mos t'i përgjigjesha fare dhe hodha sytë nga kodra, ku dukej kalaja gjysmë e rrënuar, me ato muret fragmente-fragmente, si dhëmbë pleqsh, të lënë pas dore. Kam pasur një shoqe pogradecare në kurs që ndiqte këtë taktikë:

- Me derrat nuk ndërrohet llaf! Ç't'i flasësh, kur nuk ta merr vesh gjuhën?

Ai vazhdonte të nënqeshte. Atëherë më kërcyen kabunjtë dhe e harrova qetësinë olimpike dhe bashkë me taktikën e shoqes sime të kursit.

të saj. Ajo valë sillte muzikë në dhomën e Anës dhe e kthente atë në spektatore në një sallë magjepsëse koncertesh, ku këngëtarja e ka të pamundur të këndoje njëherësh, siç ia kërkon zanati, e të përgojojë gjithë ata që kanë ardhur ta duartrokasin në skenë. Kohë më pas, unë i thashë një natë gjyshes sime:

- Kam një shoqe të mirë në apartament, por ajo dëgjon radio gjithë natën ...

- Gjynah, çupa e zezë, - psherëtiu ajo,- kushedi ç'i kanë bërë që është hasmosur kaq keq ... Mbush veshët natën t'i ketë plot për ditën!

Ja, kështu u shpreh nanaja ime. Kur mua nuk më zinte gjumi, tingujt e mbytur nga muret e dyert vinin deri në kuzhinë, ku flija. Mbase, ngaqë tingujt vinin pak të përçudnuar në ato orë të vona, qëllonte të më përngjasonin me një muzikë funebre. Më pushtonte një gjumë i turbullt, me ëndrra, dhe gjithmonë në këto raste do të fluturoja në një kishë ku organizohej një meshë e madhe. Gjëmonin përtmerr tinguj funebër, qanin njerëz dhe në mes qëndronte arkivoli. Nuk kisha arritur ta fokusojta kufomën e të vdekurit të shtrirë në arkivol, por kur ia tregova një herë Anës ëndrrën time të mundimshme, ajo më tha me një ton të përhumbur:

- As mos e diskuto që unë e kam vendin atje! Mëkati im i vetëm është se nuk pranova të bëhem ashtu, pasi ca ujqër ma ngjitën këtë epitet. Unë i kam fyer në sedër, në mënçurinë e tyre gjeniale. Po të bëhesha ashtu, do më kishin lënë të qetë prej kohësh ...

3

Një vajzë nuk e ka si në vaj fillimin e një pune të re. Megjithatë muzeu ishte vend i qetë, mes historisë e turistëve nga të katër anët e botës. Kisha të bëja vetëm me një njeri të mërzitshëm, që më vonë, pasi ta njihja diçka, do ta quaja pisanjos, i cili mbyllte gjithmonë brenda vetes enigma. Nuk më pëlqeu që ditën e parë të punës, kur drejtori më paraqiti në mbledhjen e shpejtë të punonjësve të muzeut, si vajzë të sjellshme, që rrjedh nga një familje luftarake dhe që e ka mbaruar fakultetin me rezultate të larta. Marku u hodh e shtoi se gjithashtu isha edhe simpatike dhe se kjo cilësi e vyer imja duhej të më shtohej në dokumentet personale ... Dukej i keq si karakter, i merrte të gjitha fjalët së prapthi dhe në një rast më pyeti me ironi therrëse:

- Si ia kalon me Anën?

Iu përgjigja 'shkëlqyeshëm' dhe ai shtoi se më pyeti fare kot, sa për t'u gjendur në bisedë, se, që unë kalova mirë me Anën, bile, shkëlqyeshëm, kjo dukej në portretin tim. Unë, gjithmonë sipas pallavrave të tij, shkëlqeja e tëra, sikur kisha rënë në dashuri.

Aluzioni ishte i ndyrë. Mendova një herë mos t'i përgjigjesha fare dhe hodha sytë nga kodra, ku dukej kalaja gjysmë e rrënuar, me ato muret fragmente-fragmente, si dhëmbë pleqsh, të lënë pas dore. Kam pasur një shoqe pogradecare në kurs që ndiqte këtë takтикë:

- Me derrat nuk ndërrohet llaf! Ç't'i flasësh, kur nuk ta merr vesh gjuhën?

Ai vazhdonte të nënqeshte. Atëherë më kërcyen kabunjtë dhe e harrova qetësinë olimpike dhe bashkë me takтикën e shoqes sime të kursit.

- O Mark, - i thashë, - e ku e di ti se si bie unë në dashuri? Mos nxito të japësh mendime! Vetëm profanët dhe injorantët janë të bindur për çdo përfundim që nxjerrin ...

E pashë që u murrëtye në portret.

- Jam ca vjet më i madh se ti, - më tha shkoqur.

- Varet për ç'vite bën fjalë, - ia ktheva po aq shkoqur, - për vite që të çojnë përpara, apo që të kthejnë në origjinë? Të kam parë një ditë, ti edhe mishin e haje me dorë ...

Ai u zgërdhi, s'kishte ç'të bënte tjetër, pastaj hapi gojën si peshk për të gjelltitur një gllënjkë ajër, i cili gjithashtu ishte mesjetar në atë dhomë të muzeut mesjetar, dhe foli si gjarpër me fishkëllima:

- Me ju, rininë e sotme, të kënaqet shpirti kur bisedon. Jeni tepër të emancipuar. Fejoheni kur të doni, ndaheni kur të doni, bëni vjersha 'pse të mos jetë puthja legale' ...

Desha t'i thoshja edhe 's'ua bëjmë qejfin juve', por e lashë. Ia ngula sytë ngultas. Nuk qe krijesë fort e shëmtuar, por më dukej pa shije, sikur kishte zbritur nga ndonjë planet tjetër dhe shihte me lebeti zakonet e njerëzve të tokës. Duhej të qe diçka më i madh në moshë nga Ana. Hynte në kategorinë e atyre meshkuje që mbajnë nëpër xhepa fotografitë e dashnoreve.

- O Mark, - i thashë ngadalë me një zë pajtues në dukje, - nuk e kupton se je tepër i mërzitshëm?

S'e priste kthimin e bisedës në këtë krah. Mbeti një hop në kërkim të fjalëve, por, duket, hutimi ia shkallmoi të gjitha njohuritë sintaksore. Atëherë u ngrit për të ikur, ose shkencëtarëve në seancat e pushimit. Dhe ecja i bëri efekt, sepse foli vërtet.

- Kam dëgjuar, se unë vetë s'e kam lexuar, si injorant që jam, se Lermontovi thotë që gratë e bukura preferojnë për të dashur meshkujt e mërzitshëm...

Ndodhej te dera ndërkohë.

- Ta kanë thënë, ose e ke dëgjuar gabim, - i thashë, - jo të mërzitshëm, por të shëmtuarit! Të mërzitshmit nuk i llogarit asnjë femër për të gjallë!...

Doli duke përplasur derën, kurse mua m'u duk se ky qytet duhet të shihej shumë para pasqyrës. Ana do më thoshte në mbrëmje se vërtet qëndronin gjatë para pasqyrës, por jo për të parë veten. Vëzhgonin të tjerët nëpërmjet reflektimit magjik të atij xhami të shndërruar nga shkenca në pasqyrë. Ana u përpoq atë natë me ngulm të hetonte mërsi e deziluzion në sytë e mi. Por pak e vija ujin në zjarr. Le të dërdëllitnin ca njerëz koti çfarë të donin! Vinte e shtuna, unë mblidhja disa rroba, i hypja trenit dhe zbrisja në Tiranë. Ana rëndom nuk vinte. Ajo thoshte se përtonte të udhëtonte. Vite më pas ajo më shpjegoi vështrimin hetues të asaj nate. Për herë të parë i isha dukur si aleate e saj. Më erdhi mirë për veten time më tha, që nuk do ndodhesha më vetëm, dhe keq për ty. Atë natë jam menduar deri në mëngjes, do qëndroje me mua, apo do ikje pa e kthyer kokën pas...

Sikur ta parashikoja që atë kohë fatin tim të mëvonshëm, unë do të largohesha. Në një botë paqësore, ku mbretëronte paqja, njeriu vjen të jetojë si njeri dhe jo si ushtar. Vjen të dashurojë dhe jo të ruhet deri në çmenduri nga dashuria. Unë, personalisht, dua të jetoj, të punoj dhe të dashuroj. Por njeriu nuk i mësoka të gjitha menjëherë.

Koha e tashme e përzier me të shkuarën

- Unë e kam deklaruar me kohë se kjo vajzë është nisur për djalë! - u mburr babai mbrëmjen e së shtunës së parë që u ktheva në Tiranë. U shkri i tëri nga kënaqësia, kur mori vesh se isha rregulluar për të banuar në një apartament ideal, që as ai vetë s'do ma gjente dot.

Ishte hera e parë që ai nuk lëvizte levat e tij magjike për sistemimin tim, megjithëse, duhet ta pranoj se ajo telefonata në adresë të shefit të seksionit të kulturës zgjoi ca si me shumicë ndjenjat e përkujdesjes njerëzore. Fjala 'djalë' për të mund të quhej magjike, çudibërëse, si ato çelësat specialë që hapin çdo bravë. Ishte një lexues tipik i romanit 'Sikur të isha djalë', bile, vazhdimisht më ka shkuar mendja se Haki Stërmilli e ka shkruajtur veprën e tij të njohur pikërisht për të gdhendur ca tipa si im atë. Kur linda unë, babai u bë tapë me konjak nga mërzitja dhe gjyshja tregon se shtëpia kutërbonte një javë të tërë erë të vjella, aq sa mua nuk më vinte hiç era foshnje. Dhe gjithë jetën ky burrë u përpoq të më ndryshonte seksin. Kur bota shpikte transplatin e veshkës, të zemrës e me rradhë, ai qëndronte gojëhapur e i mahnitur para ekranit të televizorit. E dija se ku i fluturonte mendja ato çaste. Si nuk po shpiket ky transplati i seksit, dreqi ta hajë, bënte sherr me veten, me atë sebep t'ia ndërrojë kësaj galës sime!... Nuk i kam kundërshtuar kurrë, ama ylberin nuk e kaloja dot! Mbeta vajzë. Gjithmonë nën tutelë. Emërimi larg shtëpisë më trishtoi edhe më shumë. Atë që kisha përjetuar për vite me rradhë e shkruajta në mendje dhe konkluzioni pas leximit

ishte një trishtim i madh: kisha humbur rrith 23 vjet jetë nën diktaturën e përkujdesjeve. Nuk është çudi që edhe mua, kur të vdes, të ma venë moshën në afishe nga tre muajshe. Të paktën, në ndodhtë kjo, unë nuk do të ngrihem nga varri e nuk do të padis kërkënd për fyerje apo për mashtrim të opinionit publik. Ky konkluzion ishte tragjik. Vetëm im vëlla atëherë queshte dhe thoshte:

- Tragjedinë e jeton padreja, jo ti! Kur ti vjen me një model të ri flokësh, atë nuk e zë gjumi gjithë natën. Kur ti lyen sytë me rimel, ke lyer edhe zemrën e tij me blozë...

Ndërsa Ana heshtonte. Kur duhej të fliste patjetër, bëlbëzonte:

- Asgjë nuk bëhet menjëherë. Por ngadalë, bëhet! Ja, ne na largoi arsimimi nga disa koncepte patriarkale. E rëndësishme është që pikërisht ti që ankoresh nga tutela të mos t'i futësh fëmijët e tu në tutelë. Babait tënd mund t'ia fal paragjykimet, ty nuk t'i fal, të konsideroj armike po të bëhesh rrafshuese e personalitetit të njeriut!...

E dinte ajo ç'i kisha thënë dikur Meritës për të? Dridhesha kur mendoja turbull se ç'varr do kthehej për mua ajo 'dava prostitute'. Dhe rropatesha ta zhbëja atë njollë nga mendja ime. Unë atë kohë fillova pastrimin themelor të ndërgjegjes. Arrita sa ta torturoja veten, ta shaja, ta fyeja, se pse nuk i thashë 'mirëmëngjes' fqinj, se pse nuk e shoqërova deri në skajin e rrugës atë plakun që më pyeti se ku ndodhej farmacia. E shkelja me këmbë veten kur arrija jo të flisja, por të mendoja keq për dikë që nuk e njihja mirë. Atëkohë fillova të përdor dendur togfjalëshin 'ç'ia ve re!' dhe të ndjeja se zëri po më zbutej e po më shndërrohej në ëngjëllor, si zë nëne kur i këndon fëmijës.

- Je bërë kristiane, - vërejti një ditë im vëlla.

Unë e mbrojta pozitën time, e lumturuar që tjetërsimi im binte në sy, ishte real.

- Do vdesim, - ia ktheva, - pse u dashka të hapim varre e të ngremë kurthe?!

- Gjërat e thjeshta është vështirë të kuptohen, - m'u përgjigji ai. - Konkretisht, konkluzioni yt i sotëm është

shumë i hershëm, ai ka lindur bashkë me lindjen e shpirtligësisë njerëzore....

Ç'bisedë ishte ajo! Mos pastë kush të bëjë me sarkazmën e vëllait tim. Ndoshta ka ngjarë nga gjyshi. Ai njeri me vështrim të ftohtë e të kujdeshëm më tha pas bisedës përvdekjen se ishte tmerrësisht pikëlluese që vdekja të zgjon humanitetin tejeta!

Kurse Ana nuk besonte.

- Ehu, - më pati thënë disa herë, - unë kam dëgjuar thashetheme nga më të ndyrat që thuheshin rreth trupit të nënës së një shoqeje, kur e gdhimë të vdekurën... Ti thua se vdekja zgjon humanitetin! E zgjon, po të jetë se është duke fjetur, veç s'ka ç't'i bëjë kur shpirti human ka vdekur me kohë e me vakt! ...

Këto dialogje qenë të rënda përmua, sepse pikërisht në gjithë qenien time po shtrihej pushteti i mirësisë absolute dhe i mirëkuptimit, i dashurisë hyjnore e njerëzore, i asaj dashurie që e nxjerr jashtë fjalorëve fjalën ‘luftë’ dhe tërë fjalëformimet që rrjedhin prej saj, që heq nga fjalorët gjithë termat e armatimeve e të taktilave luftarake e duke pakësuar fjalët, pakëson kështu edhe ndonjë leksikolog në sektorin e fjalorëve. Më shumë nga gjithçka atëherë filloj të më vriste pisllëku shpirtëror, zgërdhirjet pas shpine, virgjiniteti fals i vajzave që ëndërronin çmendurisht dashuri nga më fiziket dhe që verbalisht hiqeshin shenjtore e ngrinin me fjalët e tyre turrat ku digjej dashuria.

Kisha parë atëkohë një mëngjes tek krihesha në dritare një merceologe, të njoburën time të hershme. I thirra nga dritarja dhe zbrita me vrap poshtë, pastaj mora vesh mes klithjeve të gëzimit se edhe ajo ishte emëruar në qytetin tonë. Ne ecëm një copë rrugë bashkë. Ndihesha e lumtur që m'u shtua edhe një shoqe tjetër. Në Tiranë qemë njobur në sipërfaqe, por kjo njobje kthehet në motrore në qytetet e vogla.

- Më prit, - tha, - sa të rregulloj nja dy punë dhe do vi në muze!

Ajo erdhi kur po shoqëroja një grup turistësh anglezë. E

pashë që hyri në zyrën time dhe fluturova atje, me të mbaruar vizita e turistëve. E gjeta me Markun. Bisedonin si të njohur të vjetër, veçse sytë e tij mua m'u dukën si të lyer me epsh. Dolëm të dyja të pinim një çaj bliri dhe, duke pyetur njëra-tjetrën se si ishim sistemuar, fjala nxorri Anën.

- Dava prostitute! - tha mercologia.

Shtanga. Sikur shihja veten time përballë. Nuk m'u dhimb Ana. Ajo nuk lypte mëshirën time. Urreva veten.

- Ku e njeh, ti? - e pyeta gati me ulërimë.

Fatkeqësisht, ajo vazhdonte të ngjante tmerrësisht me mua, ishte unë!

Atje, në atë ftesë për pirje çaji bliri mbaroi miqësia ime me merceologen. Më dukej e çuditshme, gati paradoksale që, në vend të vinte qetësimi pas pirjes së çajit të blirit, sipas pretendimeve të shkencës mjekësore, vinte harbimi dhe tërbimi i plotë! O zot, i madh! Një shekull më parë mbreti i Anglisë pinte çaj bliri për të qetësuar shpirtin e për të fjetur i lehtësuar nga urdhërat e dhëna gjatë ditës për kokëprerje, kurse një shekull më pas, një intelektuale, që e cte si patok e fliste si maçok, pinte çaj bliri për të ngarkuar ndërgjegjen me mëkate të reja! Kur unë u sëmura për herë të parë dhe i fola mjekut përfektet e çajit të blirit te pirësit e ditëve tonë, ai tundi kokën pikëllueshëm.

- Nuk është faj i çajit të blirit. Ç'faj ka bliri i shkretë kur ia shtrydhin lëngun shtatë herë? A e di ti si lindi kanibali? Nga dembeli! Ishte një çoban dembel. Ai e milte lopën tre herë ditën dhe as që e vriste mendjen për ta ushqyer. Në fillim lopa jephte qumësht të bardhë. Pastaj rozë, të përzierë me gjak, në fund, prej gjinjve të së uriturës doli vetëm gjak i kuq. Edhe këtë mijelje dembeli e përdori dhe kërkoi të pinte gjak çdo ditë pas kësaj...

KOHA E SHKUAR

I.

Mbaroi sezoni i plazhit dhe ne dilnim më pak nga apartamenti. Në rrugë tani mbretëronte era, një erë e fortë e ngulmuese. Ana më tha njëherë:

- Çudi, si nuk ka poetë ky qytet?

S'e lexonte poezinë, por përshtypja e saj ishte se kur fryn erë mund të shkruash vjersha sa të duash me lehtësinë më të madhe. Kush e di ç'mesazhe, ç'gëzime, kujtime e trishtime i sillte ajo kuje e largët dhe e zgjatur, herë e fortë e herë e mbytur, si valë radiofonike. S'ishte fort e vështirë ta kuptoje karakterin e Anës. Çdo gjë e kalonte në filtrin e saj. Po t'i pëlqente diçka, thoshte 'mirë', ndryshe...

- Nuk do bësh hajër! - profetizoja unë për të ardhmen e saj.

- Nuk më tregove ndonjë gjë të re, - ma kthente, - po kështu jam ngjizur unë!

Qyteti në fundvjeshtë e pastaj në dimër bëhej monoton. Pallateve iu binte suvaja vende-vende nga shirat dhe rrugët i pushtonin pellgjet, aq sa duhej të ecje si ekuilibriste, kurse njerëzit ishin më të ngeshëm për të përgojuar edhe vetë perëndinë. Atëherë fillova t'i mësoj Anës anglisht. Ishte një lloj rrekje e lodhshme për t'u shkëputur nga plogështia, sepse Ana nuk ishte tip i prerë për mësim gjuhe të huaj dhe të lodhëte. Megjithatë plogështia nuk na ndahej. Them s'na ndahej në numrin shumës, sepse gjithçka e saj tani u bë edhe imja. Gjithmonë e më shpesh dëgjoja prapa krahëve murmurimën 'shoqja e Anës', por identifikimin e plotë e mora me mend një mbrëmje në hotelin e qytetit, kur, tek po interesohesha për sistemimin në dhoma të turistëve që

shoqëroja në muze, u ndosha rastësisht me Elin e fakultetit. Ne u puthëm të malluara, u pyetëm e stërpjetëm si të papara prej vitesh, i thamë njëra-tjetrës mbi tridhjetë herë ‘po ç’kemi?’ dhe unë më në fund arrita ta pyes për ç’hall kishte bujtur në qytetin tonë. U gëlltit dhe ngatërrimthi, duke i nxjerrë shëtitje sytë përreth, m’u përgjigj nëpër dhëmbë diçka si ‘hall familjar’. Nuk e zgjata, veç mbaj mend se ngula këmbë si mushka ta merrja për të fjetur në apartamentin tonë. Më dukej tepër fyese ta lija shoqen time të tre viteve të fakultetit të flinte në hotel, kur unë kisha një shtëpi të lirë. Sa nuk i putha këmbët, ndërsa Eli, gjithë duke bredhur sytë e hutuar përreth, ma priste shkurt: ‘Nuk vi dot, ashtu e kam hallin! Një herë tjetër...’. Atë natë, në bisedën tonë të vrullshme në hollin e hotelit, ajo më la të kuptoja ashtu si tangent se e dinte unë banaja në një apartament me Ana Likën. Nuk komentoi asgjë, por nën-teksti mbetej i kristaltë. Eli nuk e njihte fizikisht Anën, e njihte vetëm përmes fjalëve të rrugëve. Po aq e qartë mbetej për mua edhe bota e këtij thashethemi që riformohej si bisht hardhucke e nuk shterronte kurrë. Më kujtohet si i vriste hardhuckat Martini kur ishim në zbor. Iu shkonte fare afër, pasi i zbulonte tek ngroheshin në ndonjë mur, dhe i qëllonte me fishek manovre e ato fluturonin pas krismës si fishekzjarre. Ku ma gjen t’i qëllosh me pushkë opinionet e rreme! Po s’ka pushkë të tillë!... Atë natë, kur e putha Elin për t’u ndarë, m’u fiksua menjëherë fakti se ajo mbante erë borzilok. Dhe m’u kujtua se shumë vajza të kursit tim patën kokëshkrepjen ca kohë të futnin borzilok në gjinj, për të kundërmuar aromë ‘virgièresash nga xhins barinjsh’, siç tallej një lab i grupit tonë. M’u duk e çuditshme që Eli e vazhdonte atë traditë të braktisur herët në fakultet dhe dëshirën e atë natshme për t’i mbajtur gjiri dhe trupi erë borzilok e mora vesh ca kohë më pas, kur më tregoi duke u kapërdirë Salvadorja se ajo vajza që kisha putur unë me një barrë mall në hollin e hotelit, e kishte kaluar gjithë natën në dhomën e një shoferi të parkut të eksportit. Nuk kam ndjerë në jetë zhgënjim më të madh. M’u kujtua

aluzioni i saj për Anën, pastaj përqasja e natyrshme që po fillonte të bëhej mes meje dhe Anës, pastaj parafytyrova turbull hundën e atij hamshorit të Elit, si noçkën e derrit në plehra, duke nuhatur gjithë epsh e babëzi në gjinjtë e saj dhe pyeta veten e raskapitur nga trishtimi:

- Kush është e përdala në këtë mes?

Kaq neveri ndjeva nga gjithçka, bile edhe nga riti zbukurues i krehjes para pasqyrës, sepse më dukej sikur zbukurohesha kinse për të têrhequr vemendjen e meshkujve në rrugë, saqë dridhesha mos Ana vërtet pati qenë diçka përafërsisht e tillë para se ta njihja unë. Ndoshta për këtë arsy s'e pata pyetur asnjeherë pér historinë reale të asaj fejesës së saj të famshme, ose fejesës së tmerrshme, sepse, kur ndodhesha vetëm, me t'u përmendur emri i Anës, do kërcente në ekstazë, i paduruar, i uritur për të dëshmuar njoħuri mbi jetën private të tjerëve, si maçoku pas peshkut, ndonjë tip intelektuali, që kishte mbaruar rëndom për shkenca ekzakte, por që, duket, dashuronte në mënyrë pasionante sociologjinë, dhe do dëshmonte krenarisht:

- Ah, po, ajo që ka qenë një herë e fejuar! ...

Kaq shumë u xhindosa një ditë në muze pas një dialogut të tillë, sa, duke përbajtur me një barrë heroizëm nervat, e pyeta ashtu si kot dialoguesin tim, një mësues historie me pretendime serioze pér t'u bërë historian profesionist, se në ç'vit ishte bërë besëlidhja e Skënderbeut në Lezhë. Nuk e dinte.

- Si ka mundësi, - e pyeta me ironi të zbuluar, - që një historian nuk di asnjë hollësi mbi bashkimin e popullit të tij dhe interpreton pas qejfit e konstrukton hollësi të rreme pér të përçarë e sharë popullin e tij? S'e marr vesh se ç'metodologji e udhëheq këtë histori!

Dhe, vërtet! As e kam marrë vesh e as e kuptoj as sot e kësaj dite, kur mund të nxjerr tashmë edhe ndonjë përfundim.

Nën zë kam dëgjuar pastaj historira të përbindshme, sikur apartamenti ynë ishte çerdhe dashnorësh, sikur aty ishin bërë aq e aq skandale, bile edhe abortet përmendes-

hin! Në praninë time bëmat shpërnguleshin të gjitha në kohën e shkuar, domethënë kur nuk ke qenë ti atje ... Po merrej vesh se me të ikur unë, kohët korrigjoheshin në çast, bile aq vrrulltas, sa shpesh euforia dhe entuziazmi i kalonte llapaqenët deri në kohën e ardhme të përparme. Pa ditur në do gdiheshim të nesërmen, kronikanët e zinx tregonin ç'kishim bërë ne vitin që do të vinte! Më në fund, një ditë, kristianizmi im stoik më tradhëtoi, kur iu ulërriva dy mësuesve të letërsisë, që po më këputnin ca dokrra bëmash, merret vesh, në kohën e shkuar:

- As kështjella e Hamletit nuk mban dot aq intriga sa i ka ngarkuar Shekspiri! Latë nam! Sikur ai apartament të ishte për asi week-endesh, ju do të ishit bërë të shtëpisë për ne! ...

Anës s'mund t'ia zija në gojë përfoljet e rrugeve, por mendoja se edhe ajo duhej të takohej dendur me këta irritues. Shpesh errej dhe e mbyllte gojën, bënte sikur qe e lodhur, kyçej në dhomën e saj, kurse unë përlotesha si fëmijë i pafuqishëm ndaj armikut të tij. Më vinte ta shqyeja veten time, sepse e ndieja që edhe unë tashmë kisha nisur t'u ruhesha syve të botës. Nuk ma mbante të qeshja më shpengueshëm me zë të lartë, druhesha të vishja rrobe të reja se mos bija në sy ... Më trishtoi fakti se, krejt gabimisht, edhe unë që nuk lidhesha në asnje pikë me jetën personale të hershme të Anës, po kërkoja 'silencio stampa' nga opinioni dhe po hyja në radhën e njerëzve me emër. Ne vërtet jetonim bashkë, bisedonim për shumë gjëra, ndiheshim rëndom motra, po përsëri jeta e saj personale qëndronte e futur në një koracë hekuri. Ajo e dinte se një ditë do të dilte para meje nga mburoja e padepërtueshme, megjithatë e shtynte deri në shtrydhjen e fundit të kockave këtë çast. Kështu, deri sa ia behu një pasdite halla e saj. Ato u puthën me mall dhe dukej që Ana e donte plakën flokëbardhë. Ne ndenjëm deri vonë, pastaj, në mëngjes, si e përcollëm hallën për në Tiranë, ajo pëshpëriti me dhimbje:

- Më duket se edhe mua do të më ndjekë si langua fati i saj.

U kujtua se unë nuk dija asgjë për mysafiren e porsapërcjellë.

- Ka qenë yll! Ish nxënëse e Institutit Femëror. Pastaj doli partizane dhe pas Luftës mbeti partizane e madhe e emancipimit. Kur të vdesë, asaj do t'ia botojnë nekrologjinë në gazetë. Veç, megithë nderimet që i kanë bërë e do t'i bëjnë, mbeti e pamartuar. Asnjeri nuk guxonë ta merrte për grua, pavarësisht se shumë burra e kanë adhuruar apo dashur seriozisht. U trembeshin interpretimeve të opinionit. Opinion i që herët e ka cilësuar moderne hallën time dhe një zot mund ta dijë se pse ne nuk i kemi shumë qejf modernët! ... Kështu mbeti lëneshë ... Eshtë i vetmi njeri që ka arritur të më kuptojë gjithmonë, bile, edhe kur s'i ka ardhur për osh kjo gjë. Kur braktisa të fejuarin, ca kohë kërkova tek ajo strehim ...

Atëherë unë i thashë:

- Ana, mos u mërzit, po nuk e pate bezdi, unë nuk i kam futur hundët kurrë në hallet e tua, po cytur nga ç'më ka kapur veshi lart e poshtë, desha të të pyes: pse u ndave nga i fejuari dhe pse të ka dalë ky nam kaq i poshtë?

2

- Ka njerëz, s'janë pak, ëë, që më quajnë të çuditshme, femër të pazakontë. Të jashtëzakonshme! Me trille, me koncepte moderne, me ... Budallallëqe! Jam jashtëzakonish e zakonshme, në kuptimin intelektual dhe të koncepteve mbi jetën, jam një femër e rëndomtë, krijesë e edukuar me ndjenjën e druajtjes, të frikës e të nënshtrimit njëkohësisht, dhe, në mos qofsha sot fare-fare e zakonshme, dikur kam qenë siç ishe ti kur trokite në derën time me letrën e Stefanit në dorë, mos them më e ndrojtur! Ca ëndrra për të qenë e pavarur i kam pasur, ama ëndrra! Dhe, të flasim realisht: cili njeri normal nuk paska ëndërruar e dashur që të jetë i pavarur? Unë kam punëtorë në fabrikë që nuk kanë lexuar asnje rresht letërsi artistike, mendo më për libra filozofike! E pra, atë thënien e Engelsit se ku fillon e ku mbaron liria e njeriut e dinë thuajse të tërë! Pse? Sepse të gjithë janë të ndjeshëm ndaj lirisë, ndaj jetës së pavarur. Në shtëpinë time nuk e kanë qejf as demokracinë, as pavarësinë individuale, as ëndrrat, as modën e re, bile, as sezoni! Po nuk e veshën pardesynë në prag të dimrit gjithë kryeqytetasit, nuk e nxjerr nga garderoba as babai e as im vëlla. Nga tre bronkopolmonite për shok kanë marrë! Punë e madhe, thonë, e ç'është shëndeti para respektimit të tabuve njerëzore?! Pse thuhet historikisht: më mirë të të dalë syri, sesa nami? ... Ja, këtë logjikë mbartin të dy dhe unë që i njoh deri te gishtërinjtë e këmbëve them se janë qorruar vullnetarisht. Le të bëjë dimër që në fillim të nënitorit, le t'u kërcasin jo dhëmbët, por edhe kockat nga thëllimi, ata presin ... Me pak fjalë, edhe këtë veshje plaçke

të kushtëzuar nga moti dhe fiziku i çdo individi ata e duan të kryhet në unitet. Për ta individi nuk ekziston, vetëm kolektivit i thuren hosanara, sepse nuk janë të zotët të rrojnë më vete, prandaj zgërlaqen në turmën e kolektivit! ... Në fakultet kisha një shok, Sokol e quanin. Ai ishte i mrekullueshëm, sikur e kishte lindur nëna për të çmendur dogmatikët! Këta janë gomerë, thoshte, dhe nga inati që nuk arrijnë dot të bëhen njerëz, na bien neve në qafë! ... Nuk e mbërtheje dot lehtë në gabim, sepse, ngaqë qëllim të parë të jetës ruante talljen e dogmatikëve, studionte me laps në dorë veprat e klasikëve dhe i mbushte xhepat plot me citate. S'guxonte kush ta akuzonte për rënienë liberalizëm apo revizionizëm, se ai, fap, dorën në xhep dhe nxirrte bllokun: 'Në filan vepër, në filan faqe thuhet ...'. Ne kënaqeshim, na dukej se na mbronte heroikisht të gjithëve ... Atij i pëlqente Holanda në futboll, megjithëse më vonë u binda se nuk ishte aq tifoz sa shitej korridoreve të fakultetit. Se nga kishte blerë një orë elektronike, që, po t'i shtypje një buton, ekzekutonte melodinë e himnit hollandez, ca distinktiva skuadrash futbolli dhe me to merrej gjithë ditën. Por qe finok i madh! Në auditor, kur bënim mbledhje rinie dhe mësuesi kujdestar na dendte me ato fjalimet boshe të mbushura ding me fjalë të mëdha metingesh, për të na detyruar të merrnim një angazhim të ri pëngritje mesatareje notash apo për të punuar të dielave në ndihmë të bujqësisë, ai shtypte butonin e orës dhe kërciste për shtatë palë qejfe himni. Sa dëgjoheshin notat e para, ai qiri në këmbë. Merak të madh kishte të ngrinte e ta gozh-donte gatitu edhe tutorin tonë kujdestar, që nuk na ndahej një hap nëpër mbrëmje vallëzimi apo ekskursione, sikur ne të paskëshim qenë bebe në shpërgënj.

- Profesor, ju lutem ngrihuni më këmbë, - i drejtohej butësisht, - është himni kombëtar i Hollandës! Më shumë respekt për popullin punëtor hollandez! Si na kanë mësuar klasikët për popujt...

Profesori ngríhej më këmbë i skuqur dhe s'bente as gëk e as mëk derisa përfundonte hymni, që, falë atij konstruk-

torit të mrekullueshëm të orës, vazhdonte nja tre-katër minuta të mira. Kishte frikë pedagogu ynë të refuzonte ngritjen më këmbë, e trembte si dreqi ajo fjalia 'si kanë thënë klasikët për popujt?'. Ne vdisnim së qeshuri, sa na luanin brinjët vendit! Unë sot do të isha martuar me Sokolin, me siguri, po u theva atëherë... U ulëm bashkë një orë mësimi, se, kuptohej, na puqej ylli bashkë, pavarësisht nga ndonjë inat kalimtar që i mbanim njëri-tjetrit në përpjekje për ta larguar sa më larg shprehjen e dashurisë, dhe ai më pëshpëriti në vesh:

- Sot edhe Brizhid Bardoja ndërron rrugë po i dole përpara!

E dëgjova fare mirë, se veshët tek ai i kisha, të ngritura pipëz, po thashë me vete ta tallja pakëz.

- S'të mora vesh!

Ai më përsëriti fjalinë, këtë herë më pranë veshit, unë prapë vazhdova 's'të mora vesh!'.

Herën e tretë ai e nisi fjalinë, arriti deri te Brizhid Bardoja dhe atje e la përgjysmë. Më puthi pranë veshit. U skuqa dhe u drodha, po nuk i thashë gjë. Aq duhej! Atë orë mësimi nuk do ta harroj kurrë! Ka qënë më e lumtura e jetës sime! Në fillim, pas puthjes, ai dyzoi pak dhe bëri gabimin fatal, që pyeti 'ta marr?', për një diçka që unë ia fala pa dashur të ma zinte në gojë. Mirëpo s'pata dëshirë ta largoja dhe nuk i mbajta qëndrim, kur më kapi si adolescent dorën nën bankë dhe më pëshpëriti me zë të dridhur:

- Zemra, të mbeti hatri?

Të gjithëve, ne, vajzave të kursit, na thërriste 'zemra', bile kështu u drejtohej edhe pastrueseve të fakultetit, ca fishkamaneve, dhe mua më hipë inat i beftë:

- Jo! Po mos më thirr edhe mua 'zemra'!

U përkul nën bankë dhe më puthi dorën. Profesori shpjegonte ushtrime matematike në dërrasë, që nuk i hyjnë në punë as dreqit, kurse unë ia tërroqa kokën në prehër Sokolit. Ka ca gjëra që apriori quhen perverse, për shembull, të bësh dashuri gjatë orës së mesimit në bankën e fundit. Mirëpo atë ditë, të betohem, asgjë s'mund të quhej

e tillë. Unë dridhesha e tëra. Derisa profesori e pikasi që ai ndodhej nën bankë dhe na nxorri të dyve fishek jashtë.

- Përjashta të dy! - ulériu. - Siç e keni filluar ju, do vini të guduliseni ndonjë ditë këtu në katedrën time!

Dolëm të skuqur, auditori qeshte e mërmëriste, dikush pëshpëriste 'matematikë pornografike', dikush tjetër qeshte 'iks dhe seks', ne mbyllëm derën e auditorit plot mirësjellje dhe, pa kapërcyer as edhe një pllakë nga pragu i derës, ai më pushtoi tamam dhe më puthi çmendurisht. Ishte i tmerrshëm!... Pastaj shkuam nga kodrat e liqerit artificial. Ndoshta ndonjë ditë do martohem dhe do bashkëjetoj, ta zemë, tridhjet vjet me bashkëshortin që do më bjerë për hise, por gjithë këtë jetë bashkëshortore unë nuk do arrij të puthem sa atë ditë me Sokolin... Kemi krijuar deficite si pesëvjeçarë, më pëshpëriste, duhet t'i mbyllim!... Dhe puth!... Ne duheshim. Nuk ishim epshmanë. Vetëm puteshim. Ti ma ke parë në plazh këtë shenjën e vogël në sup? Ja, shihe! E kam dhuratë nga dhëmbët e Sokolit dhe jam e lumtur që e kam ruajtur këtë kujtim. Të paktën, diçka të lumtur e mbart gjithmonë më vete... Por, dikush i fryu në vesh babait tim! Ai e mori vesh historinë e nxjerrjes jashtë nga mësimi dhe mua më trajtuan si rrugaçë. Në çast fisi afroi psikologët dhe sociologët, që të më bindnin se qeshë qorollepsur në udhë të shtrëmbër, siç u shpreh një dajë dallkauk, që edhe fjalorin e kishte me fjalë të 1900-tës! Farefisi mbante leksione, meshkujt e familjes më jepnin dru, dhe pas këtij kombinimi të metodave pedagogjike, vendosa të shkëputem nga Sokoli. Se si u dorëzova, menjëherë! Por edhe faj nuk pranoj të më vihet! Ne dalim shumë vonë në jetë dhe, kështu, nuk jemi e nuk ndjehemi të pavarur në familje. Babai im më bënte mua presion me bukën e gojës, me plaçkat e trupit dhe shtratin e fjetjes. Ku të shkoja unë pa këtë trinitet të shenjtë, pa këtë trinom më të domosdoshëm se vetë oksigjeni për të jetuar? Te Sokoli, që çdo mëngjes më kërkonte 50 qindarka borxh për të blerë pesë cigare 'Partizani' te kioska e fakultetit? Kush më jepte mua në çast shtëpi, plaçka, punë? Kush më si-

guronte mua se familja e Sokolit do të ishte aq e emancipuar sa ta pranonte sfidën e familjes sime që ulërinte në kor: ‘Me ata katundarët që nuk dinë të lidhin as ushkurin, do na bësh një familje?...’. Ehu, me llafe gjithçka shkon mirë, por praktikisht kryetari i komitetit ekzekutiv thotë: Vajzë e mirë, mos bëj shakara që në pikë të mëngjesit! Ik te babai e rri urtë, se mua po më luan koka vendit për t’iu gjetur një apartament dhomë e guzhinë gjashtë frysme që po më flenë rrugëve... Punë? Po ik, pra, te babai! Po ta kesh gabimin ti, më dëgjo mua, bëj autokritikë! Po ta ketë fajin babai, e bën ai, e njoh unë, është njeri i mirë, e kemi dhe komunist të vjetër! Haja, mirupafshim!... Le të flitet sa të duash për demokracinë, për mua demokracia nuk egziston për atë vend ku për çdo hall shkruan lutje dhe ku nuk ke asnje lek në xhep. Unë, ti, ne nuk jemi të lirë. Dhe a ka demokraci për robërit? Kështu qe dhe puna ime këtej, nëpër mbledhje goditeshin me zjarr zakonet prapanike dhe vrasësit e dashurive, nga ana tjetër i inkurajonin herezitë duke më lënë mua të varfër! Nejse...

Unë gdhiva netë të tëra, i mendova të gjitha, teorema e triumfit të dashurisë s’vlente për robërit, si puna ime. Nuk vërtetohej dhe unë, si kryetari, thashë: Sokol, haja mirupafshim! Mbaj mend që ai piu nja dhjetë cigare nga paketa me filtër që ia pata blerë vetë dhe më tha i irnosur:

- Zemra, kurrë mos daçin ata bashkë me ty, po shpirtin tënd të vogël nuk e gjen më në jetë, sikur të hypësh në një gomar topall e t’i biesh Shqipërisë nga Vermoshi në Konispol!

Vërtet, nuk e gjeta më. Atëherë dita me ditë mërzitesha gjithnjë e më shumë. Më humbi dëshira për të jetuar e gëzuar. Nisa të kuptoj se më fluturoi nga dora një gjë e shenjtë, eliksiri im i lumturisë. Më lindi një urrejtje gati patologjike për ata njerëz që përshëndesja të parët me shpirt në dhëmbë ‘mirë mëngjes’, më ngjallnin krypën, nuk ua hidhja dot sytë! Dhe e ndava mendjen të gjeja një burrë të përtypshëm dhe të shpëtoj një orë e më parë nga ai mijedis feudal i familjes. Kështu njoha gjatë një mbrëmjeje

vallëzimi heroin e mëvonshëm legjendar të fejesës sime historike, meqë historia nuk ka objekt tjetër më me vlera për t'iu përkushtuar!... Ai punonte në Ministrinë e Jashtme. Kaq mora vesh atë mbrëmje gjithë zhurmë altoparlantësh. Nuk kishte haberin nga kërcimi. Më kërkoi falje gjatë një tangoje të mërzitshme, duke më thënë se tangon nuk kishte pasur rast ta mësonte si kërcehej, meqë, andej, nga jetonte rëndom ai, orkestrat e kishin fshirë nga partiturat tangon. Duke u ulur unë ia ktheva me ironi se edhe në meloditë e llojeve të tjera nuk ndjehej fort i sigurt. Qeshi si idiot, mirëpo nuk ishte aq hajvan sa dukej.

- Tangon nuk di ta kërcej, - ma ktheu sfidën, - sa për të tjerat di, por bukuria jote ua dredh këmbët kavalierëve dhe i bën kështu të pasigurt!

Unë e këshillova të mos bëhej skematik. Me gratë këshillohej përdorja e një takтиke tjetër, lipsej një diplomaci më e hollë. Në diplomacinë shtetërore mund të hanë bukë dhe vulgarët, siç e ka dëshmuar historia. Por suksesi i një takтиke të përdorur në një fushë nuk të garanton suksese kur përdoret idem edhe në një fushë të ndryshme diametralisht nga e para... Kështu u ndamë atë natë. Të nesërmen e pashë në rrugën e fakultetit. Unë e dija ç'është rastësia. S'ishte punë rastësie ajo përballje. Nejse! E takova tanimë si të njojur. Ai filloi të më dilte rregullisht përpara dhe gjithmonë e më dendur. Dukej më konsideronte si ata qentë e Pavlovit dhe përpinqej të më mësonte reflekset. Tani, o qentë janë pakëz njerëz, o njerëzit janë pak qenër, se unë, ta pranoj me sinqueritet, fillova të mësohem me të dhe, njëherë, kur ai u zhduk nga faqja e dheut nja tre javë, me ta riparë sërisht në rrugë, i kërkova në çast çamçakiz. Ai budallai u lebetit. I mbeti goja gjysmë e hapur, sikur të kundronte përballë magjistaren më të shquar të botës. Mua më lindi dëshira ta trajtoj si shërbëtor atë krijesë me pamje mjerani.

- Do më japësh? - e pyeta vrazhdë. - Jashtë shtetit ke qënë, se s'rri dot ti pa më dalë përpara një muaj të tërë! Si e futi dorën në xhepin e brendshëm të pardesysë, gjithë ajo

karabina, nxori një paketë të vogël, në madhësinë e një radioje dore mesatare, dhe ma zgjati përvuajtshëm.

- Në fakt, isha në Suedi, - bëlbëzoi, - dhe e kisha ndërmend vetë të të dhuroja diçka...

- Ka çamçakiz këtu? - ia preva fjalën në mes barbarisht, duke u hequr se pak më interesonin sendet e tjera.

- Ka, - gagaçëroi.

Kështu, tregohu pak koketë sot, prano një dhuratë nesër, u vura nën një presion të dyfishtë. Këtej, të thyeja qafën një orë e më parë nga shtëpia prindërore, andej më tundonte mendësia e turbulluesve: 'ky është flori safi! Me punë të mirë në Tiranë, një në dorë! Jashtë shtetit del kur ka qejf, dy në dorë e një në mend! Shtëpi të ngritur dhe të mobiluar ka, tre në dorë dhe dy në mend...' Sot, kur gjithçka u bë e s'ndreqet më, më vjen ta shqyej veten me duart e mia, ama, kështu, për fat të keq, ndodhi! Unë hypa në kandarin ku peshohet bagëtia. Vetë i hyra asaj valleje dhe tani më kujtohet ai paralajmërimi i popullit për kësi rastesh: Merr një lek e hyn në valle, jep një mijë e nuk del dot!... Nejse! Fillova t'i miklohem nga pak. Ai më ftoi një mëngjes të lija leksionet dhe të shkonim në kinema... Eshtë një film me luftë, më tha idioti, sikur unë isha pioniere!... Shkova. Mbaroi ajo punë. Deshte të më kapte dorën në kinema, por i shkonin shtatë nga frika. Më në fund, më vjen për të vjellë kur e kujtoj, s'di ç'gjak stërgjyshor i erdhi në ndihmë dhe e trimëroi, ma mbërtheu dorën vandalçe e s'ma lëshoi deri në fund të filmit. E kishte pëllëmbën të djersitur nga emocionet dhe mua më hynë të dridhura nga ndohti. Fakti që unë mbaja mend çdo hollësi të asaj ore plot emocione, që, tek e fundit, do të ndryshonte rrjedhën e jetës sime, më bindi fillimi si se s'puqesha gjékundi me atë njeri. Nuk e desha, prandaj pata fiksuar si me film gjithçka. Kurse më pyet për Sokolin? Asnjë hollësi nuk më kujtohet! Kur dolëm nga salsa e kinemasë, meqë ishim kapur prej dore, quheshim të dashur. Feudale, ëë?. Ai nuk e përkrahte tezën e dashurisë ilegale. Kërkoi gjoja të më respektonte mua me seriozitetin e tij dashuror. Në fakt, druhej mos mua më prishej

mendja në atë dyzim që ndodhesha dhe i shkatërroja ato pak marrëdhënie me të, prandaj dhe e mbajti fryshtë shtëpinë time. Kërkoi të bisedonte shtruar, zyrtarisht, siç u shpreh ai, paçka se zyrë s'kishte gjëkundi. Kërkoi të shtronte zyrtarisht, pra, kandidaturën e tij si bashkëshort i ardhshëm imi para prindërve të mi. Kërkonte, në thelb, të siguronte gjahun e vet! Kështu u fejova mes një atmosfere tmerrësish festive në familjen time, ku drurin e zëvendësuan puthjet e kërcitën tapat e shampanjës në tavan përfitoren e madhe... Megjithatë, megjithë gjëzimin prekës e të pafund, përsëri ndodhesha në mëdyshje. Kjo halla ime qante në shtëpi të saj, kurse mua më jepte zemër përmes predikimeve mekanikisht: 'Do mësohesh! Kështu e ka fillimi!' Në atë atmosferë dalldije dhe feste, krejt si në Trojë, është, mjeshtri e nuhati si puna e Kasandrës se festa ishte në turrën e drive. Ai e nuhati dyzimin tim, ndoshta se unë e shprehja herë-herë fare hapur neverinë për të, kështu që u bë agresiv dhe kërkonte të binte sa më parë në shtrat me mua. Sa herë ia kam këputur me flakurima surratit, kur më mbërthente në ndonjë dhomë tinash njerëzve të shtëpisë. Po nuk vinte mend. S'guxoja t'i kaloja dot afër, se duart e tij do t'i ndjeja në gjinj e në kofshë!... Mirëpo s'i jepej rasti të plotësonte synimin e tij final, sepse i jati ishte pensionist dhe s'para dilte nga shtëpia, kurse tek unë nuk i ndizte, se kishte frikë nga im atë. Atëherë iu bë aleate nëna ime. Edhe ajo e nuhati se ende po e peshoja fejesën dhe, për të shmangur tërmetin e tmerrshëm që do të binte po të hiqja dorë nga ky dhëndër ideal, siç më tha më vonë, filloj të largohej befas nga shtëpia dhe të më linte mua vetëm përvetëm me atë. S'bënin më ofendimet e refuzimet fajde. Kështu erdhi dita që nuk i shpëtova dot... Ishte tmerr! Tmerr, se nuk e doja. Ai dihaste si kafshë, mua më kujto toheshin ato tre në dorë e dy në mend... Na edhe këtë, njëqind në dorë e pesëqind mbas qafe! - i thashë vetes atë ditë të tmerrshme... M'u mbush mendja se do të më çmendonte po t'i vazhdoja lidhjet me të, lexova nja dy herë për të marrë zemër linjën e Irenës te 'Saga e Forsajtëve' dhe

komunikova një mbrëmje para familjes vendimin e paap-clueshmët të ndarjes. Skandal! Më asfiksuesi nga gjithçka ishte sherri që më bënon të gjithë, orë e çast sherr, çdo minutë sherr! Vetëm halla heshtte. Babai ma hoqi fillin dhe nuk më fliste fare, nëna më quajti ‘e përdalë’, vëllai... Halla akoma nuk e di se ç’i tha babait, se ajo është kasafortë, por unë mbaj mend se erdhi një pasdite dhe më mori në shtëpinë e saj. Babai u nxi, vetëm s’kundërshtonte dot. Ndaj saj nuk ngre krye. Halla i ka mësuar e nxjerrë në jetë e sistemuar në punë të gjithë vëllezërit e motrat dhe ata të gjithë bëjnë kryqin për të... Nja dy javë nuk shkova në fakultet. Më në fund e mora veten, më ikën shenjat e drurit, m’u zbardhën, më mirë, m’u nxinë rrathët e syve dhe dola prapë në skenë. Plasën thashethemet. Vëllai i nxiste më keq. Ai më ruante si sejmen nga pas, sikur të isha, zot na ruaj!... Atë kohë kam filluar t’i dal vetes pér zot. I bëra ditë me rradhë gjyqin e pamëshirshëm vetvetes, mundohesha të zbuloj qoftë dhe një shteg të vetëm pér t’u shpëtuar thashethemeve të harbuara dhe m’u duk se shpëtimi i vetëm fshihej te pastërtia shpirtërore. Një ditë e ndeza dushin dhe vendosa të lahem me ujë gati të përvëluar. Sa nuk e rropa lëkurën duke e fërkuar si e letuar me shtupë, e fërkova trupin derisa m’u mbush mendja se e hoqa këllirën e prekjeve vandale të diplomatit dhe dhunën familjare, pastaj, tek fshihesha shtruar ia mbusha mendjen vetes të bëhesha edhe një herë foshnje motake, e pastër, me mrekullinë madhështore pér të mos u përgojuar si karakter nga njerëzit. Se, si bukuri fizike apo pér modelet e veshjeve, edhe foshnjat rëndom përgojohen!... Dilja kokëulur nga shtëpia e hallës, aq sa një djalë më tha një ditë nga ato parvazet e parkut para hotel ‘Dajtit’:

- Ma jep mua borxh bukurinë tënde ca kohë, meqë ty nuk të hyka hë pér hë në punë!...

Isha gati t’ia falja bujarisht, isha gati të shndërrrohesha në kriesë me bukuri fizike modeste, vetëm mos bija më në sy, vetëm të më harronin!

I kuptova mirë gabimet e mijë. I ndjeva, si miu tërmjetet,

edhe pasojat, që kur filluan të më mbinë para këmbëve ca tipa të pështirë, që më afronin ndihmesën e tyre humane për të kapërcyer sa më lehtësish tragjedinë e prishjes së fejesës. Kishte nga ata që tundnin një çelës shtëpie me nëntekst të hapur, kishte që bënин sikur i thoshin shokut: sot më erdhi një pako nga Amerika! Gjysmën ia falja kësaj, sikur... Më parë me mua nuk ndodhnin as të mijtat e këtyre skenave dhe kjo do të thoshte shqeto fare se emri im lakohej nëpër ca gojë epshmanësh... Fyhesha deri në palcë, më vinte t'iu puthja dorën propozuesve të paturpshëm e t'iu lutesha të më besonin që nuk isha siç më përfytyronin. Ndihesha fare vetëm, krejtësisht e vetmuar dhe ndjeja frikë të madhe nga gjithçka, aq sa m'u mbush mendja se nuk i përkisja më vetvetes dhe nuk ushtroja asnjë pushtet mbi veten time. Sokoli s'afrohej. Po unë e doja atë dhe vetëm tek ai doja të mbështetesha. E dija se pas asaj morie me budallallëqe, ëndrra e bashkëjetesës sonë ishte një vrimë në ujë, megjithatë, netëve veçanërisht më torturonte mendimi se ndjehesha borxhlije karshi atij njeriu që dikur më kishte dashur pastërtisht dhe më kishte ruajtur të paprekur. Halla ime i dinte të gjitha. Vetëm asaj nuk i fshihja asgjë. Një ditë ajo do shkonte në një konferencë të grave në Durrës dhe unë i thashë drejt e drejt:

- Hallë, a mërzitesh po ta thérres nesër paradreke, që nuk do jesh ti, Sokolin në shtëpi? Të më ndihmojë pak në kontabilitet, se kam ngelur disa leksione prapa...

Ajo më vështroi njëherë, pastaj u trishtua:

- Pse më pyet mua? Unë të mora këtu të mësosh. Ti, mëso!

E mora në telefon Sokolin dhe i thashë duke u përkëdhelur nga pak bisedën që bëra me hallën.

- Do vish të më ndihmosh nesër? - e pyeta me ankth, nga frika se mos ai e refuzonte ftesën time.

Nuk u mendua fare. Tha, nesër në orën tetë të mëngjesit më ke atje, dhe unë gjithë atë natë kam qënë si në ethe. Çdo dhjetë minuta më dilte gjumi, si të kisha frikë se mos vinte makina që do conte hallën në Durrës dhe ne nuk do

ta dëgjonim e halla do mbetej në shtëpi. Si u gdhi ajo ditë? Veç, u gdhi! Erdhi makina, mori hallën, atëherë unë u zhvesha dhe nisa të vishen nga e para, duke kërkuar dhe ëndërruar t'i dukem sa më tërheqëse Sokolit. Vesha një fund të shkurtër, ishte i hallës, mua më rrinte një pëllëmbë mbi gju. Gjeta dhe një këmishë të bukur dhe dy komçat e para ia lashë të zërthyera. Tani më vjen të qesh e të qaj me gjithë ato prova që bëja para pasqyrës për përvetësimin e gjestit gjoja të pavullnetshëm të ndreqjes së këmishës. Po nuk binte erë hile ajo dashuri! Prisja një njeri që e doja me gjithë shpirt dhe pa asnje paramendim. Desha të isha e tija, sepse mua më tërhoqën zvarrë nga ai. Vetëm thellë, brenda vetes, shpresoja se antidogmatiku im do tregohej zemërgjerë me mua, do të më falte duke më pirë lotët... Endërraja sipas mënyrës sime! Endërraja se si do më përkëdhelte flokët me dashuri atërore, gjë që ai nuk e bëri kurrë, se si do më thoshte me një zë të thellë e të dridhshëm nga emocionet: Ana, me ty nuk ndodhi asgjë, ëë? Ehu, sa llafe ka, po ne jemi brezi i ri i vendit, që s'trembemi nga rrethimi imperialisto-rezisionist, jo më të sprapsemi nga thashet-hemet! ... Kurse unë do ta puthja atë dhe do t'i premtoja me zjarr se për të do ndërra edhe fenë time sportive, për t'u bërë tifoze e llahtarshme e Holandës dhe do qepja urgjent një fustan tulipani ... Kisha menduar deri si do bëja humor pas faljes së madhe! ... Shpresa e bën të bukur njeriun. Them se nuk kam qenë ndonjëherë më e bukur se atë mëngjes ... Në orën tetë ra dera. I mbështetur te parvazi i derës ishte Sokoli. Hyri i qetë, veç që kur më tundi kokën e më përshtëndeti pa folur, dukej se i rrihte tamam zemra. S'ia mbante të fliste, e dinte se do ta tradhtonin menjëherë dridhjet e zërit. Më hodhi një vështrim dhe, kuptohet, ai ishte xhind, ma bëri në çast skopinë. Për çdo gjë që i thoshja, ma kthente 'po', pa m'i hequr sytë zhbirues. Bëra kafe, i hodha një gotë raki, i mbusha dhe një tjetër dhe ndihesha si e kapur në lak nga sytë e tij. I rrija përballë këmbë mbi këmbë, mendo ku kishte shkuar fundi, dhe përsërisja pa pushim si skizofrene gjestin gjoja të pavullnets-

hëm të dorës të drejtuar nga turpi e ndjeshmëria bashkë, për të fshehur pjesën e zbuluar të gjoksit. Më në fund antidorogmatiku im e la lojën e syve dhe qeshi, fillimi si ngadalë, pastaj me lot.

- O mbërtheje atë komçë, - tha, - o hiqe këmishën fare! - dhe ra brinjas në divan i mbytur nga e qeshura.

Kushedi pse nuk kundërshtova, qoftë edhe formalisht! Mërmërita e nënshtuar 'si të duash ti' dhe e hoqa ngadalë këmishën, e lumturuar deri në ekstremet qiellore, që ëndrra ime, si magazinë lumturie, po realizohej në jetë pikë përpikë.

Sot çuditem edhe vetë, por kështu ndodhi. Unë atëherë nuk dija ç'bëja! Më vinte të ulërija që fjeta derr në thes me një njeri që nuk desha t'i shihja bojën dhe s'e pata bërë këtë akt me njeriun që mund t'i falja edhe ditë të jetës sime ... Kurrë nuk jam dredhur ashtu, si atë ditë. Kisha një pangopësi në dashuri, sikur hakmerresha ndaj dikujt! Kur gjithçka më në fund mbaroi, m'u shpif e qara. Mendoj ndonjëherë, çfarë çudish ndodhin në jetë! Me atë të fejuarin unë fjeta më parë se me Sokolin, kurse vajzëria ime shkoi e vate pikërisht pasi fjeta me Sokolin. Papritur e pakujtuar nisi të qajë edhe ai. Deri vonë më është dukur se lotët e tij i kam ende në gjoks. Nuk e di se si e kur do të pushonte, sikur të mos i ulërija si e dalë mendsh: mos qaj më! Mos qaajjj!

Mbaj mend që u ngrit, bëri dush me ujë të ftohtë në banjë një çerek ore të mirë dhe doli vetëm kur i thirra të vinte se po i ftohej kafja. Desha ta ktheja filxhanin përmbyss. Nuk më la. Ma kapi dorën në ajër dhe ma shtrëngoi në kyç me forcë.

- Ta them unë vazhdimin! Do mbetemi shokë. Harroje këtë ditën e sotme ... E di pse erdha sot? Nuk desha të të zhvirgjéronte dikush tjetër. Ti më takoje mua ...

- Si isha? - e pyeta.

Bëri një shenjë me dorë.

- E virgiër si shën Mëria! Mos e çaj kokën, vetëm kur të martohesh s'do jesh më vajzë ...

- Po ti, pse e çan kokën?

- Prandaj qava, - tha.

Dhe iku.

Halla më dha vetëm një këshillë:

- Mëso!

Fillova të mësoj turbullt diçka, që e kristalizova më vonë në këtë qytet: tek ne shpesh individi nuk e konstrukton vetë jetën e tij. Dëshiron të martohet me një njeri që dashuron dhe që e ndien si mbështetës të sigurt, i thonë 'jo!'. Ndërhyjnë e shpifin e nxijnë biografi njerëzish fare kot, vetëm për hir të zakonit që vajzës duhet t'ia nxjerrë fatin familja, mbarëvajtjen e saj në punë e komandon drejtori, në rrugë dirigjon opinioni. Me dy fjalë, unë nuk kam të drejtë që, pa i nxjerrë njëqind telashe vetes, t'i jap vendit tim maksimumin e vlerave që disponoj, me studimet e mia në atë shkencë që e kam pasion, me martesën time, me shijet e mia, me punën time krijuese ... Kjo është fatkeqësia jonë dhe fatmirësia e feudalëve. Kështu im atë, që të shkel fare hapur me këmbë sikur të jesh mizë, rron edhe njëqind vjet! Halla ime duhej ta dinte me kohë këtë të vërtetë, kur më urdhëroi qetësisht, siç urdhërojnë gratë njera-tjetrën përparrë kufomës së njeriut të porsavdekur e që e prisnin të vdiste prej kohësh, 'e dashur, mëso!'.

Erdhi pastaj dita e emërimit. Unë erdha duke kënduar në këtë qytet, e lumtur, si një njeri që rilind. Fillova mos ta mbyt të qeshurën dhe mos ta prangoj zërin. Mirëpo kisha ushqyer iluzione për rilindjen time. Ajo fejesë e mallkuar paskësh hyrë në epox dhe subjekti qe ngurosur në ca këngë që çdo rapsod i shtjellon pas qejfit dhe talentit të tij. Apo nuk ka rapsodë këtej! Jeta ime nuk ndryshoi, sikur të mos ishte një jetë njeriu, por një politikë e tërë ekonomike! Vonë e mora vesh se unë, që u ndava për të mos u sakatuar e për të mos e shëmtuar racën e popullin tim, konsiderohesh ha e shëmtuar dhe sakatuese! Këtë e kuptova kur u njoha me Stefanin, atë që të dha ty letrën në komitet. Ai është inxhinier druri, ka qënë përgjegjës i Salvadorez atëherë. Stefani është njeri i mirë, por plastelinë, ia këput kokën

dhe ia ngjit sa herë të duash. Merrte formën që të pëlqente t'i jepje. As ai nuk e kishte patur fatin ndonjëherë ta ndërtojë jetën e tij sipas mendjes së vet. Ishte tip i skllavëruar. Unë e desha dhe ai më donte. Që në fillim fare të lidhjes sonë, ia tregova gjithçka, siç t'i tregova ty, përjashto paraditen me Sokolin te shtëpia e hallës. Mund t'ia kisha treguar në vija të përgjithshme apo me detaje të hollësishme edhe ngjarjen e asaj dite, por e nuhata se nuk dukej tip që mund ta kapërdinte e ta treste atë ngjarje, për të cilën, tek e fundit, s'i detyrohesha aspak atij dhe askujt tjetër, pasi nuk kisha hedhur fall kur rashë në shtrat me Sokolin se unë, Ana Lika, një vit e shtatë muaj më pas do lidhesha me fije dashurie me një mashkull të quajtur Stefan Kaciboli. Që nuk ruante aftesi gëlltitëse, këtë e thitha menjëherë, fill pas njohjes sonë të parë. As Stefani nuk dinte të vallëzonte e t'i përqafonte hapur ata që deshte, nuk dinte të dehej, ose, më mirë, trembej për vdekje mos njerëzit e shihnin pa maskë. Ishte i mrekullueshëm, kurse i frenuar diçka më shumë se një budalla i vockël. Jo shumë ditë më parë u futa në klubin e kombinatit për të pirë një kakao. Në sallën e vogël ishte vetëm ai dhe nuk ia prisha ftesën që më bëri për ta pirë kakaon me të.

- Si jeni? - më pyeti.

Kisha kohë pa e parë dhe pa i folur nga një largësi aq e vogël.

- Stefan, - ia ktheva ngadalë, - ti je i mirë kur bëhesh foshnje, siç të ka lindur nëna. Kur shfaqesh siç të ka edukuar ajo, nuk ke asnë vlerë! Mos fol në numrin shumës!

- Je e poshtër, - më tha, - hakmarrëse meskine!

- Absolutisht, - ia ktheva gjithnjë qetë, duke pirë kakaon, - por pakëz meskine, e pranoj, jam! Dëshiroj që ti ta njohësh vetveten dhe t'ia njohësh thesaret vetes tënde, që nesër ta lumturosh e të mos ta degustosh atë që do zgjedhësh apo do të të zgjedhë për të bashkëjetuar, sepse nuk dua që ajo të mendojë keq përmua: 'Po ajo Ana Lika, ç'dreqin i ka pëlqyer këtij mashkulli pa kripë!'

Iu err fytyra, megjithëse një fashë diell i binte mu në ballë.

- Ke ndonjë këshillë tjetër? - më pyeti me ironi, por pa e fshehur dot dhembjen.

- Po, - i thashë pa hequr dorë nga qetësia e fillimit, - po të pëlqeu ndonjë vajzë, mos i premto bashkëjetesë, pa i marrë pëlqimin më parë nënës tënde, se mund të trish-tohesh më pas...

Tundi kokën si i sëmurë nga parkirsoni, sepse e mori vesh ku ngulej gozhda. Dhe në atë njohjen tonë të hershme unë iu përgjërova, iu luta, i thashë si njeri: 'mendohu, vendos, vetëm mos mbaj me shpresa kot!'. I thashë se nuk mund të duroja dot më fushata të reja fjalësh të ndyra... Ai më premtoi duke më puthur sytë e hundën e duart, m'u betua se s'i merrte dorë kujt për të ndërtuar lumturinë e tij personale, më qarravitej se nuk kishte dashur kurrë njeri në botë aq sa mua, më shihte mu në gojë, sikur do nxirrja vezën e kuqe dhe unë e besova dhe nuk ia fsheha më ndjenjat e mijë syve të qytetit. Ne ishim si të fejuar, megjithëse bashkë nuk shkuam kurrë deri në shtrat. Ato kohë ndjehesha e lumtur. E kuptoja se Stefani më adhuronte, ushqente ndjenja fisnike për mua dhe nuk donte t'i përdhoshte ato me banalitetë të rëndomta. Në të vërtetë, ai ishte i ndershëm! Atëherë unë nuk do t'i kundërshtoja dëshirat e tij për t'u bashkuar me mua, bile, në çaste të caktuara vetëm turpi ma qepte gojën dhe s'më linte t'i thoshja; 'Stefan, rri sonte me mua!'. Nga armiqësi flagrante, nga një vetmi shtypëse, unë pata gjetur dashurinë e pastër, njeriun human, që di ç'të njohë e ç'të kërkojë, që di të qeshë e të qajë. Kjo amplitudë në ekstreme për mua formonte ferrin dhe parajsën, prandaj unë nuk i trembesha pushtimit tim nga ana e parajsës. Nuk do ta harroj kurrë një të diel të mrekullueshme maji kur u ngjitëm të dy në mal. Ishim armatosur me ushqime dhe verë. Gjithë natën e natës para ekskursionit isha përgatitur shpirtërisht t'i jepesha... Ç'livadhe të bucura ka lart në mal! Unë shtrihesha e rrötullohesha, ecja si qenush, vrapoja e flisja me zë të lartë, krejt e çliruar. Më dukej vetja në qiell! Hëngrem drekë, pimë verë dhe 'Eja, Stefan' i pëshpërita më në fund e skuqur.

Ai më shtrëngoi në krahë, më puthi, por vetëm kaq... Kemi kohë, më tha si i goditur nga rrufeja. Atë natë, kur u ktheva, dyshova për herë të parë në ecurinë e marrëdhënieve tona. Nuk më pëlqeu frenimi i tij në mal. Ia njihja ndershmërinë dhe në bazë të kësaj njojheje arsyetoja kështu: atij dikush duhet t'i ketë fryrë në vesh për mua dhe tanë përpëlitet, ta braktisë apo ta çojë deri në fund lidhjen tonë... Atë natë nuk qava, sepse papritur e pakujtuar arrita në përfundimin se nuk e kisha sasinë e duhur të lotëve për të vajtuar katrahurën e re. Poshtërsi e madhe, hall më vete dhe mungesa e lotëve! E di, kush ka halle, s'ka lotë!... Kur të thashë se jeta ime lëkundej në amplituda ekstreme, desha të ta bëj të qartë konkretisht se nga parajsa e drekës unë në mesnatë ndodhesha në furr! Atë natë kam bërë gjumin më të vuajtshëm të jetës sime në këtë qytet. Për herë të parë e ndjeva tamam tmerrin e vetmisë, të të qenit tmerësisht vetëm. Në atë palo gjumë të coptuar që bëra më dolën në èndrra gjithë tersllëqet, e pashë veten me vello, hëngra èmbëlsira, m'u thyen pasqyra e madhe, mora lekë... I binte që, sipas kanunit të paragjykimeve, në mëngjes të më qe sëmurë e të më kishte tundur këmbët gjysma e fisit. Në të vërtetë, ata janë edhe sot shëndoshë e mirë si molla dhe nuk kanë shkulur as edhe një dhëmb, jo më... Duket i gjithë farefisi bashkë nuk peshoka sa mua, po t'i hidhje në balancë. Ky mendim realist më erdhi ca muaj më pas, kur u ndava nga Stefani dhe i bëra ca bilance në vetminë time përmes kujtesës, që falë mëmës natyrë, e kam të fortë. E kisha pësuar vetëm unë nga ajo èndërr që s'linte të keqe pa ndjellë me kapacitetin shkatërrues të një bombe atomike! Atëherë i mallkova me themel, me rregull dhe pa harruar asnjë vuajtje të përbindshme e dinjitoze, sa ta meritojë të quhet vuajtje, që nga u 'pjekshin në hell' e deri 'u futshin të gjallë në dhë e u bëfshin pleh', të gjithë ata bojaxhinj të ndyrë që ma lyenin çdo ditë jetën me bojë të zezë. Jam e sigurt se as kisha katolike nuk dispononte një arsenal aq të plotë mallkimësh. S'jam penduar për këtë veprim. Me mua bota është tallur. Më ushqente me iluzionin e lumturisë

dhe, sa hapja krahët për të flutuar, ma shkyente qielin copa-copa përpara syve! Kjo ndodhi kur Stefani ndërmori hapin e parë serioz, i foli nënës së tij lidhur me fejesën që donte të bënte me mua. Unë sa nuk fluturoja, vetëm nga ideja që ajo më kishte hetuar një ditë me sy admirues në rrugë. Atëherë u plasi një sherr i madh në shtëpin, ku aspiroja të hyja nuse e t'ua lyeja parvazin e derës me mjaltë, dhe nëna e theu. Në të vërtetë ajo nuk i tha asgjë të re, bile historinë me Sokolin nuk e dinte, por presioni 'kë do marrësh, atë kurvickën që s'gjen karar me burrat e i fton vetë pa pikë turpi'..., e bëri copë-copë Stefanin, aq më tepër që, për dreq, edhe atje në mal unë e kisha ftuar vetë atë. Vinte tek unë, i shkreti, kthente mendje, shkonte te mamaja, gdhihej me mendje tjetër. Atëherë e preva mendjen dhe shkova takova nënën e tij. U vesha bukur, u rregullova me qëllim që ta shkelja me këmbë me paraqitjen time. E vërteta është se pamja ime e goditi atë grua esber. Tamam sustë çeliku! Sa ia hiqje dorën, shkonte në pozicionin e parë!

- Po mos dëshirosh, ti, - i thashë, - unë nuk fejohem me djalin tënd, vetëm 'kurvickë' mos më shaj, se po të isha ashtu, edhe të tundje këmbët ti, unë do të vija këtu si nusja e djalit!...

Ajo u bukos, më pati bërë leckë, dhe nuk më njihte as për portret! Por i paturpshmi s'ka turp, fle si qingj, se nuk e vret ndërgjegjja. Edhe ajo e vazhdoi me entuziazëm përpunimin e Stefanit. Filloi zhdukja e tij, por mua kjo gjë nuk m'u duk më si tragjedi. Prapa diellit vaftë, thashë me vete, s'jam bërë akoma për sevap!... Më mërzisnin vetëm fjalët që gëlonin nëpër qytet dhe ai karakter prej burreci i Stefanit. Ndërronte edhe rrugë kur më shihte nga larg! Një ditë e mbërtheva në një bërryl rruge.

- Pse trembesh e ndërron rrugë? - i thashë, - Unë nuk jam leproze! Po të duash mos hajde, po, të lutem, më lajmëro, që mos shoh ëndrra me sy hapur. Tani, do vish më apo jo?

- Jo! - ma ktheu me gjysmë zëri. - Vetëm dije se të dua...

- Faleminderit, - i thashë, - më bëhet qejfi.

Dhe u tregova e sinqertë. I thashë, më bëhet qejfi, se dua ta kuqto shqip që, po përfille opinionin e rremë, po e mbolle, prashite e ujite atë, po e bëre si vijat e bardha të rrugës, kështu do vuash dhe s'do kesh kurrë tënden jo atë që të pëlqen e që e do, por as veten tënde, o i shkretë!

Ika. Iku dhe ai. Shkoi, piu, u bë tapë dëshmi përfundoi duke u qarravitur në repart. Atje u rrëfye. Salvadorja e imiton, të vdesësh fare, qarjen e Stefanit për tragjedinë e tmerrshme që i paskësh ndodhur. Salvadoren atëherë nuk e njihja as për portret, por e njoha pasi i kishte thënë Stefanit në mes të repartit:

- Ti e deshe gruan për vete, apo për ne? Po ta deshe për ne, pse i hyre valles? Në qoftë se atë deri tanë e tregon me gisht gjysma e qytetit, ngaqë paska ndarë të fejuarin e me demek s'ua... legenëve, tanë edhe gjysma tjetër do ta hapin gojën si qefulli budalla mbas shiut!...Ke bërë krim, t'u bëfsha! Në shtëpinë e të varurit nuk përmendet litari!...

Atëherë mikë im i panjohur punonte në kombinatin e drurit. Duhej të ishin një 50 punëtorë në atë sallë të gjatë gjithë tallash druri që m'i ngulën sytë pa folur fare me të shkelur unë në repart. Mes atij grupi të heshtur ndodhej edhe Salvadorja.

- Unë jam, - doli nga një cep pasi pyeta për të.

- Unë jam Ana Lika, - i thashë, - erdha të të falenderoj për ato fjalët e mira që ke shprehur në adresën time. Faleminderit!

Dhe e kapa në qafë në mes të punëtorëve. Nuk kisha ndërmend ta përqafqoja. Shkova vetëm sepse ndjeja një detyrim shpirtëror ndaj njeriut të parë që më mbrojti me logjikë, pa më njohur fare, ndërkohë që edhe të njohurit me mua më përcmonin e më bënin leckë. Për dreq, nuk i mbajta dot lotët. Bëra të shkëputem e të ik nga sytë këmbët, kur më pushtoi si oktapod Salvadorja e s'i ndahesha dot.

- Prit, - tha, -mos qaj se iu bëhet zemra mal legenëve. Rri merr veten sa të të sjellim një kafe...

Një burrë i thinjur e ndjeu se s'ishte punë për hajët të

rrinte e të priste kafenë duke qarë faqe 50 burrave një vajzë në moshën time. Ai më mori për qafe me një dashuri, o zot, më shumë se prindërore, dhe më futi në dhomën e vogël të shefit të repartit. E urdhëroi Salvadoren të hidhej një vrap deri në klub për kafenë, pastaj m'u ul përballë dhe priti sa m'u fashiten dënesat.

- Mirë bëre që qave, - më tha, - e nxore dufin. Po mos e merr me kaq malore e lot punën. Ti je vajzë me shkollë, ke katër palë këmbë e duar, sy e vesh, ke gojë... Po vure ulurimën ti, ne të tjerët duhet të vrashim veten, apo jo? Jeta jote as ka filluar e jo më ka mbaruar! Kurse ti qan, sikur more vesh rastësisht se pas dy muajsh do japësh frymën e fundit. Në jetë ka fatkeqësi më të mëdha. Ç'do bësh ti po të ranë ato në kokë? Mua më vdiq djali 25 vjeç, më iku kot fare, dhe gjashtë orë para se të ikte më la amanet mos t'i vishnim kostumin e ri kur ta përcillnim për atë botë. Mbaje ti, më tha, se ti duhej ta qepje i pari në shtëpi... Ti je e gjallë, vajza ime, s'ke nevojë të lesh amanete!...

Atë ditë them se fitova jetën, se, të betohem, isha aq e mërzitur, sa mendja më rrinte në plazh. Thoshja me vete, të shkoj në plazh, të futem në det, të notoj vetëm përparrë e mos kthehem më në breg. T'ua bëj edhe peshkun më të shijshëm atyre plehrave që nuk u ngopën duke më sharë me sytë e mi, që, me demek, do m'i hanin peshqit kur të mbentesha!...

Koha e tashme

Pas asaj bisede me zemër të hapur ne qamë me ngashëri-
me të mbytura të dyja, ia pimë lotët duke u përqafuar
shoqja-shoqes dhe u bëmë motra. Të paktën, unë e shpreh
me bindje se nuk desha njeri më shumë se ajo. Kishte filluar
plotësisht sezoni i shirave dhe zakonisht rrnim të dyja
bashkë thuajse gjithë pasdreken të ndryra në apartament.
Dilnim pak, luanim e talleshim si fëmijë me njëra-tjetrën.
Herë na kapte qejfi të mbillnim lule, mirépo të shumtën e
rasteve ose i mbillnim jo në atë sezon që kërkonin ato për
të mbirë, ose i ujtnim më shumë nga ç'duhet, ose bënim
pikërisht një kundërshti tjetër me recetën e lules dhe hiqnim
dorë shpejt nga ky pasion. Ana tallej: ‘na janë tharë ndjen-
jat, prandaj s’mbijnë as lulet pranë nesh. Ne rrezatojmë
antijetë!...’ Kurse unë kérceja përpjete, nuk e pranoja
akuzën. E kanë fajin ato helmet e kombinatit tënd, i thosha-
ja, nuk e ke parë që me t'u kthyer era në drejtim të qytetit,
lulet gdhihen të thara në ballkon?... Po, pranonte ajo dhe
shtonte mendueshëm: një investim i shoqërisë do t'i zhduk-
te helmet, do t'i shpërndante, bile do t'i kthente nga vdekja
në jetë, do t'i përpunonte e do prodhonte vlera që do ta
rrisin prodhimin shoqëror... Rëndom, pas dialogëve të
tillë, e hetoja me bisht syri portretin e saj të mërzitur. Për
ç'helme bënte fjalë vallë? Dyshoja se bënte aluzion për të
keqen që ruan si rudiment njeriu, për atë të keqe që e bën
atë të ecë së prapthi. Duke e kujtar tanit Anën, duke
mbledhur e restauruar vështrimet që i hidhte ajo peizazhit,
tymrave, sendeve, gjithçkaje jo frymore, unë them se Ana
ruante një fuqi të jashtëzakonshme animizuese, si çdo njeri

me halle mbi shpinë, që është i dëshiruar t'ia qajë hallin kujdo e të shohë me sy mosbesues çdo njeri e send.

- Ti, Ana, ke frikë nga njerëzit? - e pyeta pak kohë para se të sëmuresha.

- Po! - m'u përgjigji.

Dhe nuk shtoi asnijë fjalë.

Sikur ta pyesja përsëri, të gërmaja në përgjigjen e prerë, jam e bindur si buka që ha se do të më përgjigjej thatë:

- Ne kemi biseduar një herë në fillim!

Sot rri e mendohem, bëra mirë apo mëkatova që nuk e hapa më bisedën e jetës së saj, sepse rrëfimi e lehtësoi përkohësisht Anën dhe seç i ndezi ca drita nën lëkurë. Dera jonë filloj të hapej dhe ajo zymtësi e zezë sikur u shporr. Na vinin herë pas here miq, herë vëllai im, herë Salvadorja dhe më shumë fqinjët. Pastaj na erdhi një piktor i njohur nga Tirana, që po kryente lejen krijuese në qytetin tonë. Ai u njoh me Anën në fabrikë dhe iu lut t'i pozonte për një portret. Ana nuk ia prishi dhe piktori filloj të na vizitonë herë pas here pasditeve. Nuk ishte njeri i bezdisur, qëndronte me masë dhe nuk e nxirrte menjëherë lapsin. Qejfi i tij ishte të kruante kokën me treguesin e dorës së majtë, të rrinte këmbë mbi këmbë dhe të debatonte me ne për rrugën që duhej të zgjidhët njeriu në jetë. Ai ishte në emëruesh të përbashkët me ne, siç shprehej Ana, përsa i përkiste ekzistencës së një mefshtësie të qëllimitë të drejtoreve, botuesve e të tjerë firmosësve të vegjël ndaj përkrahjes së të resë, por ndahej te lufta e njeriut. Ne ngulnim këmbë se njeriu vdes po nuk u përkrah, ai ngulmonte se individi i talentuar mund t'i imponohej shoqërisë. Kur piktori ikte, unë qeshja:

- Ky nuk duhet të jetë piktor! Ai as e nxjerr lapsin e as e kam dëgjuar ndonjëherë të flasë për pikturen! ...

Por piktori kishte huqet e tij, studionte tipin e zgjedhur për t'i bërë portretin, nuk ikte derr në thes. Një të shtunë pasdite Anës papritur i kërcyen xhindet me të dhe filloj t'i bërtiste me një logjikë gati të shkalafitur. I shpërthyen xixa nga sytë, a thua e kishte armik piktorin, kur i ulëriu mu në hundë:

- Ti ia fut kot! Ku ka individ të imponohet? Mediokrit, po i fale pushtet, të merr shpirtin, ti më thua individi ... Apo e ke fjalën për ata individë që i marrin nën mbrojtje të fuqishmit? - e ktheu me ton ironik ajo. - Ata që marrin në telefon: filanin e kemi piktor të mirë, e kam edhe unë mik ... Filantropisë bota nuk ia ka parë hajrin dhe e ka bërë dalje me kohë. Një njeri që disponon aq pushtet sa të ushtrojë filantropinë, më mirë le të vrasë mendjen se si duhet të përkrahet e të nxitet të funksionojë me rendiment maksimal çdo talent njerëzor!

Piktori heshti. Ia nguli sytë i menduar dhe e pyeti si në tym:

- Ashtu?

- Ashtu! Pse, ç'mendon zotrote? Jetën e drejton lapsi, jo llafet. E drejton ekonomia! I ke parë ata limonët e kalbur që nuk i hanë më as derrat? E di pse janë kalbur? Se nuk i shtrydhi njeri t'ua marrë lëngun që të bëhet shëndet! Edhe njeriu si limoni është! Plot me mend e ka kokën! ...

Të nesërmen piktori erdhë i ngarkuar me kavaletin, e vuri në një skaj të kuzhinës, nxori tavalocin dhe filloj nga puna. Iu lut Anës të vishte një bluzë bojëqielli dhe i kërkoj t'i pozonte në këmbë, me shpatulla mbështetur në mur. Dielli luante përmes perdes në bluzën e saj. Krijonte një njollë të bardhë përpëlithëse. Piktori foli edhe një herë, kur iu lut asaj ta sillte nëpër mend debatin e djeshëm, pastaj s'foli më. Punoi me ngulm deri në drekë dhe thuaj gjithçka përfundoi. Ne u mrekulluam kur e pamë portretin. Ai e kishte zhveshur Anën nga gjërat e parëndësishme të saj. Në portret kishte mbetur vetëm thelbi i Anës, guximi dhe qetësia, çlodhja dhe gatishmëria për t'u rinisur përsëri. Ajo njolla e bardhë në krahëror, pranë zemrës, në sfondin blu të bluzës, ishte kthyer në një pëllumb paqeje dhe dukej se, po t'i hapte krahët, do pushtonte gjithë trupin e saj. Ne iu lutëm të hante drekë me ne dhe piktori, i raskapitur befas, nuk na e prishi. Se ç'mendonim për të gjatë vizitave pasdite, unë ia thashë kur po hanim drekë. Qeshi ngadalë dhe po aq ngadalë, si njeri që i merr shtruar-shtruar gjërat, tha duke copëtuar thelën e mishit:

- E dini? Një herë kam ngelur për vjeshtë, kur isha student në Institutin e Lartë të Arteve. Ngela në praktikën mësimore. Atë vit praktikën ishim ngarkuar ta bënim në stabilimentin ‘Mihal Duri’. Duhej të piktureonim tipa punëtorësh. Mua që në fillim shkoi e më ngjiti shpirti pas një kali që transportonte letër me një karrocë. Ai kali ishte plak, mezi lëvizte dhe të krijonte kushte pune ideale. I bëra mbi 100 vizatime! Kur m’i panë pedagogët vunë duart në kokë. Një muaj këto ke bërë, më pyetën të tmerruar. Këto, ua ktheva. Po punëtorët ku i ke, më thanë, dhe meqë unë ngrita supet, më këputën një dysh! ... Kështu ngela për vjeshtë! ... Kur shkova gjatë gushtit prapë në stabiliment, ai kali qe zhdukur, dhe unë kalova klasën ...

Ne qeshnim me të madhe.

- Edhe me ty prandaj nuk e nxora lapsin, - iu kthyen piktori Anës, - mediokrititet bëhen pa njohje, me një të rënë kuturu të lapsit. Ja, në fillim, mua më ngacmoi një punëtor. Eshtë një Ana Lika këtu, më tha, pse nuk i bën asaj një portret? ... Pse, e pyeta ... Si pse, ma ktheu, është e bukur! ... Si e bukur, e ngacmova më tej ... E bukur, pra, filloj të përtpej ai, pastaj i vuri menjëherë kapak: është njeri! ... Dhe unë vendosa të piktuoj portretin e quajtur ‘Ana’! Tani që njoha Anën mirë, - m'u kthyen mua, - them ta titulloj portretin ndryshe ...

- Konkretisht? - pyeti Ana.

Ai ndezi një cigare, pastaj tha duke parë rrathët e tymit që fluturonin ngadalë, si disqe, mbi kokat tonë:

- Kantatë për njeriun! Ti nuk e kishe keq dje, - shtoi, - edhe unë jam brenda logjikës sate ...

2

Piktori futi një fryshtës në apartament. Ishte si punë stine, ai njeri! Sikur u ajrua me themel gjithçka e dukej sikur dielli ishte më diell. Iku vërtet, por ca kohë më pas ne lexuam duke klithur nga gëzimi listën e çmimeve të Konkursit Kombëtar, të botuar në gazeten 'Drita'. Ai kishte fituar çmim të parë në gjininë e portretit!

- Fantastike! - thirri Ana.

Dhe pak ditë më pas na erdhi një zarf nga piktori. Brenda ndodheshin dy kartolina me ngjyra të portretit, një njëqind lekësh dhe një pusullë e shkurtër: 'Pini për suksesin tim! Mos u dehni, se do shëmtoheni! Po erdhët në Tiranë më kërkoni në telefon.' Ana u mendua një hop me kartolina, kartemonedhë e letrën në duar, pastaj shkoi në dhomë, mori një kornizë me xham me fotografinë e saj, ia hoqi fotografinë dhe preu një karton të bardhë me masën e kornizës. Atje ngjiti fotografinë e portretit, kartmonedhën dhe letrën e piktorit. I vuri në kornizë, pastaj i vari në mur, duke më pyetur:

- Të pëlqen?

Unë e putha.

- Ky është kënd emulacioni! - deklarova, pasi u shkëputa prej saj.

Ajo qeshi e lumtur.

- Nuk e ke keq! Nuk më shkoi nëpër mend kjo gjë, ama, në thelb, prandaj i ngjita, që çdo njeri ta shohë e ta dijë sa i mirë është në qelizën e tij, po të dojë, natyrisht, të jetë njeri i mirë ...

3

Kështu, ngadalë, ndërroi edhe këndi i diellit me tokën. Nga qyteti filluan të teren shirat dhe era u bë më e ngrohtë e më e butë, a thua kishte filluar të frynte juga.

- Këtu vjen pranvera shpejt, - tha Ana. Dhe pshërëtiu. Më pikëllonin pshërëtimat e saj. Të rralla, vërtet, por mua pas tyre më shfaqej një Anë tjetër, jo ajo bukuri e fortë dhe kryeneçe përballë meje, por një vajzë e drojtur në karrocë paralitikësh. Shihte rrugën, detin, malin, por nuk i shkelte dot. Dhe pshërëtinte.

- Pse pshërëtin? - e pyeta.
- Kot! M'u kujtua babai. Ai thotë se në pranverë vdesin shumë njerëz ...

- Bëhen lule, - i thashë.

Tundi kokën.

- Po! Bile edhe njerëzit e këqinj ...
- Si e shpjegon shkenca ekonomike këtë? - u talla unë.

Qeshi.

- Fare thjesht! Mbi rrënojat e botës së vjetër ngrihet bota e re. Lënda e parë përgjithësisht të hyn gjithmonë në punë ... Njeriu, - ma ktheu talljen me tallje ajo, - kot mendon se një ditë ndahet ngajeta. Po erdhe në jetë, s'të lenë të ikësh më. Edhe kockat t'i bëjnë pleh!

I iku zymtësia e çastit dhe u bë e gjëzuar.

- E di, - më tha befas, - sikur të bëhesha drejtoreshë e kombinatit të drurit!

- Ti, drejtoreshë? - qesha me të madhe.
- Po! S'ta mbush syrin? Do bëja cudira, ca vjet. Ai kombinat drejtohet pa mendim ekonomik. Kolori përdoret

si tavolinë pér tē ngrënë bukë ... Ka rezerva fantastike pér tē shfrytëzuar! Mund ta trefishosh prodhimin e ta dhjetëfishosh llojshmërinë e produkteve pa bërë asnje investim serioz, vetëm me ca pakësime tē fuqisë punëtore ...

Pastaj ia hyri shpjegimeve tē hollësishme. S'qemë futur kurrë në biseda tē tilla dhe mua më habitën mendimet e saj. Kisha përshtypjen se ajo pak interesohej pér ç'nuk ishte e saja.

- Po mirë, ti pse nuk e propozon këtë organizim pune?
Tundi kokën.

- Ne paguajmë edhe kur punon në kuota minimale. E kush i do telashet? ... Leku qyl është i embël!

- Bëj një artikull në gazetë!

- i thashë. - Në qytet ka ardhur me stazh partie një gazetar i fortë i 'Zërit të Popullit', Agim Kika. Erdhi një ditë në muze, Markun sikur e piu dheu, u zhduk ...

Ajo tundi kokën me shpërfillje, siç do ta tundte edhe tre vjet më vonë, kur tē më fliste pér fatin e fejesës perspektive tē saj, dhe u ngrit tē ujiste luleshqiponjën me gjethë tē orientuara drejt diellit si duar tē stërmëdha drejt zjarrit në oxhak. Mbushi një shishe me ujë dhe kur unë u bëra gati ta pyesja se ç'i kushtonte ta takonte një herë Agimin, foli pa e shkëputur vështrimin nga vazoja e luleshqiponjës ku varej ngadalë një curril uji:

- Edhe ai shkrimi më duhet mua! Edhe atë kam mangut!

- Kot, ëë, - e tora muhabetin unë, - nuk po tē bëj politikë, ëë, por, po nuk shkruajte ti, në rastin konkret, që e njeh një dobësi në themel, pse pretendon tē shkruajnë tē tjerët?

- Këtë e dinë dhe tē tjerët, - ma preu shkurt, - tē paktën e dinë edhe punëtorët deri në nivelin intelektual të Salvadores.

- Po pse heshtin, - e pyeta e shtangur.

- Nuk duan t'i hapin telashe vetes!

- Po kështu ne e stërvafërojmë veten tonë!

- As që diskutohet! Po kjo është një varfëri e keqe, graduale, që nuk ndihet menjëherë, e pranueshme. S'e merr vesh si nisin tē mungojnë gjërat, bile.ambientohesh tē

jetosh në mënyrë tepër modeste. Kurse qepja e drejtuesit pas teje me gurë në trastë është rrënim i menjëhershëm! Dy metra afër, duke vadir lulen, e ke shembullin më domethënës!

M'u mbyll goja. Kështu u pre ajo bisedë. Shumë kohë më pas, kur ne na thirrën në hetuesi pasi denoncuam për ofendim publik Markun, unë u acarova me hetuesin, që ishte një megaloman kokorroç me një tufë çelësash në dorë, si gardian burgu. Atij dukej nuk i pëlqeu ftohtësia jonë dhe shpërfillja e shumëzimi me zero që i bëmë figurës së tij monumentale, e cila pretendonte se kishte fatin tonë në dorë, dhe mbrojti hapur Markun.

- Nuk ka dëshmitarë që ta vërtetojnë akuzën, - tha me ton përbuzës.

Atëherë mua seç më luajti një damar pas qafës dhe i bërtita pa e çarë kokën hiç:

- Po ti, kur nuk dënon dot ata që vjedhin dinjitetin e njeriut, kë dënon, ata që vedhin 10 lekë? Na, - i thashë duke hapur me rrëmbim portofolin, - po t'i fal unë jo dhjetë lekë, po njëqind!

Dhe ia flaka kartëmonedhën në tryezë. Ai u tërbua.

- E di ç'të punoj unë, - ulëriu, - të fus brenda!

- Të jetë për ty, - ia ktheva, - rroj njëqind vjet pa frikë!

Ai e ndjeu pafuqinë për të vepruar ndaj meje dhe bërtiti i xhindosur:

- Përashta! Dhe unë dola duke e përplasur fort derën, sa do të ketë fluturuar patjetër ndonjë copë suvaje si fishekz-jarr para surratit të tij. Më kishte ardhur shpirti në majë të hundës me ca njerëz me dy gram pushtet, që i gënjen mendja se kanë fatet e njerëzimit në duar. Kur më thirri shefi i hetuesisë dhe filloi të më pyeste me zë të akullt pse kisha fyer hetuesin, nuk ndieja frikë. Bashkë me Anën takuan paraprakisht prokurorin e rrëthit, një 30 vjeçar indiferent në dukje, dhe ai, si na dëgjoi pa na ndërhyrë, më tha si duke fishkellyer:

- S'ka ç'të bën hiç! Ai të ka fyer ty me qëndrimin ironik!

Nuk më pëlqeu akullsia e zërit të shefit të hetuesisë, m'u

duk tepër ofendues për mua dhe vendosa të mos i lëshoj pe.

- Mua më dhimbset Atdheu, - i thashë, - kurse atij vartësit tuaj kam përshtypjen se aspak

- Si, si? - pyeti ai i habitur.

- Kontradikta jonë, - ia nisa unë, - qëndron në horizontet deri ku duhet të shkojë puna e hetuesit. Për shembull, unë mendoj se po u drejtua keq një kombinat, është më e leverdisshme të ketë prioritet hetimi i mënyrës së drejtimit të kombinatit, se sa i një hajduti ordiner që vjedh dhjetë dërrasa. Mendoj se fytersi i dinjitetit njerëzor është më i rrezikshëm se huligani i vockël... Kurse ai hetuesi juaj mendonte të kundërtën...

Shefi e ktheu pllakën. Qeshi dhe tha me humor se unë isha një natyrë konstruktive.

Nuk po merrja vesh, tallej apo e kishte seriozisht dhe, për çdo rast, lëshova një fjali të dykuptimtë:

- Vdes për reforma brenda natyrës së sistemit!

Ai më ftoi për një kafe dhe atje, në klubin me tavolina të larta, ku pihej kafja më këmbë, më pyeti se si ishte tamam e vërteta e natës së incidentit me Markun. Ia thashë pa m'u dridhur zëri aspak.

- E dëgjoi njeri? - pyeti.

- Natyrisht, - ia ktheva, - ishte natë vonë. Rrezik se edhe te apartamenti juaj ka ardhur kënga!

- Po nuk ka dëshmitarë ta pohojnë denoncimin tuaj, - tha ai duke ndezur si me trishtim cigaren, - ata që e pohojnë flasin për një të dehur që këndonte me sa zë kishte në kokë një këngë patriotike. Unë nuk mund ta relatoj për ta burgosur një njeri që vuan nga sëmundja e patriotizmit, po e quaj!Jemi për reforma brenda sistemit,apo jo?-ironizoi.

Ra heshtja. Pastaj unë thashë shkoqur:

- Ama, ka hile në këtë mes! Ju e kuptioni si drita e diellit për ç'patriotizëm të fëlliçur bëhet fjalë. Merret vesh një orë larg se në ç'nivele të ndyra e poshtërojnë ca njerëz patriotizmin dhe atdheun... Ata na e bënë me hile, iu thanë njerëzve 'mos dilni dëshmitarë'. Por a ka reciprocitet? Edhe

ju mund t'ua bëni me hile, mund të nxirri dëshmitarë të rremë, por që në thelb do pohojnë të vërtetën!

Ai buzëqeshi ëmbël dhe më ra supeve si at shpirtëror. Nuk dukej nga ai takëm që iu del telasheve përballë. E kishte trupin qiri të drejtë! Më nuk e takova dhe Anën nuk e mbrojti.

- As prisja ndihmë prej tyre! - më tha Ana. - Kam kohë që nuk ushqehem më me iluzione!

Kur erdhi më pas një kohë që asaj i duhej të trokiste në dyert e zyrave të pushtetit, edhe pse vetë pushtetsat e ftuan tërthor, duke i çuar lajm se mjaft të vinte ajo vetë në dijeni Komitetin për problemin që kishte dhe gjithçka do të zgjidhej në çast, Ana nuk pranoi të shkonte. Unë lashë punën në Tiranë, mbërrita urgjent në apartamentin tonë dhe nuk lashë fjalë pa i thënë. Ajo më shihte pa ngjyrë, me përtesë dhe pa gjallëri sysh, si ata njerëzit në prag të vdekjes, ndjesi që m'u forcua edhe më ngaqë e folura i mori ngjyra dialektore:

- Jo! - ma preu, - E mori xaxareja këtë punë!

Ishte çame, por s'e kisha dëgjuar kurrë të përdorte qoftë dhe një fjalë të vetme çamërisht. Atë ditë më trembi me atë ‘xaxareja’... E mori xaxareja... Vetëm kur troket vdekja njeriu kthehet me shpejtësi në origjinë, ndoshta për të kërkuar ndihmë shpëtimi nga njerëzit dhe dheu që e duan, sepse e kanë gjakun e tyre. Ndoshta... Unë sot them se Anës prej kohësh i qenë qepur me gurë në trastë disa njerëz të dobët, që kanë ëndërruar në vazhdimësi ta shohin në shtratet e tyre. Atëherë, kur na këndoi Marku nën dritare këngën patriotike ‘Eja, mblidhuni këtu!’, si një bariton i sprovuar, e pyeta Anën se ç’dreq inati kolosal ruante Marku me të.

- Ka pasur ca dëshira dhe ai, - më tha.

Koha e shkuar

Gjithçka ndodhi në mënyrë të rrufeshme. Një ditë marsi Ana u akuzua drejtpërdrejt si hajdute. E keqja qëndronte se ajo arriti e tha në një mbledhje të zgjeruar në kombinat se atje pritej një pyll për të bërë një karrige. Ishte mbledhje e brendshme dhe kushdo mund të diskutonte ashtu, por të këqijat kanë një unitet të çuditshëm mes tyre. Nuk vinë asnjëherë të vetmuara, por tufë! Fjalët qëlluan që ndezën zjarre dhe shkuan në vesh të gazetarit. Kur ai shkoi e takoi Anën në kombinat duke i kërkuar t'i jepte një intervistë lidhur me çiftin pyll-karrige, ajo e refuzoi në mënyrë kategorike.

- Të lutem shumë, - i tha, - mos ma përmend emrin në gazetë. Boll halle kam pasur deri më sot!...

- Po a mund të më ndihmosh me një bisedë, si konsulente, natyrisht, pa emër e pa e bërë fjalë me njeri këtë punë, - ngulmoi gazetari.

Ilegalisht Ana pranoi ta kryente atë punë, t'i tregonte gjithë ç'dinte gazetarit e ta orientonte se çfarë ndryshimesh mund të sugjeroeshin. Shkrimi u botua një të dielë dhe, megjithëse emri i Anës nuk figuronte kund, fatkeqësisht titulli i artikullit 'Pritet pylli për një karrige' ishte nxjerrë nga fjalët e saj. O zot, si ajnë njerëzit! Me llapat e veshëve të shpuara. Në çast e varin inatin vëth në vesh! Që ta kenë kudo qofshin me vete!... Pa u mbushur muaji nga botimi i artikullit, ata e akuzuan Anën për hajdute!

Bëhej fjalë për një falsifikim urdhër-shërbimi. Ajo erdhi me një pamje tmerrësish të lodhur në apartament. Një vit më parë kishte qënë tri ditë me shërbim në Durrës. Akuzo-

hej se shërbimin e kishte përdorur për të bërë qejf në Tiranë, kurse në Durrës s'i kishte shkelur këmba asnje minutë. Ana mund ta faktonte qëndrimin e saj në Durrës gjatë ditës. Ishte kthyer çdo natë të flinte te halla. Por rraskapitjen ia jepte tjetër gjë.

- Këta po më paralajmërojnë, - tha me ton të hidhur, - i kanë nxjerrë shpatat sheshit!

Pastaj qeshi, ose, më mirë, u ngërdhesh me mundim.

- Sikur të kisha gabuar diku, këta do ma kishin protokoluar në ndonjë dosje dhe sot do ma bënин gropën!

Unë s'flisja, sepse m'u lidh gjuha. Memecëroja. Befas asaj i hypi një inat i lebetitshëm:

- Ç'iu kam bërë! S'dua as lavdi, as honorar! Për mirë folia! Dhe prapë i ruajta, nuk e dhashë intervistën me emër! Po kanë frikë se mos u fluturojnë veturat, qejfet, servilët, wik-endet...

- Ana, - u përpoqa ta qetësoja, - mbylle gojën! Mos fol! Mos...

Më shtyu egërsisht dhe unë përfundova përmbyss mbi tapet.

- Nuk punoj dot kështu! Nuukkk puunoojj doottt!

Pastaj po aq papritur e uli zërin.

- Pse duhet të ruhet njeriu, - dënesi, - s'ia kam patur kujt me të keq... Pse u dashka të gërmohet në jetën e tjetrit si hapës varresh!

Ja, kështu tha, si hapës varresh!

Gjithë ato ditë ishin të tensionuara. Salvadorja rrinte më gjatë tek ne dhe ai mendonte se përsëri ishte dora e Markut në këtë mes.

- Vetëm mos më daltë në shteg! - u betua Ana.

Salvadorja qeshië ëmbël. Ishte i çuditshëm! Kështu, me kaq ëmbëlsi joshëse ai qeshte pikërisht kur bëhej gati ta rrënonte tjetrin. Dhe unë nga ai mbasë e kam trashëguar instiktin e të qëndruarit larg njerëzve që qeshin ëmbël. E ëmbla të génjen. Ajo që duket e ëmbël jo rrallë del të një idhësi, që mos ta marrësh veten për nja një javë të mirë! A ka gjë më të dyshimtë se premtimet apo fjalët e bukurë?

**Edhe Salvadorja, shkumbëzues deri në palcë, qeshteëmbël
dhe thoshte me një zë ëngjëllor:**

- Mos ki merak, Ana! Do t'i vijë rradha Markut, mos i
paça vajzat, unë do ta bëj atë ta mallkoj ditën kur e lindi
nëna, ajo katolikja që rrëfehej tre herë ditën te prifti, por
s'dinte ku binte në kishë vendi i rrëfimit!...

Ana këmbëngulte që Salvadorja t'i linte betimet e të
tërhiqeç veç, se me Markun do merrej ajo vetë. Në të
vërtetë, Marku do ta gjente nga unë. Po këto punë kështu
qënkan. Nuk mund të parashikohet dot se cili polic do ta
kapë hajdutin. Dhe me Markun risku më qëlloi krejt papri-
tur mua.

Radioja jonë, e heshtur ca kohë, tani i rifitoi fuqitë dhe
mua, sa herë zgjoheshë natën nga gjumi, më vinin në vesh
copëra melodish. Çuditërisht gjithë ato ditë radioja trans-
metonte muzikë sinfonike. Mua më dukej si funebre. Kurse
Anës nuk i dukej funebre. Eshtë klasike, më thoshte, varet
se si e interpretion ... Mua më trembte kjo logjikë e saj.
Duket funebritin e mendonte dhe e ruante për hakmarr-
jen e madhe!

- Kaq shumë e urren Markun? - e pyeta papritur një ditë
pas një dialogu mbi muzikën funebre e klasike.

- Ta shoh varur, nuk ngopem! - më tha.

Kështu erdhi prilli, më i ngrohtë se zakonisht, ne veshën
rrobët e banjos dhe zbarkuam në plazh. Ajo pasdite e parë
e çeljes së sezoni të plazhit ishte vërtet e bukur, aq sa mua
m'u mbush mendja se njerëzit e kishin rigjetur dashurinë
njerëzore, se ne askush nuk dëshironte të na shikonte me
sy të keq. Një të shtunë, kur unë erdha në Tiranë, im atë
më mori veç.

- Kam dëgjuar ca fjalë për atë shoqen tënde, atë Anën, -
më tha.

Një copë akulli sikur m'u shkri në peshkun e kurrizit.
M'u duk vetja e mjerë, si ajo fëmija, nxënësja e studentja
e papushtet në këtë shtëpi. Qava nga inati e pafuqia ime
dhe ia shpjegova me ngjyra idealiste gjithçka mund t'i shp-
jegoja për Anën, jetën e saj, armiqtë e saj. Ai më dëgjoi

me durim, më besoi ose u hoq sikur iu mbush mendja, por nuk deshte të rrezikonte as edhe një fije floku!

- Mirë, - i vuri kapak me tonin e tij despotik, që e trashte sipas rëndësisë së vetos që do të vinte, - por më mirë akoma është që ti të gjesh një apartament tjetër për të fjetur. Këtë herë do merrem unë me këtë punë!

Dhe meqë nuk ka punë që, po ia hyri ai, nuk ftillohet, unë e kuptova se pas një muaji ai do të më thoshte: 'Ema, mblidh plaçkat, ndahu me atë shoqen dhe do shkosh në ...'. Atë mbrëmje e kundërshtova për herë të parë babain:

- Shtëpi nuk ndërroj! Në qoftë se duhet të largohem nga apartamenti i Anës, interesohu të më tërheqë drejtoria e turizmit këtu me grupshoqëruesit e turistëve!

Ishte kundërshtim qesharak, si i atij frikacakut që i thotë hajdutit në pyll:

- Jo! Nuk t'i jap të gjitha lekët! Do mbaj tridhjetë qindarë për të blerë një biletë urbani! ...

Im atë e kishte menduar bisedën me mua të shkurtër, tip flesh, sepse për të asnjëherë nuk kishim pasur mend e të drejtë fjale. Më peshoi me sy dhe u ul ngadalë përballë meje.

- Dëgjo, - ia nisi duke i rrotulluar fonemat në gojë si kokrra tespixe, - di aritmetikë zotëria jote?

Nuk po e merrja vesh ku donte të dilte, aq më tepër pas asaj ironisë 'zotëria jote', që nuk parashikonte mot të mbarë.

- Humor po bën? - guxova e thashë.

Atij befas i shkëlqeu fytyra, a thua dikush ia tërhoqi lëkurën me sa forcë kishte.

- Di aritmetikë, ti? - më pyeti përsëri, këtë herë me nerva të tendosura, sa nënës i kishte hyrë tmerri nga dhoma matanë, prej nga përgjonte me ankth.

- Di! - ia ktheva.

Iu përgjigja me inat, do më thoshte të nesërmen ajo, dhe mua m'u mblodh zemra e u bëra grusht, se thashë se do të ngruhej e do të të shqepëtë në dru! ...

- Mirë fort! - tha ai.

Këtu m'u shkri gjaku, do më thoshte nëna, se deri pa folur yt atë, gjakun ujë e kisha! Ia paska mbledhur rripat çupa, përderisa po tregohet kaq i duruar ky xhind! ...

- Në jetë nuk ecet me zemër. - vazhdoi ai nofullashtrënguar,

- por me aritmetikë! Ashtu siç bëjnë një edhe një dy, dy plus dy katër, edhe ti duhet të mbledhësh plaçkat nga ajo Ana Lika! Ajo qoftë e kulluar, qoftë ëngjëll e vajzë ministri, në dashtë, unë nuk kam asnje punë me të. S'kam njëqind vajza, - ngriti zérin,

- që t'ua fal njëren fjalëve më të ndyra të botës!

Kur përmendi 'fjalët e ndyra', m'u drodh mishi, do vazhdonte rrëfimin e ndjekjes së bisedës tragjike ime më. Prit kur të thyejë ndonjë vazo! Po, shyqyr, desh zoti, s'theu gjë! ... Mos iu lut zotit pér dhjetë lekë, ia ktheva unë, lutju tamam, se s'ka as lezet ... Se nuk të dhimbet dhjetëlekëshi, pa do mbetesh bythëjashtë, më tha ajo. Paranë e sjell qerrja dhe e ha luga! E bën naaa, byk! ...

- Atë shoqen tënde nuk e do njeri, - u gëlltit im atë,

- e quajnë ... ashtu! Edhe ty, që më je bërë motra e saj, ashtu do të të quajnë, në mos të kanë quajtur! Ti je 24 vjeç, nuk ke kurriz të mbash hallet e kësaj bote! Më dëgjo mua, mos shiko hallet e të tjerëve se as mos të të gënjejë mendja që do gdhihesh ndonjë ditë pa telashe! Edhe kur të vdesësh, do lesh halle mbrapa, se vdekja nuk të pranon të ngarkuar me halle!... Mos sot, nesër do martohesh e do të ikësh nga Ana, apo jo? Unë them të ikësh sot, të martohesh dhe pastaj, në dashtë ai që do të të marrë (pikërisht, kështu u shpreh Lekdukagjinisti!), ktheu dhe rri përgjithmonë tek ajo! Mendohu sonte dhe nesër në mëngjes dua përgjigje! - e mylli bisedën babai.

Kurse nëna do hynte në dhomën time majë gishtave në mes të natës, sa do më tmerronte kur do e shihja, dhe do më lutej përgjérueshëm: Aman, se mos na bën ndonjë proçkë nesër! Ja, nuk më sheh mua? Gjithë jetën e kam dëgjuar dhe s'më ka hyrë ndonjë gjemb në këmbë! Vetëm sherr mos na dëgjofshin veshët! Ku ka shoqe sot, moj Ema,

do më thoshte ajo qetësisht gjënë më tragjike, sot ka thika pas kurrit!...

Doli që edhe ajo edhe pragmatisti dukagjinist kishin të drejtë. Kur unë u dashurova me Ilirin dhe shikoja ëndrra me sy hapur se si do martohesha me të, ai qe nisur për një ndërrim gjelle me mua! Pa qënë nevoja që i dashuri im të interesohej se ç'përfqaqësonte figura ime morale, ishin interesuar të tjerët vullnetarisht për mua, prostin e vockël, siç më pati përcaktuar me përkëdheli prekëse një i panjohur në veshin e Ilirit. Vajzëria ime shkoi dhe vate në një dhomë të ftohtë të hotelit të Gjuetisë në Ishull të Lezhës dhe fatkeqësisht, kjo ngjarje e paharrueshme iku në mënyrë që s'të merr malli as ta sjellësh nëpër mend. Mua nuk më pëlqeу mënyra se si e sajoi atë histori Iliri, bile nuk do t'ia fal kurrë atë trajtim fyes, por pranova të futem me zemër të ngrirë në dhomën prej dërrase të krimbur të prenotuar prej tij pak nga turbullimi i mendjes prej verës së bardhë e më shmuë nga qejfi im beftë për t'iu dhënë tërësisht atij. Virgjëria ime e tronditi Ilirin, i mori gojën dhe ia transformoi portretin. Po të hyj tani në hollësira se ç'pamje mori ai njeri pas konstatimit se unë isha e virgjër, nuk mund të le pa përmendur një çaplim sysht, një gojë gjysmë të hapur në mënyrë idioteske , dy veshë të skuqur në një fytyrë të hirtë dhe një bëlbëzim si prej adoleshenti para vajzës që tenton më kot t'i thotë njëren prej fjalive më të shkurtëra në botë, 'të dua'... Pa pasur as më të voglën dijeni për ç'përfolje i ishte bërë figurës sime në veshët e tij, unë e mora atë për ndonjë tip të apasionuar deri në manjakëri pas teorisë se gruaja, ashtu si dhe plaçka e re, duhet të provohet për herë të parë se si është e se si qëndron te blerësi i saj, dhe nuk i vura shumë rëndësi shpartallimit të portretit të tij. Por, kur ai m'u zbërthyte plotësisht pas një jave, i verdhë, si filter cigareje të porsapirë, unë jo u zverdha si filtri, por u bëra dhé, si nikotina në qëndër të filtrit! U bëra e pagojë, meite, ndërkohë që ai hidhte me hurba të mëdha konjakun në gurmaz. Ia rrëmbeva gotën nga dora dhe e shkunda me fund.

- Ti më njohe tani, - i thashë pasi e mora veten nga përvëlimi i alkolit, - më vjen keq vetëm për Anën!

Por prapë isha gabuar. Duhej të mendoja më shumë për hallin tim, sepse vërtet kisha qënë virgjëreshë, por kjo pak rëndësi kishte për Ilirin. Ai më shihte pjerrtas dhe vriste mendjen si si i bëhej ta merrte këtë njoftim opinioni, përndryshe ‘prosti e vockël’ dhe... Mallkonte veten se pse u nxitua dhe nuk e la atë punë ta bënte natën e parë të martesës, që pastaj ne sabah të nderte çarçafët e lyer me të kuqen e virgjërisë dhe kështu t'i hakërhohej serbes lagjes e opinionit banal ‘a ma hani m... tani!’ Kurse unë e quajta lehtësish të myllur kapitullin tim dhe ia nisa mbrojtjes së Anës!

As sot e gjithë jetës nuk do arrij ta parafytyroj se deri në ç'gradë mund të jetë shpifur për atë njeri të mrekullueshëm, sepse e keqja është se për të arrinin të shpifnin edhe vetë të mrekullueshmit! Jam ndodhur jo shumë kohë më parë në një familje me shpirt poetik, me bibliotekë të madhe dhe pesë frymorë organikë. Rastësish atë mbrëmje televizioni transmetoi një film pakëz sentimental dhe frymorët e shtëpisë filluan të qajnë me rradhë. Në fillim ia nisi babai, një 35 vjeçar stoik në dukje, pastaj vajzat e infektuara nga lotët vrushkull të babait dhe në fund vuri kujen gruaja, një dentiste e bukur. Dhe fill pas përfundimit të filmit dhe fshirjes së lotëve, stomatologia arriti e më pyeti duke më parë m'u në bebëza:

- Aman, si durove dhe ndenje aq kohë me atë Ana Likën?

Ç'ti thoshja? I bëra qejfin:

- Njeriu i shkretë për të hequr ka lindur!

Nuk i thashë se njeriu ishte i shkretë dhe hiqte jo nga kategoria e Anës, por nga takëmi i saj. Kurse stoiku i saj qaraman më mori bujarisht nën mbrojtje. Ai ishte tamam intelektual:

- S'e mos e njihte Ema, - tha duke fshirë hundët mu në sy tim me shami me sa fuqi kishte. Si e kreua ritin që kishte ndër duar, futi shaminë në xhep dhe plotësoi serbes fjalinë e lënë përgjysmë nga ajo puna e rëndësishme e shfyrjes së qurrrave: Kur e njuhu, u nda!

Ja, kështu tha ai qurravec: kur e njohu, u nda!

Këto xhevahire, dhe të tjera të kësaj natyre, unë nuk i futa në illogari atë natë, kur e gdhiva duke menduar se ç'përgjigje duhet t'i jepja babait. Megjithatë, e kuptova se e mira do të ishte t'i ngrija leckat prej Anës. S'kishte kuptim të kundërshtoja dhe të dyluftoja si Don Kishoti me llafet e pazarit. S'kisha, gjithashtu, as më të voglën dëshirë që t'i hiqja telashet e Anës, që i njihja mirë, mbi kurriz. Më mirë po e ha turpin me bukë me Anën dhe po heq dorë nga heroizmi, vendosa, dhe në mengjes, pa pritur të dalë im atë nga dhoma, i shkova unë. Trokita në derën e dhomës, pastaj, si e hapa paksa derën, sa për të futur kokën brenda, i thashë me kokën në dhomë e këmbët në korridor, me një zë të qërruar e pa ngjyrë:

- Do bëj si më mësove ti, vetëm nuk di si t'i shpjegohem Anës.

Ai e lëshoi gazeten që po lexonte mbi brinjë dhe maktheu i lumturuar nga logjika ime me një zë tmerrësisht të ngrrohtë, sa mund të thekje bukën në të e që do t'ia kishte zili çdo lehonë:

- Deri sa ta rregulloj unë atë banesën tjetër, e mendojmë këtë punë me nge. Hë për hë, ti mos u ndje! Të gjejmë apartamentin e përshtatshëm, pastaj i kthehem këtij muhabeti...

Nëna se nga mbiu në çast me tre filxhanë kafeje në pjatancë. Me siguri kishte hetuar nga kuzhina bisedën dhe kishte bërë me ndërgjegjje të plotë harxhimin e madh, duke përdorur për të zjerë kafetë urgjent atë spiralen e vogël, që ne na e kishte ndaluar kategorikisht ta përdornim, që kur i erdhi fatura e qirasë një herë dy lek e shtatëdhjetë qindarka më tej se limiti i parashikuar si maksimal prej saj. E pimë kafenë bashkarisht, duke folur për gjëra të gëzuara, si njerëz që nuk persekuchohen nga asnje njollë mëkatit, por mua diç më gërryente brenda gjoksit, një ndjenjë faji e mashtrimi përzierë bashkë. Sikur më dridhej i gjithë trupi, aq sa nuk qëndroja dot në një vend. Më dukej se mëkatit im rëndohej edhe më shumë, ngaqë do t'ia fshihja vendimin

tim, ose, më saktë, dekretin familjar. Një natë, pa pritur gjetjen e banesës tjetër nga im atë, vendosa t'i hapem Anës. I rashë fare shkurt. Çuditërisht kisha një siguri prej të mefshti se ajo do të më përzinte që atë çast nga apartamenti duke m'i flakur çantat e plaçkat një nga një nga maja e shkallëve. Bile, kur po i thoshja se nuk kisha më forca për të dyluftuar me fjalët, po mendoja njëherësh se në ç'derë të trokisja për ta kaluar atë natë. Kurse Ana nuk më përzuri. Vetëm uli kokën dhe nuk foli për një kohë të gjatë. Kur unë guxova dikur t'i hedh një bisht syri, e kapa në kohën që ktheu kokën tinzash nga dritarja dhe fshiu po aq tinzash cepat e syve. E ndjeva veten keq, si vrasëse m'u duk vetja.

- Të lutem, - tha pa kthyer kokën, - mos ik tani! Ndoshta së shpejti të tërheqin në Tiranë dhe largimi s'do bjerë në sy...

Ajo heshti, pastaj vazhdoi po me atë ritëm të rëndë të foluri:

- E kuption sa më kushton mua ikja jote nga ky apartament në një tjetër? E kuption ç'do të thonë njerëzit? Edhe Salvadorja vetë do ma heqë vizën... Të lutem, shtyje ca kohë ikjen!

Nuk mund ta dëgjoja dot më. I mërmërita një 'natën e mirë' dhe ia mbatha në dhomë. Me t'u përplasur siç isha në krevat, më shpërthyen lotët. Në të vërtetë ato fjalë ishin dimensioni real i krimit që po kryeja unë kundër saj! E pashë përmes lotëve si u mbështet te parvazi i derës, pastaj, si erdhi pranë shtratit dhe si u hodh e më pushtoi edhe ajo duke qarë më keq se unë e duke m'u lutur mos ikja.

- Nuk do të iki! - i thashë papritur, - Nuk do të iki, edhe sikur ai të më përzëjë nga shtëpia!

Babai ma bëri më vonë këtë presion dhe jam e bindur se do t'i khente në realitet kërcënimet, po të mos druhej se braktisja e tij totale do të më kalonte mua automatikisht në kampin e femrave të dala dore. Unë isha kthjelluar befas, i kisha parë në fokus të plotë gjithë dimensionet e katrahurës që do të shkaktonte në jetën e Anës ikja ime

dhe s'ekzistonte më perëndi në Olimp të ma kthente mendjen. Kur babai më pyeti pse e ktheva pllakën aq shpejt, iu përgjigja seriozisht, megjithëse im vëlla më tha më vonë se mezi e kishte kapërdirë të qeshurën, se vetë ai më mësoi që në jetë nuk ecet me zemër, por me aritmetikë.

- Atë mëngjes nuk i bëra llogaritë mirë dhe t'u përgjigja me zemër, - iu shpjegova, - me aritmetikë më del se nuk duhet të ndërroj banesë, sa të jem në atë qytet! Në qoftë se largohem nga Ana, - i shkoqita fjalët sikur të kisha përparrë një shurdh që të kuption vetëm po të pa në gojë e kur flet ngadalë, - i gjithë opinioni do të shprehet kështu: e njohu edhe shoqja e ngushtë se ç'monstër qe dhe ... Më vjen keq, por nuk largohem dot! ...

Për herë të parë në jetën time e kam parë babanë të bukosur, a thua ia këputi dikush gjuhën deri në rrëzë. Atij nuk i fola edhe për dinjitetin njerëzor, për turpin e madh të braktisjes së njeriut dhe të idealeve të vvetves, për moslejimin e dhunimit të vetes nga këmbët e pistës të tjerëve ... Këto dhe plot virtute të tjera njerëzore unë i bisedova me Anën atë natë të rëndë. Mbaj mend që ajo më tha:

- Ta ruajmë dinjitetin, të vetmen pasuri që kemi!

Sot unë them me bindje se dinjitetin kam arritur ta ruaj. Dhe është vërtet e vëtmja pasuri e vyer që kam, megjithëse, - për fat të keq, nuk ka asnje vlerë materiale.

Përzierja e kohëve

Unë isha në shtëpinë time dhe nuk di ku bie kjo shtëpi. Dje ajo do të shembet nga themeli, ashtu siç do ta kenë ndërtuar sternipërhit e mi një herë e një kohë ...

Sa absurde do t'i tingëllonte kjo fjali mësueses sonë të gjuhës! Ajo ishte një grua e ndërtuar nga lënda e urtësisë, me sy të dhembshur dhe numërimin e notave e niste gjithmonë mbi pesë, por unë e di mirë se kjo fjali do të kthehej në goditje traumatizuese për të. Dora e saj do të drejtohej një çast të vetëm nga instinkti i trashëguar i racës njerëzore, dhe do të shkruante nën fletën e detyrës ku qe hartuar kjo fjali notën katër! Dhe brezat e nxënësve i linin njëri-tjetrit një porosi mesazh: po të vuri katër mësuesja e gjuhës, ik mbytu në liqen!

Pinim kafe në klubin e boshatisur në atë orë të mëngjesit. Ishim ulur pranë dritareve të mëdha me xhamë deri në dysheme, që të krijonin një lloj ndjesie pushteti mbi botën. Salvadorja vetë e zgjodhi atë vend ku binte me bollëk një diell i ngrohtë. Kthehej rrallë në muze, zakonisht kur reparti i kornizave mbetej pa dërrasa. Shkonte bënte porosinë në ndërmarrje, pastaj më thërriste nga rruga, kur hetonte se në oborrin e muzeut s'ishte parkuar asnjë autobus turistësh. Më kishin përcjellë sytë e palarë të Markut, si dy thëngijët në shpinën time, dhe befas më pat hypur një e kruar e tmerrshme në trup. Më kruhej shpina, beli ... Ishte shumë i poshtër ai njeri! Të vështronte poshtërsisht ... Zëri i Salvadores sikur m'u largua pak, humbi në një humnerë përhumbjeje, për t'u kthjelluar përsëri përmes atij trishtimi në veshët e mi. Po më përsëriste fjalët se nuk mbahej mend një gëlim i tillë i qytetit. Ana po thoshte ...

2

Ah, ç'Salvadore ishte ai! Unë i tregova fije e për pe se ç'ngatërrresë e telashe mund t'i hapnin Anës prindërit e mi, më saktë, babai, prita ta shkoqiste këtë lëmsh të ngatërruar me prakticitetin e tij, kurse ai i ra shkurt gjithçkaje:

- Pse nuk e merrni edhe atë gocën time të mësojë anglisht? Eshtë dreq! Vetëm mend ka! As ke për t'u lodhur hiç. Nuk ka nyje që ta marrin shpirtin ...

Zgurdulloja sytë. Salvadorja ishte marangos i mirë, peshkatar me nam i qefullit në gjithë zonën. Pinte verë e shtrohej klubeve për shtatë palë qejfe. Nuk ishte e lehtë ta kërkonte një diçka të tillë pikërisht Salvadorja, bile, unë isha e bindur se, po të më shkonte mua ndërmend, gjë që nuk do guxoja ta bëja, ta shtroja unë këtë kërkesë, Salvadorja vetëm 'jo' do të artikulonte me gojën e tij. Kurse ai ... Unë e dija se Salvadorja në përgjithësi e respektonte njeriun e zgjuar, por jo kulturën. Të kishe një zanat, kjo mbetej kultura e kulturave për të. Qindra herë e pata dëgjuar të përsëriste: mendtë e shumta, e keqja e të zot! ... Ai pëlqente pavarësinë e veprimit. Këtë ta fal puna, thoshte. Me qenë punëtor i mirë, s'të bie kush në qafë ... Dhe shih tani, Salvadorja! Por unë nuk e dija se deri në ç'masë i pëlqente pavarësia Salvadore, nuk e dija se ai pavarësinë e kishte perëndi dhe me atë mençurinë e tij bruto vriste pareshtur mendjen si mund të bëhesh i pavarur.

- Me gjithë qejf, por nuk po bëhesh pak liberal? - e ngacmova.

- Ne prandaj kemi ngelë mbrapa, - ma ktheu, - se unë edhe të qeshurën me zë të lartë e kam ditë për liberalizëm. Për nder! - u betua.

Dhe ra përsëri një heshtje e çuditshme në tryezë. Mendoja për Salvadoren, për vajzën e tij. Pak herë më pati rënë rasti ta hasja. Ishte e hajthme, me sy pak vëngëroshë, që Anës i dukeshin të mrekullueshëm. Duhej të qe rrrotull të 17-vë, por dukej më e vogël. Ndoshta nga hajthmëria. Ai frigoriferisti që dashuroi ajo më vonë tha një herë duke qeshur për të se, kur ia prekje belin, sikur të zinte korrenti. Duke qeshur ai tha një të vërtetë, ajo fërgëllonte e tëra. Të shihte si me turp, por Maria, kur i thashë se vajza ishte e turpshme, vuri buzën në gaz: Kush, ajo e turpshme? As emrin nuk ia di turpit! ... Ishte e vërtetë. Më vonë, kur e njobha mirë, pashë se ajo ironinë e vishte me petkun e turpit. Kur ti thoshe u skuq nga turpi, mendja e saj kushedi se ç'prapësi bluante. Eshtë spec djegës, thoshte Salvadorja, fut ca kunja të hollë, që mbas 24 orësh ia merr vesh ... Rrotullonte përhumbshëm filxhanin e verdhë mbi syprinën e kuqe të tryezës, mendohej me buzë të mbledhura, duke jetuar një tragedji reale, sikur po i kthjellohej pikërisht tan magjia e jetës dhe vriste mendjen si mund ta jetonte sa më shumë, mundësish maksimalisht, këtë realitet magjik. Ai ngjante pikë për pikë me gjyshin tim të babait, që e kyçi gojën dhe nuk foli më dy javë para se të vdiste. E panë që po fikej dhe i luteshin të gjithë me lotë në sy: baba, fol një fjalë! ... Ai memec! Më në fund i erdhi shpirti në majë të hundës e zorrët në gojë nga jargavitjet e tim eti dhe i tha shkurt, me gojë thuajse të myllur, si ata njerëzit me bajame të qelbëzuara: 'Hajvan! Nuk e kupton se po vdes? S'dua të harxhoj frymën kot!' Babait i vinte vdekja kur ia kujtonte nëna, ama kështu ka ndodhur! Nëna ime edhe sot e tregon historinë e asaj vdekjeje legjendare duke qeshur me lot. Edhe mua më qeshej tek shihja Salvadoren dhe kujtoja vdekjen e gjyshit. Kështu do t'i vinte vdekja edhe një herë nënës sime nga vajza e Salvadore, e cila do t'ia refuzonte me ëmbëlsi atë karamelen më të lirë që mund të gjendej të qerasjes, duke i thënë:

- Këtë karamelen, faleminderit, nuk po e marr! Nuk dua të mësohem keq! Nuk ka ku m'i blen baba pastaj ...

Sa gjëra pér tē qeshur e pér tē qarë do tē ndodhnin! Po kush i dinte? Ka ca njerëz që ngordhin pér tē mësuar se si do ta kenë tē ardhmen. Ç'duhet, o tē zes? Pér tē vrarë veten? ...

Salvadorja m'i nguli sytë dhe pushoi së rrotulluari filxhanin. Pështyu. Ishte hera e parë që e shihja ta bënte këtë veprim.

- Të lutem, - i thashë unë.

- Më fal, - ma bëri.

Pështyu prapë dhe më tha prapë ‘më fal’, megjithëse unë e pashë ç’nerva tē cingrosura kishte dhe nuk i fola.

- Ty s’ta pret mendja sa i mbrapshtë kam qenë! E mbytsha gocën e madhe po ta shifsha në rrugë pa lejen time! Vetë e martova, e dhjeva thuaj, që 16 vjeç. Tani është 22 vjeç, ka një tufë kalamaj, ka ngelë me sisë në dorë. Eshtë plak si lisat në kala e vetëm ‘si urdhëron’ di me thënë. Ka mbaruar ajo!... Kjo tjetra le ta bëjë vetë jetën e vet! E pati rraf burri atë tē madhen, e kishte bërë pér ibret tē zotit! Ma tha Maria. Shkova e pashë. Zgërlaq në banjë, lante rroba. M'u bë mishi kokërr. Ktheva në shtëpi dhe i thashë Maries: ‘atë e kam rraf unë, jo ai gomar që e ka në shtëpi! Të voglën mos e ngit e mos i rri si xhandar sipër kokës! Mentë i ka sa pér tre vetë e po iu lutem atyre gocave t’ia mësojnë anglishten...’ Maria ka frikë. S’ngrehet brenda ditës fëmija në këmbë, thotë, mos na bie e na thyen kokën... Ka doktorë sa tē hanë qentë, i them unë, s’e le Ana me Emën tē vritet!...

E dija që Ana ishte perëndia e Salvadores, por nuk e dija se ai mund t’i falej kësaj perëndie. Dhe kur ia thashë këtë, atij i kapërceu një damar i keq:

- A e di ti historinë e atij budallait?... Vjen një mirditor prej France i familjes së Markagjonajve, se ata e kishin paren e madhe e ia dijshin kimetin shkollës atëherë. Kishte bërë fëmija shkollën andej dhe u kthyte në Mirditë me diplomë e një barrë mend. U mblohdhën në Orosh në dhomën e burrave tē Markagjonëve pleq e burra zakoni dhe nisën tē pyesin shkollarin se ç'bëhej asaj France. Ai i

shkreti i bie drejt e drejt. Ka avionë që fluturojnë në qiell, iu tha, e me ta shkon për çerek ore nga Oroshi në Shkodër apo Tiranë. Ka rrugë të mëdha e makina, ka.. Burrat luajtën nga vendi dhe filluan t'i bëjnë shenjë shoku-shokut: ‘mos e ngisni, qenka kthyer budalla prej andej!...’ Budallë ia njiti i pari nofkën baba i vet! Të tjerët budallë, budallë, siç thotë Markagjoni... Studentit i iku fytyra. U falën miqtë e u ngriten duke ngushëlluar larg e larg babën e djalit për gjëmën. Atëherë baba e thirri djalin afër. Or bir, i tha, aeroplan kam parë unë 20 vjet para teje e kam hypur në t dhe s'kam kallxue, se nuk është mirë për ty e për mue e për fisin me ditë këta burra se në ç'botë jetojmë. Duan edhe ata pastaj të shkojnë për Çerek sahati në Shkodër! Me çfarë t'i çoj unë, me gomarin që bëj dru?... Ti je mbret! Mbret ka atje ku flihet gjumë! Po gjumi flehet me sy mylli e s'ka as mbret e as Francë e as qejf kur gjindja i ka sytë hap kokërr!... Mirë atij Markagjonit, ashtu ia lypte puna me fol, po unë, ç'dreq mbreti jam?!

I kërcisin nihembët në mënyrë të frikshme, i dilnin skajet e dhëmbëve nën lëkurë. ç'dënim po i jep vetes, Salvadore, sa nuk bërtita.

Turfullonte si kalë. E shtrëngoi filxhanin në grusht në mënyrë të përbindshme, iu skuq e gjithë fytyra nga shtrëngimi, sikur e kishte litarin në fyt e ia hoqën stolin përfund këmbëve. Më në fund u dëgjua një krokëllimë. E kishte thyer filxhanin dhe e lëshoi në tryezë.

3

- Salvadore, paske pi? - u hodh banakierja, mbasi dëgjoi kërcitjen e copërave të thyera në tryezë. - Paguaje atë filxhan që theve

Ai ia bëri me dorë ‘pusho!, pastaj u kthye përgjysmë nga banaku:

- S’kam pi, he të hëngërt dreqi, se nuk më janë hap sytë hala, po m'u kujtua një gjë e poshtër. Ta paguaj filxhanin, se nuk ishte prej ari!

- Mos bërtit! - ia ktheu ajo. - Kujtova se kishe pi. Po e theve esëll, shëndet u bëftë! Nuk i dua lekët!

E tërroqa për dore dhe ai u kthye nga unë duke mërmëritur diçka të përafërt se tani të mësojnë si të sillesh në rrugë edhe banakieret...

- Salvadore, - iu luta, - më trego pak për jetën e Anës këtu!

Më pa njëherë si të deshte të më blinte mendjen. Po nuk fshihja gjë. Ndjeħesha vetëm kurioze të dija më shumë për Anën. Dhe këtë ia shpreha që në pyetjen time.

Ai filloi të vizatonte me gisht suprinën e tavolinës dhe zuri të fliste ashtu siç po e vërtiste gishtin, pa e ngritur kokën:

-Ne nuk e njihnim në fillim kur erdhi të punonte këtu. Vit për vit vijnë djem e vajza të reja, vit për vit transferohen në rrethet e tyre dhe ikin. Po këtë e ngau bukuria e vet! Bukuria e madhe, e keqja të zotil!... Eshtë e bukur fort, dreqi! Dhe filluan të bulojnë llafet! I pari duhet të ketë folur një inxhinier që erdhi bashkë me Anën në qytet. Ai do ta ketë lëshuar gjuhën, se Ana ia bëri gropën atij! Ishte

pijanec. Punonte në bonifikim, po veç në klub e gjeje! I vinte rrrotull Anës ai zarbo dhe kur nuk i doli hesapi, e lëshoi llapën sheshit. Jo ka qënë e fejuar, jo ka qënë e përdalë... Ana nuk u ndje, veç asaj ditës kur ndodhi një përmbytje e madhe në rrethim tonë. I kapi gafil këta të bonifikimit, të nuk iu punonin gjysmat e motopompave. Erdhën me vrapi nga Tirana ca shefa e do bëhej ballafaqim i madh. Atë ditë Ana i doli përparrat atij inxhinierit. Kush dreqin e di si i qeshi e ç'i tha, veç ai e la mbledhjen e i ra mbrapa. Merre me mend se ç'skandal ishte! Këtu kishte ardhur vetë ministri të gjente fajtorin, kurse inxhinieri, bash ai që do të sqaronte gjendjen, u zhduk nga mbledhja si krimbi prej grepit! E shkarkuan në vend, e hodhën në gjyq dhe sot e kësaj dite ka ngelë me diplomë të grisme. Iku i pari. Po miletë është kamkum. S'i hap sytë dhe s've mend...

Salvadorja ndezi një cigare dhe pikërisht atëherë kur unë mendova se do zbërthehej plotësisht, e preu bisedën. Nuk e zuri në gojë njohjen e tij me Anën. Ndoshata s'deshi ta përmendte emrin e Stefanit. Më vonë unë u binda se për atë punë heshti. Njerëzit i deshte flori. I fërkonte fort, që t'ia zhdukte ndonjë papastërti të mbetur atje nga atmosfera apo duart e dikujt, që mos i shkonte mendja keq njeriu se ai flori ishte fallco, pare kallp, siç e quante Salvadorja.

E nxori tymin me rrathë, pastaj shkundi cigaretën në tokë.

- A e di? Ajo është fortë, di t'i dalë zot vetes... Megjithëse kërkush s'e ka çarë kokën për të e s'ia ka qarë hallet!...

- Pse, Salvadore? - e pyeta.

- Kjo botë jallane kështu është! - tha thatë. - Secili e mban vetë hallin e vet! Lere ç'thuhet! Halli nuk është bukë me u nda copa-copa. Nuk ndahet halli! Të ra, ul kurrizin dhe mbaje!

Unë e pashtë të përhumbur. E besoja realizmin e tij, por jo atë logjikë.

- O Salvadore, - i thashë duke rrudhur buzët, - mirë të ra halli, mbaje vetë, po ti, ama, mund të ndihmosh që mos t'i lesh të tjerët të mësohen të mbjellin halle tek unë, tek Ana, te Vera jote...

Ai m'i nguli sytë dhe u mendua një hop.
- Mbase s'e ke shtrëmbër, - tha me një frymë. - Mbase...
Megjithëse...

Kohë të përziera I Po them, kohë e tashme

Atëherë Ana shkruajti në një karton të madh atë vjershën e një poeti të panjohur kryeqytetas, që na e recitoi duke qeshur piktori ynë kur na vizitoi për herë të fundit, dhe e vari tabakun e kartonit te koka e krevatit. Vjersha njëstrofëshe ishte shkruajtur me ca gëрма sa një simite secila dhe pak nga madhësia e ca nga ngjyra e kuqe e bojës së përdorur për shkrimin e vjershës, mund të lexohej që në korridor edhe nga një fëmijë që porsa kishte mësuar Abetaren. ‘Ashtu si vietnamezët, thoshte vjersha, edhe unë nuk kam librezë kursimi. Atyre rrjedhjet bankare ua pret lufta, - mua - trishtimi!’

- O zot, - thirri Ana, - sikur e kam shkruajtur unë këtë vjershë!

- Mos u hiq si e trishtuar, - e kundërshtova, - ti mund të mos kesh librezë, për arsyen e thjeshtë se nuk ke asnjë qindarkë të tepërt, por, sa për trishtimin, unë njoh në Tiranë plot të kamur që nuk iu qesh buza kurrë!...

Nuk më pëlqenin të frynin erërat e trishtimit në apartament. Nga gjithë sëmundjet ngjitëse, më ngjitëse është trishtimi! Më në fund po na kaptonte kotja e qetësisë dhe, megjithëse më dukej ogurzezë, si bunacë, përsëri uroja të ruhej ajo paqe e qetësi që të bënte të mos hasmoheshe me jetën.

Ndjeja një frikë të turbullt mos bënte Salvadorja ndonjë skandal me Markun. Jo se më dhimbsej ai mistrec muzeal, por trembesha mos miku ynë ia këpuste syve në mes të rrugës. Atëherë Marku mund ta denonconte në polici dhe... zot, na ruaj! Do lakoreshin edhe emrat tanë në sallën e

gjykatës me dëgjues një qytet të tërë. Në mbrëmje unë dhe Ana do bëheshim fatkeqe, si ato spikeret e televizionit. Do dilnim në ekranin e bisedave dhe mendo ç'turli gjërash të paqena do rrëfëheshin për ne! U pendova që fola me Salvadoren në klub. Më mbante gjallë vetëm indiferencia e tij, kur i rrëfeva se ç'më pati ndodhur me babanë. Ndoshta ai nuk i mveshi rëndësi bisedës. Pastaj, Vera e tij kishte filluar të vinte rregullisht te ne dhe mua kjo më qetësonte edhe më. Ishte alogjike që pikërisht në këtë kohë Salvadorja do më betohej për kryet e vajzave se po mos t'i dilja unë përpara në ato larjet e hesapeve me Markun, ai e kishte ndarë mendjen t'i thoshte burgut hapu... O ai unë, më tha, po dole ti dhe... Ishte një luftë e madhe në kokën time mundja e hipotezës se Salvadorja mund të bënte skandal me Markun. Logjika më trembte, dëshira më qetësonte. Gjumi thuajse m'u prish dhe unë fillova të pi fshehur Anës valiume. Atëherë e mora këtë peshqesh të poshtër që ma bëri gjumin copa-copa e që më dha një dhimbje koke gati të përhershme. S'kishte asnjë dyshim se Marku mbetej tava kryesore që e gatuante atë çorbë, e cila iu servir bujarisht edhe tim eti, ndryshe nga zakoni i kamarierëve, që edhe kur iu bën një porosi me përvojtje të plotë, ose ta presin me 's'ka!', ose ta sjellin ç'ke kërkuar pasi ta kanë plasur buzën nga një orë të mirë. Kurse tim eti ia gjetën zemrën e ia plotësuan porosinë pa e hapur gojën fare ai. Babai im s'merrte shumë vesh nga arti kulinar. E paralajmërova, është e prishur çorba, por ai nuk më ka llogaritur kurrë me të drejtë fjale. E keqja e detyronte të më dëgjonte. Ai më tha mua me mospërfillje se i dinte të gjitha: 'kemi stomak të fortë ne prindërit tuaj, se nuk jemi rritur me pekule, si ju, por kemi ngrënë edhe pilaf me miza nëpër aksionet e para të rinisë, kur nuk kishte as gjalpë e as dizifektim!...'. Seç hynte këtu stomaku, pilafi me miza, gjalpi e dizifektimi vetëm ai e dinte! Unë di se ai kujdesej me kujdes kujdestari për mua, që mos bija në dërrasë të kalbur, derisa ai, ati im, të gjente një banesë më të përshtatshme për mua. Unë kujtova atë përgjigjen me stomak e gjalpë e miza dhe ia

ktheva me të njëjtën monedhë, kur i thashë se sot, në stadin aktual të zhvillimit të socializmit, në Shqipëri nuk ka dërrasa të kalbura (t'u kalbtë koka, do më mallkonte më pas nëna, kurse vëllai do më thoshte: ia kalbe kokën plakut!). Pastaj, pa e lënë të merrte veten, ia kujtova si larg e larg vendimin tim për të mos ndërruar apartament, duke përdorur këtu një betim patetik: edhe sikur të më bëhet mishi copa-copa! Por ai u hoq i shurdhër, siç ia donte mideja, natyrish! Në Tiranë padreja heshte pér këto gjëra. E quante të drejtën e tij të ligjshme të diktonte dhe përtonte të jepte shpjegime, por vëllai, një të djelë në mbrëmje, tek më përcollë bashkë me Anën deri në Vorë, më tha shqip:

- Ki kujdes! Bën sikur është plakur e sikur nuk ka fuqi, por prapë, edhe pa dalë në shesh, ai e komandon lojen!...

Marku u bë befas i përkëdhelur. Dyshoja se babai adresonte shumë falenderime tek ai dhe kjo i mjaftonte reliktit pér t'u lumturuar si viç me thikën mbas qafës. Zuri të sillej paturpësish rrëth meje, si ato guvernantet e qëmotshme, aq sa një shoqja ime që edhi një ditë në muze bëri çudi me atë hajvan dhe më pyeti:

- Po këtë monstrën ç'e keni? Ndonjë nip të Tanush Topisë?

- Objekt muzeal, - iu përgjegja.

Ishte vërtet objekt i rëndomtë muzeal. I vdekur fare! Më pyeti një ditë gjoja si pa qëllim mërziteshim vetëm me Anën në shtëpi, apo na vinin pér vizitë njerëz. S'e durova dot. I thashë drejtpërdrejt pa ia ndarë sytë:

- Për ç'miq e ke fjalën, Mark?

S'i luajti asnë muskul. Ishte friks i madh, një grusht bëhej po ta vije përpara, por pyetjen e lëshoi pasi e bluajti mirë dhe pasi i mori masat që unë s'kisha më shteg pér t'iu përgjigjur.

- Shoqe, - tha duke u zgërdhirë, - pse, pér ç'miq mendove ti?

Dhe buzëqeshi me një ironi të pështirë prej ligaveci. Ta tregoj unë ironinë, iu hakërrova me vete e xhindosur, kurse pér t'iu përgjigjur zgjodha zërin më të qetë që zotërojnë

qetamanët më të spikatur të lëmshit tonë tokësor, siç i pëlqente ta quante globin tonë mësuesja e edukatës shtëpiake në 8-vjeçare, një grua e apasionuar marrëzisht pas thurjes së trikove. I thashë, pra:

- Unë po mendoj për ata miq që ke në mendje ti, por që s'ta mban t'i pohosh me gojë dhe e dredh fjalën si mashtrues. Ti je frikacak! Ndryshe mendon e ndryshe flet, prandaj ke fatin të jesh hem njeri e hem majmun!

U zverdh e iu bë surrati pulla-pulla, si limon i zgjebosur nga ato sëmundjet që vetëm agronomët e frutikulturës i dinë. Gëlltitej hajvani e s'artikullonte dot gjysmë llafi. Seç donte të dërdëlliste, por nuk ia krijova këtë rast fatlum.

- Ti, Mark, - shtova si nënë shembullore me po atë zë ëngjëllor, - po sillesh me mua si ato guvernantet që shikon nëpër filma. Ato përkujdesen për vajzat e kamura dhe shpërblehen. Babai im s'është i pasur, bile, po ta them në mirëbesim, është trokë fare e ti s'ke ç'merr nga ai, veç në paç nevojë për nja dy kile fasule, prandaj, kur nuk nxjerr gjë me këtë zanat, pse nuk gjen ndonjë zanat tjetër?

Dhe idioti vajti e më doli vetë në shtegun ku e prisja, kur më hungëroi me një zë të transformuar:

- Të lutem shumë, unë nuk jam guvernante!

- Që je guvernante, këtë as e ve në dyshim! Në dyshim ve vetëm se cilit seks i përket. Rëndom guvernantet janë femra. Në ndonjë rast të veçantë gjen edhe eunukë apo impotentë...

U ngrit e doli duke e përplasur derën me tërsëllëmë e duke demonstruar një ftohtësi të plotë ndaj seksit femëror, ndryshe nuk kishe se si t'ia shpjegoje skizofreninë në atë moshë. M'u shpif një e qeshur që nuk ma beson njeri po t'ia shpjegoj! Rrija në zyrë dhe qeshja me zë vetëm fare, si idiote. Çfarë dite ka qenë ajo! Kur të merr rrokullima, priti të gjitha me vetëmohim! Akoma kujtoj figurën groteske të Markut, që rrinte si ata kalamajtë që i kanë mbushur breçkat, nën dritaren e zyrës sime. Seç peshkoi një ekonomist vendas dhe po mundohej të mblidhte veten duke llomotitur me të. Atëherë kaloi një plak në rrugë dhe kur ai ekonomisti

e pyeti: si je, xha Kolë, ç'të jem, ia ktheu plaku, pleqëri hesapi! Unë shtyp rrugën, ti shtyp krevatin! ... Ekonomisti qeshi me të madhe, kurse Marku i xhindosur kërkoi të mbante qëndrim:

- Ç'flet ashtu pa pikë turpi, more!

- Nuk e kam me ty, - ia ktheu qetësisht plaku, - se ti je si puna ime! ...

Unë e di sa kam qeshur atë ditë! Më binin lotët si breshër dhe më dhimbnin nofullat një javë! Nuk kam njojur gjidi më egoiste me psikologji më feudale se të tijën. Ai ishte sinqerisht i ofenduar, tepër i ofenduar, deri në palcë, do thoshja, sepse kishte përshtypjen se e pati nderuar shumë dikur Anën, kur denjoi t'i propozonte me atë tërthoritetin e tij perpendikular të hanin një darkë në shtëpinë e tij, meqë nuk i ndodheshin as prindërit në qytet! ... Po unë nuk di të laj pjata, ia pati kthyer naivisht Ana ... Mirëpo atëherë, kur e njoha unë, ai luante si diletant, me kartëra të hapura, se duket nuk i ecte të gjente zagarë për t'i ndërsyer ndaj nesh.

2 Koha e ardhme

Hëngrëm drekë gati më këmbë. Ana nguli këmbë të shkonim në plazh dhe gati sa nuk u mbytëm, që të arrinim urbanin e orës tre e gjysmë. Veshëm me ngut rrobat e banjos, morëm me vete libra, radion e famshme, që ishte sa një kuti bonbonesh, por që s'ma ha mendja të gjendet një simotër e dytë e saj me aq stacione e muzikë sa kishte ajo, dhe dolëm me vrap. Fatorinoja ishte pak i pirë dhe përmendte vazhdimisht Çernobilin, rrezet kanceroze të diellit dhe leuceminë, aq sa shoferit iu shpif tmerri i kapjes nga ato sëmundje, që s'të shëronte as perëndia.

- E di ç'ke ti, - i tha shoferi fatorinos, - a nuk zbret dhe shkon te marrësh një sy gjumë në shtëpi, se vi të marr unë rrugën tjetër.

- Mbaje, - i tha fatorinoja, - se po zgres! Po zarzavate mos hani e qumësht mos pini, se pastaj, kur të tundni këmbët as unë e as shteti yne socialist s'i u kemi asnjë faj!...

Zbriti duke iu marrë këmbët e duke lakuar gjithmonë Çernobilin dhe njerëzit injorantë, që s'marrin vesh nga pisillëqet e kësaj bote.

Neve na u shpif e qeshura. Shoferi mallkonte nëpër dhëmbë pijanecët, këta vandalë që pijnë sa s'mbajnë më e ia nisin pastaj muhabeteve me vdekjen. Po rakia, a nuk bëhet nga frutat, zihej me vete, s'paskan frutat çernolesh a bil, si e ka dreqi... Zot i madh, pshërëtiu Ana. Ky po harron se tani po flet pak si shumë bash për vdekjen! ... Dhe kështu, duke u tundur e duke u shkundur nëpër makabritete, më në fund arritëm në plazh. Ishte kohë e mrekullueshme! Zumë skajin tonë duke shtyrë njëra-tjetërën në rërën e

pashkelur, u zhveshëm duke i flakur rrobat me këmbë në hava dhe unë u shkriva fare kur m'u duk sikur diellit i ngeli për kapelë këmisha ngjyrë mjalti e Anës. U zhytëm një herë, sa për të na kapur shpejt dielli, pastaj dolëm me vrap.

Duhet të ketë qenë fund maji, besoj. Ana kishte veshur një palë rrobe banjoje të vogla, me një ngjyrë rozë të ngrohtë, që i shkonin përmrekulli. U shtrimë përballë detit, vumë syzet e diellit dhe filluam të lexonim duke shkëmbyer tek-tuk ndonjë fjalë. Një njeri duhej të na qe afruar ngadalë, si spiu, prapa dhe që atje na kundronte qetësish. Ai e kishte diellin përballë, kështu që hijen e linte pas, pa e hedhur mbi ne. Papritur dëgjova një zë të ëmbël, pak ironik, andej nga krahu i Anës:

- Fryu erë e detit, të mbuloi kumi, Ana ulërvia, të zgjova nga gjumi ...

Asaj i ra libri nga dora dhe në çast e pashë të ngritur në bërryl.

- Sokol! - klithi.

Pranë saj, në gjunjë, duke qeshur si i hutuar, qëndronte një djalosh i zeshkët në moshën e Anës. Kishte sy të lëvizshëm dhe dhëmbë të bardhë të rregullt. Qeshte lehtë, aq lehtë sa nuk kuptohej nëse ironizonte, apo ashtu qe mbrujtur si natyrë.

- Edhe Holanda si puna jote është, - tha ai po duke qeshur lehtazi, - iku Krujfi, ikën mosha, po kampione të dyja! ...

Dukej, s'do kishte dalë asnjë ditë në plazh, dhe dielli e pat skuqur mirë.

- C'je bërë si salcë domateje? - i tha Ana duke e parë nëpër shpatulla. - S'të përqafon dot as me majën e gishtave, se të ngelesh në dorë!

- Këto janë dhembje që durohen edhe në prag të vdekjes! - ngriti zérin ai dhe të dy u përqafuan vrrulltas. E pashë si u transformua në çast. Ishte Sokoli i hershëm i jetës së saj! M'u kujtua vetëtimthi ajo skenë e përlotur kushedi sa herë nga unë e takimit të tyre në shtëpinë e Anës. Shihja Anën gjysmë lakuriq me shpinë nga ai ... Desha të puthja

nga gëzimi këtë Konstandin të stërpitur. Unë e dija ç'kishte hequr Ana, unë dhe askush tjetër. Po nuk e pata imagjinuar kurrë gëzimin fëminor të Anës. Bëheshin pesë vjet, pesë vjet e gjysmë; do ta korigjonte shifrën ajo, që nuk ishin parë më. Dhe në ato vite tek Ana herë zgjоhej dashuria e zjarrtë e femrës, herë zgjоhej nëna. I zgjonte Sokoli fare i padukshëm, i humbur e i paadresë, si ata kilianët e zhdukur nga Pinoçeti. Sokoli jetonte brenda Anës si ideal i madh, atje ku jetojnë heronjtë, në kujtesë.

- Po ti, këtu? - thirri Ana.
- Me shërbim, ku na thérret zéri i atdheut! ... Po ti, ç'bën?

Ne qeshnim si të dehura. Drejtoheshin nga të gjitha anët pyetje që nuk iu përgjigjej askush.

- Po jeta mondane, ç'thotë? - e pyeti Ana me një përtypje të lehtë.

Ai ngriti supet.

- Beqar, - tha. - Damat nuk kanë preferenca për moshat e mëdha. Ne po trokasim te të 30-at tani, jemi mësuar të flemë vetëm, kthehem me tèrbim majtas-djathtas, sa asnje femre nuk ia mban të flerë me ne në shtrat matrimonial. Ka frikë mos i biem sipër natën e i thyejmë një pesë brinjë, që të jemi brenda! ...

- Ti je i kujdesshëm, - ia ktheu Ana, - edhe po të shembe, të paktën di të kërkosh falje ...

- Më fal, atëherë, - i tha ai, - një minutë sa të le takimin me shokët, dhe erdha!

Erdhi vërtet shumë shpejt dhe u ul pranë Anës. Tregonte herë krejt seriozisht, herë me ironi të hollë se ç'bëhej kryeqytetit, tallej me ca tipa që i njihnin mirë të dy, pastaj e theu gjuhën. Nisi të flasë me dialektin e Tiranës me Anën dhe krahasimet i bënин me emra që unë s'i kisha parë e dëgjuar kurrë. Ajo përtypoj e mezi përgjigjej. Atëherë unë u ngrita dhe u futa në det. Ndenja sa m'u zbrujt mishi, që t'i lija sa më shumë vetëm. Isha gati të falja gjithë ç'kisha të shtrenjtë, vetëm ata të rikthehesin tek ajo dhoma e hallës, të duhesin e të qanin për njëri-tjetrin. Jeta ime

nuk ka pasur shumë gëzime. Tutela e babait i largonte, dorështrëngesa e nënës nuk i lejonte të trokisin në derën tonë. Bile ne as merrnim pjesë në dreka-darka të fisit, që mos ishim të detyruar t'i ftonim të tjerët. E gjithë kjo punë për ca para të fëlliçura, që kurrë nuk arritet të na shëndoshnin e të na bënin të ndiheshim mbret. Nuk mbaj mend të kem jetuar ditë të gëzuara në atë shtëpi, të qeta në dukje kam jetuar plot, por të gëzuara, asnje! Bile, edhe kur më doli e drejta e studimit, kam qarë nga mërzia, jo nga gëzimi. Mendoja limontinë e re të katër viteve të studimeve në fakultet, mendoja se si do ndryhesha e tulitur dhe e pagojë në dhomën time, ku edhe dielli mezi e fuste kokën. Vrisja mendjen në det se si mund të bëhesha katalizator për bashkimin e vrullshëm të tyre dhe më mbante një shpresë e mjegullt se gjithçka do ecte mbarë. Deti, thashë me vete, si të bërtisja 'Eureka'! Deti! ... Ai është i bukur, i pushtetshëm mbi njeriun. Gjithmonë njeriu i jepet atij pa paragjykime. Ndoshta e kam përjetim subjektiv, por në det më është zgjuar gjithmonë ndjenja e dashurisë. Një herë, kur shkuam për muajin e praktikës mësimore në Durrës, zbritëm, si çdo pasdite, në plazh. Nuk dija mirë not dhe druhesha të shkoja thellë. Atëherë një shok i kursit më propozoi të ma mësonte notin mirë. Hymë bashkë dhe shkuam deri ku niveli i ujit më vinte gati në mjekër. Ai filloi të më jepte leksione seriozisht se si ta mbaja trupin në ujë dhe si të vozitja me këmbë. Pastaj, duke tentuar të më rregullonte pozicionin e deformuar të trupit, që e ndryshoja çdo sekondë duke ulërirë nga frika e nga qejfi i të përkëdhelurit, çka dëshmon se kemi pakëz gjak maceje, dora e tij rrëshqiti nga barku, në gjoksin tim. Mësimi i notit vazhdoi pak si gjatë, dora e tij e harroi detyrën e parë dhe sikur u paralizua mbi gjinjtë e mi. Nuk protestova e s'bëra zhurmë vetëm e qetësuar nga joshja magjike e detit për t'i dhënë përciptas e përkohësishët dikujt dhe sepse e dija mirë që, me të dalë në breg, gjithçka do distancohej sërisht. Nuk më lidhte asgjë me atë shokun, kështu që bregu mund t'i largonte fare lehtë duart e tij nga trupi im. Kurse duart e Sokolit,

trupi i Anës, kishin kujtesë! Ato mund të ndiznin zjarre të mëdha, që zor të fiken më vullnetarisht.

- Lahuni! - i urdhërova kur dola nga deti. - Uji është valë, i mrekullueshëm! ...

Gënjeva pak, por isha tepër i sigurtë se atyre uji do t'u dukej i përvëluar! Ishte absurditet që t'u interesonte temperatura e ujit. Në gjimnaz, maturante kam qenë atëherë, kryenim muajin e punës prodhuese në Petrelë. Atje pranë kalon lumi Erzen. Ishte mars. Kuptohet ç'ujë i ftohtë ishte në atë lumë. Ca shokë tanët vendosën një paradite të lahen në lumë. Ne ngulëm këmbë mos laheshin, se do të bllokoheshin nga i ftohti i madh, por trimëritë e gjimnazit janë unikale! Deshën të dukeshin si heronj para vajzave që adhuronin e që u qenë qepur pas si pulla poste. U zhveshën dhe filluan të futen me radhë. Nga bregu pyesnin: si është uji? ... I shkëlqyer, vinte përgjigja nga ca fytyra të mavijosura ... I shkëlqyer! ... Bota! ... Ç'është ky ujë kaq i ngrohtë?! Mos ka ndonjë degëzim llixhe këtu? ... Dhe pëlltum e brenda të gjithë, me përjashtim të Kol Lazës, atij ironikut të tmerrshëm të paraleles së rusishtes, që tundi kokën e nuk pranoi të lahej me pretekstin: ‘Nuk ka ardhur sot Aida. Kështu që s’kam kujt t’i shes mend si puna juaj! ...’. I fundit, me një portret të shtrembëruar aviatori vuri ulërimën. Shante me fjalët më të ndyra që përbante fjalori i shqipes se pse e gënjen dhe e futën në atë akull të tmerrshëm. Dolën të gjithë me vrap, të akulluar, si kallëpe akulli janë bërë, tallej Koli dhe ia nisën vrapit e një fizkulturne të çmendur për t'u ngrohur. Ndihmojeni shtetin tuaj, ulërinte duke qeshur me lot Koli, shkonit e futuni në ato mbajtëset e shishevë të birrës, se ka dy ditë që është prishur fabrika e akullit! Ndihmojeni shtetin, çuna, se i juaji është! ... Ku u varrosët, o trimëri gjimnazisti?, pyesja me vete tek i shihja ata thellë, pranë e pranë, me dëshirën e zjarrtë që ta rijetonin rininë e tyre. Nëna ime, që e di edhe dashurinë vlerë materiale, më akuzon mua për altruiste të çmendur. Ajo gabon. Unë vetëm se nuk jam ziliqare, ja, kaq! Patriar-

ku më çoi te mirëdashja njerëzore. Nuk kam mundur të bie në dashuri e të bëj dashuri, sepse më ka ruajtur si hije e trupit babai. Përse të mos bëjë e të mos ndihet e lumtur shoqja ime? Përse të mos e ndihmoj unë, po të kem mundësi, dashurinë e saj? Në praktikën mësimore në Durrës ishte edhe Silva me Gencin. Ata duheshin. Unë flija në një dhomë në hotel me Silvën dhe kur hëngrëm darkën e parë bashkë, ua thashë copë: ‘Po deshe të rrish me Gencin vetëm në dhomë, më thuaj! Unë vdes për të bërë shëtitje! ...’ Sa herë brodha atëherë si romantike anës detit, a thua isha gjak me Bajronin, mos them e bija! Muzeu arkeologjik më kishte vizitoren më të kualifikuar. Rrija para amforave dhe ca monedhave të ndryshkura që ta përsosnin hamendjen, dhe ciceronia, kur e pa se nuk i ndahesha pa nja njëqind pyetje të mira e pa i ardhur dy herë ditën në muze, ra përbysë mbi libra e tekste profesionale, që të dinte ç'përgjigje t'u jepte pyetjeve të mia të pafundme e të shtruara. Ca arkeologë ia këputnin kot fare në interpretimin e varreve prehistorikë, mos them për shkatërrimin që po u bën jodi i detit monumenteve të kulturës të ekspozuara jashtë muzeut dhe për të cilat as arkeologët e as restauratorët s'e çajnë kokën hiç! ... Atë muaj, të them të vërtetën, unë bëra universitetin special të arkeologjisë! Fitova kulturë lidhur me origjinën time si popull, kurse Genci me Silvën u martuan më vonë dhe tanë kanë fëmijën katër vjeç. Ky nuk është altruizëm. Altruizmi nuk bashkohet në asnjë pikë me atë që bëhet e ardhme! ... Ç'mrekulli do qe ta dinin ata të dy se ç'mendoja unë në ato çaste. Por nuk flisja dot me zë të lartë dhe turpi është vrasësi i dëshirave të pasprehura! Unë kam pasur turp të flas për të ardhmen. Dhe jam e bindur se kështu më është larguar gjithmonë e ardhmjë! ...

Atë pasdite të ngrohtë kam filozofuar gjatë në breg. Edhe ata u vonuan shumë. Kur dolën, pak nga muzgu që po binte, pak nga ujërat që u kullonin, m'u dukën të lagur e të trishtuar, si të kapur nga ndonjë rrebesch në mes të rrugës e larg strehëve. Ana u fshi me ngut. Deshte të iknim. Më therri zemra. E ndieva. Ai nuk ishte për kthim prapa të

kohës e të ndjenjave. Ne u larguam me një trishtim të madh duke udhëtuar drejt qytetit në një autobus pa fatorino, sikur dikush të kujdesej që t'u krijonte sa më shumë komoditete udhëtimi njerëzve të trishtuar.

E shkuar në të gjitha aspektet e saj

Ora duhej të kishte kapërcyer njëmbëdhjetën e natës, pasi prej kohësh përmes ndonjë televizori me volum të ngritur të fqinjëve dëgjuam siglën e mbarimit të emisioneve të Tiranës. Folëm edhe gjysmë ore anglisht, përpinqesha që Ana ta thyente gjuhën veçanërisht para gjumit, pastaj filluam të gogësijmë me radhë, sa na ngeli goja hapur dhe vendosëm të flinim. Ata ishin muaj të qetë. Dukej se paqja ra, se njerëzit i lanë sherret, e njohën Anën dhe u penduan që i kishin rënë kaq kohë më qafë. Edhe im atë s'pipëtinte, Çuditërisht ishte tërhequr! Vazhdonte të më pyeste me kujdes për Anën, por nuk thoshte më në mënyrë kategorike: të duhet gjetur një banesë tjeter!

Dhe pikërisht atëkohë që ne sapo i kishin thënë ‘natën’ njëra-tjetrës në shkallë u dëgjuan hapa. Nuk mund të më shkonte mendja se dikush vinte për te ne. Hapat qëndruan çuditërisht para derës sonë dhe mua nuk më ngjanë me atë të ecurën e rëndë të Salvadores. U ndien trokitje në derë, si moskokëçarëse, dhe unë thirra Anën duke u ngritur nga shtresat.

- Ra dera!

Ajo doli me këmishë nate në koridor duke më pyetur se kush duhej të qe kaq vonë, pastaj lëshoi zërin dhe pyeti:

- Kush është?

U vonua një grimë përgjigjja, pastaj u dëgjua një emër:

- Stefani!

- Një minutë! - tha Ana dhe mori në dhomë penjuarin. E veshi duke më hedhur një vështrim të çuditur. Po ky, pyeste ai vështrim, pastaj ma bëri me shenjë që t'i shkoja

afër për çdo vaki që mund të ndodhte dhe, kur më ndjeu përbri, aq sa ia ndieja fërgëllimat e trupit, ajo zgjati dorën, rrrotulloi çelësin në bravë dhe e hapi derën paksa. Stefani qëndronte i mbështetur me parakrahun e dorës së djathtë te parmaku i derës dhe mundohej të na buzëqeshte në mënyrë joshëse të dyjave që pa u hapur dera ende. Binte erë teatralitet. Luhej një lloj teatri i çuditshëm.

- Mirëmbërëma, - mezi arriti të thotë, - a mund të futem brenda?

Vetëm një i metë mund të mos ta nuhaste se po bisedonte me një të dehur. Qelbej era alkool dhe gogësiu nga dy herë ndërkokë, sa mua më erdhën zorrët në gojë.

Bëri të hynte, por Ana nuk ia liroi rrugën.

- Po pate ndonjë hall, - i tha me një zë të thatë, pa nerva, - hajde nesër në zyrë. Ne ishim duke fjetur ...

- Tani u zgjuat? - pyeti duke u zgërdhirë ai.

T'ia këpusje një flakurimë syve, qelbashit! Bënte dhe lodra fjalësh ai, që fliste kuturu nga rakia!

- Natën e mirë, - i tha Ana e vendosur dhe e shtyu në çast derën mu para hundës së tij. Kërciti çelësi në bravë, kurse nga ana tjetër e grisi qetësinë zëri i Stefanit:

- Mos u hiq kaq e shenjtë! Ti ma ke hapur derën!

Anës iu drodhën mollëzat.

- Dil te ballkoni i aneksit, - më tha zëdridhur, - dhe shiko kush po e pret Stefanin poshtë! Unë po përgjoj nga dritarja e dhomës!

Tutje, në cep të rrugës, dukeshin dy silueta. E thirra Anën, mirëpo ajo nuk ma vari. Dhe mirë bëri që nuk m'u përgjigji. Të mitë kishin qenë dy kalimtarë të rastësishëm. Njerëzit e Stefanit qenë futur në shkallën tonë dhe, kur dolën, Ana dalloj Markun. Ishte zbehur e tëra, dridhej, dhe unë nuk e qetësoja dot. Dridhesha për vete. Gjithçka ndodhi tmerrësisht shpejt. Turbull më kujtohej trokitja, jargavitja e pështirë e tjetrit, po nuk desha në asnjë mënyrë të më kthjellohej ajo skenë. Sikur ta harroja sa më shpejt!

Dhe pa e mbledhur veten akoma, dëgjuam zërin e Markut që, duke ulërirë si ujqërit në pyll, tha se do të ishte mirë të

këndonin këngë patriotike nën dritaret tonë.

Ia nisi i pari, me zë të intonuar çuditërisht për mrekulli me melodinë dhe përpinqej t'i shqiptonte sa më shkoqur fjalët e refrenit, veçanërisht atë vargun 'Eja mblidhuni këtu, këtu ...'.

- Pse këtu? - murmurita unë, pa e ditur shkakun që formuloi pyetjen formale.

- Po ne jemi ashtu, pra, - trishtoi Ana krejtësisht e rraskapitur. Ishte bërë bezhë në portret.

M'u mpi mendimi dhe as ndieja gjë, përveç një frike të pashembullt. Më dukej se më luajti zemra nga vendi. Atëherë u hap një dritare, diku sipër nesh, andej nga e majta, nga hyrja e aviatorëve, dhe u dëgjua një zë:

- Shokë patriotë, lereni koncertin për nesër, se na zgjuat nga gjumi!

- Atdhedashuria nuk njeh orar! - u përgjigj duke u zgërdhirë Stefani.

- Po atdheu më kërkon nesër që në pikë të sabahut zgjuar! - ulériu fqinji ynë. - Shkoni flini, shokë patriotë, që mos ju zbres unë poshtë dhe t'ua këndoja mirë atë këngën! ...

Kori e braktisi këngën bashkë me patriotizmin dhe u shpërndat pas zgërdhirjeve, kurse unë, ca ditë më pas, kur e pështyva Markun në muze, i thashë se edhe pisllëqet të ndihmojnë ndonjëherë të zbulosh talentin. Ja, ai hajvan, mund të bëhej alamet këngëtar lirik! Vetëm se do ta humbte dëshirën e tij tejet humane, po të ndodhët të bëhej vërtet këngëtar, për t'u bërë keq njerëzve. Do t'i lumturonte me zërin e tij të mrekullueshëm, gjë që atij nuk duhet t'i ketë pëlqyer që herët, përderisa nuk arriti të bëhet kurrë këngëtar dhe nuk tregoi kurrë se dinte të këndonte bukur.

Hijet u zhdukën përtej kryqëzimit dhe vetëm atëherë Ana pëshpëriti ngadalë me një nxjerrje të plotë fryme nga krahërori:

- Filluan prapë!

U mendua një hop, të shtrihej apo jo, por kjo hamendësia e dytë ishte absurde fare dhe u çapit drejt kuzhinës. U ul si e sharruar në mes të kolltukut. Që atje më urdhëroi të

bëja nga një kafe. Papritur pashë rroben time të pambërt-hyer plotësisht në atë ngut, dhe më hypi inati me atë mizerjen që më pati kundruar mirë e mirë gjysmë të zhveshur.

- Ku shihte nga sytë ai! - ma preu mallkimin me një lëvizje të lodhur të dorës Ana.

Bezhëronte e tërë fytyra e saj, sikur t'i qe kalbur mish, Bile m'u duk se sa i vinte e i bëhej lëkura më në ngjyrë dheu.

- Po pse erdhi? - e pyeta për Stefanin.

Gjithçka ishte aq e çuditshme, shto dhe atë kalbjen e menjëherëshme të saj, që të kallte tmerrin kur e shihje, a thua u ngrit e vdekura nga varri!

- E kanë dehur dhe e sollën pako postale te porta. Gjetën një budallë, plastelinë! ... Duan argumentin e imoralitetit tim ... A nuk të thashë atëherë se edhe shkrimi në gazetë më duhet mua? ... Ish-dashnori del prapë në skenë ... Roman erotik, pastaj! Po ti mos i bjer në sy Markut! ...

Seriozisht më trembi pamja e saj, më trembi keqas edhe ajo ftohtësi e qetësi që ruante kur fliste. Më vonë kam uruar mëmën natyrë që nuk iu shkrep Anës atë natë të dilte jashtë dhe ta mbërthente Markun në rrugë. Atëherë do të ishte një skandal! Ajo do t'ia fuste thonjtë në fyt! ... Pimë kafe pa folur as edhe një çerek fjale, ajo piu gjysmë shishe konjak 'Skënderbeu', duke e hedhur çdo pesë minuta në një gotë vere, u deh plotësisht dhe e zuri gjumi siç ishte në kolltuk. Keni parë njeri të dehet duke pirë i vetëm pa komunikuar me kërkënd? Uroj mos keni qëlluar në ndonjë mort të tillë! Unë e durova heroikisht këtë vdekje të njeriut. E prita me durim sa u deh, e ruajta sa e zuri gjumi, i hodha kuvertën e lehtë përsipër, pastaj vendosa të mos fle, por të rri e të ruaj Anën. Pata frikë mos villte në gjumë. Gjyshja ime thoshte se të dehurin e mbyt e vjella e tij, bile ajo tregonte shpesh rastin e atij kushëririt tonë të largët që për pak sa nuk e kishin ngrënë laraskat, sepse ai kishte vjellë natën në krevat dhe në mëngjes e gjeti e shoqja me një tufë laraskash përreth, që patën hyrë nga dritarja e hapur dhe hanin të

vjellat ... Kjo histori më pati tmerruar dhe ma pati futur deri në palcë frikën nga pasojat e të vjellave. Ana flinte me pamje të mjeruar, tërësisht të mjeruar, nga koka e rënë në supin e majtë si e këputur me një tërheqje të furishme kriminele, deri te këmbët e zbathura të dala paksa jashtë mbulesës. M'u duk si lypsare klasike, që mjerimi e ka shtyrë të dalë në rrugë me dorën e nderur përpara ... Këtu mbaroi heroizmi im i qëndresës. Më shpërthyen lotët vrushkull, aq shumë, sa në mëngjes u gdhiva me fytyrë të palarë, rripara nga rrëketë e lotëve. Më zgjoi Ana, para se të ikte. Unë e filloja punën një orë pas saj. Megjithatë, u çova, pimë prapë një kafe të dyja dhe, tek e përcolla te dera me një dhimbje koke të mërzitshme, e putha duke i pëshpëritur në vesh:

- E di si m'u duke mbrëmë?
- Nuk dua ta di! - ma preu.

Pastaj, pa e zbritur akoma shkallaren e parë, ktheu kokën nga unë dhe më tha ngadalë:

- Ema, këtë herë do lyp ndihmë!
- Dhe iku duke tundur dorën.

Koha e tashme

Të nesërmen e asaj nate Marku nuk erdhi në muze. Fillova të bëhem nervoze që s'po hasja dot atë palaço, për t'i thënë nga dy llafe si parathënie dhe shkove e pyeta drejtorin mos e dinte se ku ndodhej Marku. Vajta qëllimisht tek ai burrë i shtruar, që ta dinte se Marku nuk qe paraqitur në punë dhe t'ia priste ditën në bordero. Nuk ngopesha dot duke i bërë keq asaj varreze të fëlliqr! Drejtorin e kishin njofuar në mëngjes se Marku qe nisur që dje pasdite me shërbim në Tiranë. Atëherë Marku m'u duk tamam hajdut e vrasës! Ata hienë bëjnë krimin dhe mendojnë paraprakisht, me gjakftohësinë më makubre, alibinë.

- Edhe në varr të futet, - u ckërmít Ana, - do ta nxjerr dhe do ta varros me duart e mia! Do t'ia nxjerr për hundësh atë patriotizmin e tij të flaktë! ...

Jashtë kishte filluar të frynte sërisht era. Plepat qenë prerë që në verë e bërë shkrepse e letër dhe tani rruga e përcillte erën me ca zhurma më të forta e më të mprehta. Dridhesha mos ajo trokitje në pragmesnatë dhe ai himn nën dritare mos arrinin te babai gjysmë të përcudnuara, në trajta legjende.

Në apartamentin tonë mbretëronte heshtja, por unë e kuptoja qartësisht falsitetin dhe zymtësinë e saj. Varre, pastaj paqe, thoshte hirnimi i Anës. I mësoja anglisht vajzës së Salvadorës, duke u përpjekur t'ia ilustroja mësimet me anekdota të gëzueshme angleze, desha të qetësoj disi Anën. Ajo qeshi vetëm kur dëgjoi atë dialogun mes gruas që e kishte divorcuar bashkëshortin, me një shoqen e saj: do kthehem prapë te burri! ... Pse? Ti vetë e braktise?! ...

Nuk e shikoj dot të jetojë i lumtur! ...

- Ç'është kjo lumturi? - pyeti Vera e Salvadores.

Ajo ishte një dhuratë e çmuar për ne. Ishte i vetmi njeri që na mbante gjallë me ato imitimet e përsosura që i bënte Salvadores dhe mësuesit të fizikës në gjimnaz, që ua demonstronte orën e shpjegimit të inercisë duke u hedhur si majmun nga maja e bankave e duke ulërirë me t'i thyer gjunjët fare pak: e patë si u përkul gjuri? Kjo është inercia! ... Tregonte për të atin dhe na paralajmëronte duke na tundur gishtin e hollë:

- Mos i kallxoni babës, se më shkyn!

- Ai është qingj!- qeshte Ana.

Vajza tundte kokën.

- Poooo! - përgjigjej duke zgjatur 'o'-në. - Vetëm se nuk ha bar! Eshtë qingj që ha mish! - shtonte duke kukurisur.

- Ka kë shkyen Salvadorja, - hidhesha unë, - mos ki frikë, ti!

Dhe e vërteta ishte pikërisht kështu, Salvadorja, për të shqyer, donte të shqyente shtatëqind copash dikë tjetër, Markun. Ai e shau Anën me fjalët më të ndyra që dinte, kur mori vesh se ajo e denoncoi ofendimin e bërë atë natë në hetuesi e Komitet Partie.

- Të thashë, - i ulëriu mu në fytyrë gati duke e kapur përgryke,- më shkoi goja mbrapa duke të thënë të hiqesh veç e të ma lesh mua ta tjerr punën e Markut! A nxore gjë në dritë me ankesa? Një mut! Tani që u bë zhurmë e mori fjala malet, edhe Marku ruhet, edhe unë s'iа thyej dot eshtrat rrëzave, se kur të lehë 'më ngordhi në dru Salvadorja', të gjithë do ta besojnë!...

Ana nuk u përgjigji. Kur unë i tregova asaj dhe Salvadores se si e pështyva Markun e se ç'dialog i furishëm u shkëmbye mes nesh në muze, atëherë ajo hapi gojën e tha se deri sa të vdiste nuk do ta gjelltiste dot turpërimin që i kishte bërë atë natë Marku.

- Harrojeni! - na urdhëroi i trishtuar. - Unë edhe sikur ta shoh të vrarë para syve, nuk lehtësohem dot! Gjithë ai kor burrash hamshorë që ulërinin nën dritaren time 'Eja,

mblidhuni këtu...' nuk gëlltitet dot si buka që ha!...

Në fakt, ai na e punoi bukur. Siç u tërhoq hetuesi, ashtu ngriti supet edhe instruktori i Komitetit të Partisë.

- Unë nuk mund t'i tërheq vërejtjen një njeriu, - tha instruktori, njeri i dashruuar marrëzisht vetëm pas formës e pa as më të voglën kokëçarje pér përbajtjet e ndryshme të formës së njëjtë, - e aq më tepër të kërkoj dënimin e tij, pse paska kënduar nën dritaret tuaja një himn patriotik!...

- Nuk ju intereson nënteksti, - e pyeti Ana, - as tallja publike me simbolet e shenjta kombëtare?

- Më interesojnë, - ia preu shkurt ai - por ato nuk duken!

Ishte mjerim i madh të kërkoje ndihmën e tij, që nuk e dinte akoma se e vërteta nuk duket kurrë, vetëm zbulohet!

Kur unë e pështyva Markun dhe e shava me ç'më mbante goja faqe gjithë kolektivit të muzeut, ai, pa m'i ndarë sytë si prej brejtësi, më tha atë që nuk ma priste mendja kurrë:

- Mua as që më ka vajtur mendja kurrë ta tall e ta përgojoj Anën, se nuk më intereson fare si njeri. Po ti mos u hiq kaq e shenjtë! Unë, po, mund t'i bija në qafë Anës, po t'i besoja fjalëve të tua, që ke thënë dikur se ajo është ashtu... që mos ndyj gojën, meqë edhe nuk jam mësuar!

Ngriva. Dhe, meqë m'u mpi gjithçka, nuk jam në gjendje ta tregoj se si e kalova atë fragment të llahtarshëm kohe. Asnjëherë nuk e mora vesh: I tha Markut njeri se ç'pata dërdëllitur dikur unë pér Anën apo ai ia këputi kot fare dhe arriti të qëllojë në shenjë, si ajo belaja që na polli në zbor në fakultet, kur s'dihej kush ta paguante gomarin e katundarit. Atë qenie të pafajshme e vrou një plumb anonim i yni, kur po bënim qitje. Bëri plumbi rikoshet dhe shkoi e i ra në krahun tjetër një gomari që po kulloste në qejf të tij. Atëherë u bënë një tufë me mbledhje se cili duhej ta dëmshpërbente të zotin e gomarit, që arriti e vuri edhe një çmim astronomik, si të qe 'Porsh' gërdallës së tij, kurse mua, tani që po shkruaj rrëfimin tim e po zbraz barkun, më duket se s'do arrij asnjëherë të jem në gjendje ta dëmshpërblej Anën!

- Ti, Mark, je i poshtër! - i thashë me të mbledhur veten

disi, pikërisht në atë kohë që në zyrën tonë, pas shpinës së tij, po hynte drejtori. Ai mendoi se ende ndodhej vetëm për vetëm me mua dhe më lëshoi një fyerje të rëndë. Kjo pakujdesi e vogël e dogji.

- Rrugaç! Përjashta! - ulériu drejtori.

Në muze Marku hyri edhe një herë, kur dorëzoi dosjet e tij rrëth familjeve Komini e Topia. Nuk ia pashë fytyrën më. E hodhën si në epoqë tre male përtej, në një trevë alpine me plot rapsodë, meqë kishte zë të bukur. Tani vonë e mora vesh se atij qytetarët ia paskan ndërruar mbiemrin dhe e thërrasin Marka Patrioti.

Natën e zënies time me Markun dhe përzënien e tij të menjëhershme nga puna Ana priti deri sa u larguan nga ne Salvadorja me vajzën.

- Mos u mërzit, ëë, por ai Marku me ç'kurajo mashtroi aq ndyrë? - më pyeti zëulët.

E mendova në të qintën e sekondës me dhimbje që të shkakton sinqeriteti se më në fund mund të flakja jashtë ndërgjegjes e trupit tim barrën dërmuese të asaj thënie së ndyrë 'dava prostitute'

- Nuk besoj se mashtroi, - ia ktheva pa e ngritur kokën.

Dhe u rrëfeva me një frymë, shpejt e shpejt, e trembur nga kthimi i pendesës, u rrëfeva shpejt, a thua prifti kishte një orar me stomatologun dhe po e shikonte orën parreshtrur. Mendimi se po rrëfëhesha edhe më tmerronte, edhe më lehtësonte. Kur shqiptova fjalinë e fundit, nja dy-tre kilogram peshë trupore duhej të më kishin hyrë në ujë, sepse, sinqerisht, më lëvizi fundi në trup.

Ana më përqafroi ngadalë dhe më puthi.

- S'ka gjë, - tha. - Tek e fundit nuk është vetëm faji yt, - shtoi.

- Megjithatë, ai duhet të ketë fantazuar, i sigurt se secili nga ne ndjehet fajtor...

Heshti një çast, ashtu e përqafuar me mua, pastaj tha si me trishtim:

- Më vjen keq që njerëzit ndjehen kaq të papunë, sa të merren me hallet e të tjerëve...

Heshti përsëri, siç heshtin për t'u mbushur me frysme azmatikët me sëmundje të avancuar. Po e vononte shumë atë thithje oksigjeni dhe mua më fluturoi mendja te mendimi se asaj, Ana Likës, ky qytet po ia fshihte edhe oksigjenin.

- Më vjen keq edhe përfaktin tjetër, - foli më në fund, - që njerëzit nuk vuajnë hiç nga arteroskleroza. Të shkretët! - psherëtiu, - Do çmenden fare, se truri çakërdiset, po nuk funksionoi seleksionimi i saj ç'të kapin shqisat me anë të mekanizmit të harresës...

U ngrit duke qeshur hidhur.

- S'harrojnë dot as edhe një fejesë të dështuar!

Më në fund guxova e i thashë se nuk harrojnë, ngaqë, duket, kanë ëndërruar të ndahen përvete nga gratë që nuk duan t'ua shohin bojën, por s'ua ka mbajtur të ngrenë krye.

- Ka mundësi! - ma ktheu.

Atëherë unë fitova më tepër kurajo. S'kisha frikë se mos më kthehej mua e të më thoshte: mbylle gojën, ti! Shumë shpejt e more veten!... I thashë:

- Edhe te Homeri i gjen thashethemet! Nuk e gjen Nausika kur po lan rrobet në lumë me shoqet e saj Uliksin? Kur u kthyen, deri pranë qytetit ecën bashkë duke biseduar. Atje u ndanë, se Nausika i tha 'nuk dua të na shohin njerëzit bashkë, se flasin pastaj...' Kur iu trembej fjalëve dhe vajza e mbretit...

- Kur i ka shkruajtur veprat Homeri? - më pyeti.

- Nja tre mijë vjet përpëra, po! - ia ktheva.

- çfarë shoqërie duhet të ketë qenë atëherë? Primitive?

- Aty afër... Skllavopronare...

- Mjerë ne! - tha.

Ngatërrimi i kohëve

I

Merita e humbi të drejtën e vazhdimit të shkollës përfundimisht. Ngeli pëséri në morfologji, për një palaçollëk, siç e përcaktoi ajo... Ai pedagogu, ëmi, ai hajvani që është ndarë dy herë nga gratë, më ngeli për një ngatërrresë të kohëve së foljeve në analizën morfologjike! Mizerje, fare mizerje, turfullonte. Për një ngatërrresë kohe, jo jam, po isha, të ngelësh e të përjashtohesh nga fakulteti?!... Mua më vinte pakëz pér të qeshur, por nuk guxoja ta lëshoja gurgullimën e zërit që më qe mbledhur mu në grykë. Nëna e Meritës ndodhej bashkë me ne në kuzhinë dhe do të ofendohej nga kjo mospjesëmarrje e hapur e imja në fatkeqësinë e familjes së saj. Ajo sa nuk po e thyente së përplasuri në fole receptorin e telefonit të bllokuar papritur. Kërkonte nga çdo anë me ngulm një raport mjekësor pér Meritën pér t'i shpëtuar përjashtimit të Meritës nga fakulteti. Një mjek i njobur neurokirurg i kishte dhënë gjysmë fjale t'ia nxirrte Meritën anormale. Mirëpo telefoni u bllokua! Kurse Meri e brishtë e harroi morfologjinë e filloj të më tregonte me një siguri të habitshme, a thua ishte ndodhur personalisht në vendngjarje, se si e shoqja e një mjeku specialist të zorrës së trashë e mbërthau në flagancë të shoqin me një aktore të njobur të Teatrit Popullor, e cila ishte justifikuar me gjysmë zëri, ashtu, lakuriq, se po vizitohej. Asgjë tjetër nuk po bënte!...

- Mbase ka qenë vërtet pér t'u vizituar nga ndonjë infeksion në zorrën e trashë, - vërejta unë më shumë pér ta ngacmuar, pa ia vënë veshin shkakut prej nga buronte trashësia, sipas Meritës, mënyra barbare e ngrënies së bu-

kës nga ana e të shoqit të aktores me të dyja bulçitë njëherësh.

I shkëlqyen sytë.

- Po pse e zhveshi aktoren lakuriq? - pyeti. - Vend i sëmurë nuk ka lidhje me gjinjtë!

Mua m'u qesh.

- Përderisa ceroza e mëlçisë duket edhe në qeskat e fryra të syve, edhe infekzioni i zorrës së trashë mund të duket në squilljen e gjinjve, - ia ktheva për qejf.

- Ajo ka gjoks të fortë! - më tha Merita dhe unë nuk e mbajta dot më të qeshurën.

- Madhështore! - i thashë. - Nuk e dija se njohuritë e tua shkojnë deri këtu!

I dhashë dorën në kohën kur nëna e saj arriti ta mbërthejë atë psikopatizuesin e raportit dhe ika. Ishte krim i madh ta harxhoje kohën me të. Kryeje një barbarizëm të kohës! Një shtenie me armë automatike mbi kohën paqësore e të pambrojtur... M'u kujtua befas Silva me Sokolin dhe vendosa të kthehem një vizitë tek ata. Kishin marrë një apartament të ri pranë Agjencisë Telegrafike. Ishte hera e dytë që shkoja. Herën e parë shkova për një urim të dyfishtë, përvjetorin e parë të djalit dhe për marrjen e apartamentit të ri. Atëherë nuk u kënaqa, sepse gjeta një mori kushurinjsh të Silvës e të Sokolit, që gjithashtu kishin ardhur të uronin. Këtë herë apartamenti ishte bosh. I lashë një rakinakë në dorë djalit, që mbahej mirë më këmbë, pyeta për Sokolin dhe, si mora vesh se ai ishte jashtë Tiranës ca ditë me një grup turistësh, u mbështeta qetësisht me Silvën në divan dhe ia nisëm shtruar pyetjeve e përgjigjeve për të gjithë të njohurit tanë. U befasova kur më tha se e njihet Anën.

- Eshtë prishur ndopak? - më pyeti.

Kishin qenë të dyja fqinja te shtëpia e prindërve. Nuk e dija. Te Silva kisha filluar të hyja e të dilja në kohën kur Ana nuk punonte në Tiranë.

- Eshtë zbukuruar! - i thashë jo pa krenari.

- Sa fine që eshtë! - psherëtiu. - Unë e kam pikë të dobët! Kur e la atë të fejuarin, nuk i kam vënë faj. Po se mos

vetëm unë!... Se si u bë ajo fejesë, tak-fak... Po tani ç'bën?
Tunda kokën. Silva u pikëllua.
- Gjithë ajo bukuri, - tha, - nuk e mendoj dot të vëtmuar!
As unë nuk e mendoja dot. Një mëngjes, pak kohë më
parë, Ana më pati thënë me trishtim!
- Kam parë gjithë natën sonte në ëndërr Sokolin! Ai nuk
përsëritet më në jetën time!...
Ç'tí tre goja Silvës?

2

Në prag të Vtit të Ri, kur po bëhesha gati të kthehesha në Tiranë, ia behu halla e Anës krejt papritur. Një vit më parë ato e kaluan natën e festës te shtëpia e hallës dhe mua Ana më kishte thënë që në fillim të dhjetorit se sivjet nuk do të luante nga apartamenti.

- Më mërzit Tirana, - më tha.

Iu luta gjithë ato ditë të vinte me mua. Silva, Sokoli dhe ca miq të tjerë kishin prenotuar një alamet tavoline të gjatë te 'Arbëria'.

- Do t'ia kalojmë mrekulli, - përpinqesha t'ia prishja mendjen.

Por ajo rrudhte buzët.

Dhe atëherë lajmëroi halla se do vinte ta kalonte natën e Vtit të Ri me Anën. Më erdhi keq që nuk do ta takoja dot. Ajo do vinte më 31 dhjetor, unë do largohesha një ditë më parë, kështu që... Por erdhi kur ne nuk e prisnim, më 29 dhjetor, dhe më tha shkoqur kur po hiqte pallton në korridor:

- Erdha se desha të të gjej edhe ty këtu! E festojmë sonte bashkë Vtin e Ri, nesër ik pastaj në Tiranë...

Ç'i duhesha unë asaj gruaje të urtë, që bënte sherr me ne sa herë na i gjente lulet të tharra nëpër vazo e që, para se të puthte mbesën, pyeste: si e kam tulipanin?

Shtruam një tavolinë sipas shijes së Anës. I vumë të gjitha ç'kishim. Unë hapa edhe një herë baulet e mia dhe nxora ushqime e piye që i kisha blerë për prindërit e mi, vrapuam si të marra për të blerë birrë, pastaj, si bëmë nga një dush për të hequr nga trupi erën e gjellës, u veshëm e ngjeshëm,

si të niseshim për në premierat e Teatrit të Operës dhe Baletit, ku bëhej parada e modës, zumë vend në tavolinë. Flisnim të trija njëherësh. Qeshnim, tregonim historira, putheshim, por dalëngadalë halla filloi të fitonte terren. Nisi një histori të sajën dhe ne pushuam.

- Para një muaji qava shumë, - tha, - vdiq një shoku im i vjetër i Luftës...

Duket pati frikë mos ndonjëra nga ne hidhej e thoshte 'po tani edhe do vdesin, se moshën e kanë, po, të lodhur janë...' dhe shtoi në çast:

- E di, Ana, unë mund ta qaja atë para një muaji si burrin tim dhe mund të prisja njerëz për ngushëllim... Ashtu e qava, vetëm se derëmbyllur... Atë e kam dashur me gjithë shpirt. Po nuk u martuam dot... Ishte i zgjuar. Kur unë prisja me ankth të ma shfaqte dashurinë, 47-ta duhet të ketë qenë, ai më ftoi të shkonim bashkë në fshatin e tij të lindjes. Merret vesh, pranova duke flutuar dhe gjithë kohën e udhëtimit për në fshatin e tij tëndërrroja skenën kur ai do t'i thërriste që nga oborri nënës, siç ndodhë rëndom në ato kohë të papërsëritshme: 'mama, dil të shohësh nusen! Kjo është! Kemi qenë partizanë bashkë!...' Dhe isha veshur bukur. Ato kohë nuk keqkuptohej dekolteja. Dhe unë, me një goxha dekolte, konkuroja të Bukurën e Dheut!... Ai nuk thirri nga oborri. Epo, do ta thotë lajmin brenda, mendova... Në shtëpinë e tij ra heshtja, sikur të mos kishte kapërcyer pragun një vajzë, por arkivoli! Më shihnin me habi fyese. O perëndi, si më shihnin! Bënин shenja njëra-tjetrës duke punuar shtiza, pastaj dilnin jashtë për të më përgojuar mua... Nuk dija ç'të bëja e ç'tu thoshta. U tregova se në luftë, në kohën e Operacionit të Qershoret, erdha në këttë fshat, por nuk gjeta njeri. Ishte shkretuar dynaja e tij, -thoshtë nëna e tij. Punonte shtiza dhe ajo. Fliste pa ngritur kokën, a thua mërmëriste me vete. Lufta! Atëherë ishin tërë njerëzit njëlloj!... Thumbin ma nguli fare hapur. Dhe përsë? Për atë dekolte idiote!... Më shtruan për të fjetur në katin e dytë të shtëpisë. Unë e di sa kam qarë atë natë! Po zuri ndonjëherë lagështi ajo shtëpi, nga

lotët e mia e ka marrë!... Atë kohë unë nuk u martova me të ndjerin, sepse bëra një gabim: u vesha sikur po shkoja në ballo, duke harruar se ato gra të veshura me të zeza pa mbushur 10 vjeç ngarkoheshin çdo ditë me dru në kurri. Dhe më mundon gjithmonë ai gabim, sepse gjithmonë kam dashur me gjithë shpirt të martohem! Ju të dyja ende talleni me jetën, nuk e keni idenë se ç'përfaqëson për njeriun martesa...

Dhe qau me dënesa të lehta. Mua m'u mblodhën lotët vetë dhe, për të mbledhur veten njëfarësoj, u ngrita dhe bëra sikur kisha nevojë të shkoja në banjë. Ishte e rëndë të shikoje atë grua që luftoi gjithë jetën për emancipim shoqëror, të braktisur e të parë shtrembër nga vetë gratë. E mblodha vërtet veten larg saj, aq më tepër që ma mori mendjen ai fëmija që i thërriste nënës nga obori:

- O mami, a del gomari jashtë shtetit për specializim?
- Del, - i përgjigjej e ëma, - po mos më thirr më se kam punë!

Kur u ktheva në guzhinë ishte klima më ndryshe, veç ajo vazhdonte të dëneste. Ana e shihte qetësisht dhe unë mendova se qe mësuar tashmë, i qe regjur lëkura, siç shprehet gjyshja ime, me mizanskena të tillë, por asaj në tjetër vend i rrihte mendja. E la derisa pushoi, pastaj e pyeti me një zë të akullt:

- Halla, ku deshe të dilje?
Plaka fshiu lotët me shami dhe u përgjigji qetësisht, sikur pyetja e mbesës së saj t'i dukej fare normale.

- Ti duhet të martohesh! Prandaj desha të gjej këtu edhe shoqen tënde të ngushtë. Ajo mos hargaliset e të bëjë gjithë ditën giu-viu pas teje, por të të bindë që ti duhet të martohesh! Kështu! Këtu desha të dilja!

Ana psherëtiu.
- Mirë e ke, por me kë të martohem! Me ty? Se unë vetëm ty të njoh ç'zemër ke e, rrjedhimisht të dua!

Nuk po orientohesha dot me kthimin e menjëhershëm të bisedës. Ishte kaq e çuditshme, e mistershme, si një libër që lexohet një faqe këtu, një faqe në fund. Por ato flisnin

edhe me pauzat në mes të fjalëve. E njihnin mirë njëratjetrën. Ishin si gjyshja me babain tim. Që kur ai kapërcente në drekë pragun e shtëpisë, ajo i hidhte një sy dhe na thoshte me zë të ulët: aman, mos ia ktheni, se nuk është në terezi sot!...

- Dëgjo Ana, - dhe halla u kollit lehtë, - unë kurrë nuk të kam dalë kundër, ti e di. Më pëlqen që je e emancipuar dhe dinjitoze, e pastër dhe e bukur, pa këllirë në shpirt. Më pëlqen që i ke dalë zot vetes dhe e mban për bukuri atë. Si ty, si Ema, duhet të jenë të gjitha vajzat tona! Je partizane e së resë, me pak fjalë, je siç kam qenë unë. Në Luftë, kur vritej një partizan, ekzistonte një rregull i hershëm, që e zbatonim me fanatizëm të gjithë partizanët: po të kishe një vëlla tjetër partizan, këtë e ruanin të gjithë si sytë e ballit të mos vritej ... Unë mbeta e pamartuar ... Pretendova në fillim, pastaj u plaka e nuk më mori njeri ... Ti je një gjak e një shtëpi me mua dhe duhet të martohesh. Plagët mezi zunë kore, mos i hap përsëri ...

Ra një heshtje e rëndë. Ana trokiste gishtërinjtë në gotën e birrës krejt mekanikisht, unë nuk guxoja t'i ngrijë sytë, halla fshinte krejt pa kuptim fundin e pastër me gishtërinj. Më në fund Ana mori frymë thellë.

- Ti, si thua? - më pyeti.

E ndieva veten keq. E dija ç'përgjigje do t'i jepja dhe tabloja që do krijohej pas përgjigjes sime do të ishte e zymtë: një luftëtare që hedh armët për tokë! ... Veçanërisht pasi iku nga skena Marku, ne ndiheshim shumë të forta. Askush nuk na binte më në qafë, njerëzit na respektonin, bile Salvadorja na tha një mbrëmje se në qytet kishin filluar të na thërrisin 'burrnesha', çka konsiderohej si respekti më i madh që mund t'i bëhej femrës në këto treva. Në të vërtetë ne po dashuroheshim gjithnjë e më shumë pas dinjititet. Ç't'i thoshja unë tanë dinjitozes sime? Megjithatë, u kapa pas amësisë. Brenda mureve të këtij apartamenti Ana ishte e emancipuar pa ndonjë vlerë, sepse e vetmuar nuk rrezatonte dot asgjë. Unë një ditë do të ikja dhe ajo atëherë do të mbetej e vetme, fare e vetme, me atë botën

e saj dhe vetëm të saj, me fatin e saj të keq, që do ta bënte gradualisht hakmarrëse ndaj shoqërisë, të mbyllur në vevvete e pa asnje vlerë për njerëzit, mos themi, të rrezikshme për ta! Nuk gjykohet lehtë Ana, por vëtmia po e hante pak nga pak dhe po ia turbullonte realitetin. Kështu ajo i largohej edhe dashurisë. Vëtmia, kyçja në apartament e bënte të mos shihte dy herë një njeri në rrugë. Si dreqin do mbinte ajo martesë me dashuri, atëherë? Me frymën e shenjtë? ... Ia thashë turbull të gjitha këto, ia fsheha sa munda kapitullimin, pastaj kalova pa ngurim në krahun e hallës:

- Halla ka të drejtë!

Vazhdonte po ajo trokitje e gishterinje në gotë dhe mua ende dhe sot më kumbon në vesh ai ritëm ngjethës. Ngriti gotën pastaj, buzëqeshi lehtë-lehtë dhe e trokiti me ne.

- Gëzuar! Hallë, më gjej një burrë pas shijeve të tua, bisedo vetë me të dhe unë jam dakord!

Halla ia nguli sytë.

- Nuk bën shaka?

- Pazar i mbaruar! - ia ktheu Ana.

Dhe nisi t'i përplaste sërisht papilat e gishterinje në qelq.

Koha e tanishme

I

Më dy janar Ana i zbriti trenit bashkë me hallën në stacionin hekurudhor të Tiranës. Më kishte thënë që nuk do të vinte dhe unë as që e diskutoja vendimin e saj. Po binte një muzg çuditërisht i kaltër për janarin në Tiranë, kur trokitën disa herë në derën e prindërve të mi. E hapi nëna, duke menduar se do qe ndonjë vizitë e përvitshme fqinjësh. Nuk e njihte Anën për portret, po kur Ana ia tha emrin, ajo u tregua aktore e shkëlqyer, përplasi duart e thirri:

- Më raftë pika, të lashë në këmbë! Eja, eja, hyr brenda!

Nëna ime ka dobësi për të bukurën. Edhe Ana dukej shkëlqyeshëm. Kishte veshur një palë pantallona me stof leshi ngjyrë gri dhe një pulovër me supe të rëna në ato nuanca. Ajo përdorte rëndom këpucët pa takë, por atë pasdite kishte zgjedhur një palë këpucë me takë të larta dhe trupi i dukej edhe më tërheqës. Fliste pak, më shumë i përgjigjej shkurt nënës dhe babait tim, kurse mua më drodhi ajo fjala që tha në fund në adresën time:

- Keni vajzë të mirë! ...

... Me mësime shkon shumë mirë, sillet korrekt me shokët dhe shoqet në klasë ...

U drodha sepse më ngjau me mësueset e mia të hershme. Dinjiteti asaj i jepte një fuqi imponuese të jashtëzakonshme dhe unë them se ata që kishin të bënin me të, asimiloheshin prej saj. Bëheshin më të bukur e më njerëzorë. Megjithatë toni i mësueses më drodhi e s'më pëlqeu. M'u kujtuan vetëtimthi një nga një, e si figurina shahu, mësueset e mia të hershme. Ato ishin plakur të gjitha. Mplakja as që kishte

pyetur për mirësitë e bukuritë e tyre. Pedagogjia të plak shumë shpejt. Dhe mua më trishtoi mendimi se gjithë ajo bukuri kishte një brejtës të tmerrshëm përbrenda, plakjen, e cila e distanconte nga unë deri në atë masë sa t'i jepte tonin e mësuesit ... Më mirë plakja, se vdekja, do thoshte më vonë ... Unë e kisha kuptuar se ku dëshironte të dilte ...

- Babai im, - do vazhdonte, - ka dalë që 14 vjeç partizan, ka shkuar në të gjitha aksionet e para të rinisë, siç i pëlqen të thotë, ka ngrënë bukë me shalqi apo marmalatë dhe prapë ka punuar si hero, ka luftuar kundër karkalecave, kundër diversantëve, kundër fesë e me radhë ... Po paqja nuk qe për atë! Unë mendoj se ca njerëz e keqkuptojnë paqen, e cila, realisht, nuk ekziston kurrë, përderisa njerëzit luftojnë parreshtur për t'u përsosur. Ata ia këputin me gjumë dhe kënaqen me ëndrra. Po e di ç'shikon njeriu në ëndërr? Vetveten! ... Mua prandaj nuk më kuption ai, sepse Shqipëria për atë ka dalë në plan të dytë, në plan të parë qëndron familja e tij!

Sikur e mprehete shumë problemin. Tragjedizëm artificial, do ta kish përkufizuar ligjëratën e saj mësuesi im i letërsisë së realizmit socialist, një miop që mezi lexonte gërmat e librave, siç thuhej, e pale nëntekstet! Ana nuk do të binte dakord me mua.

Ishte e ashpër!

Atë pasdite ndeji gjatë, derisa erdhën disa miq të babait për vizitë. Atëherë u ngrit dhe ne dolëm bashkë. Në darkë do ta gjeja çuditërisht nënën të dashruar pas Anës dhe do përlotesha nga gëzimi kur ajo të përsëriste vazhdimisht:

- Goxha vajzë! E bukur, t'i futësh kokën në kuti! Gjynah që nuk gjen një burrë si veten! ...

E dija, ishte krejt e sigurt se prindërvë të mi do t'u pëlqente Ana, me ta njojur. Dhe lumturohesha që e zgjodha vetë këtë shoqe dhe e mbrojta me ngulm para sulmeve të tyre.

Ajo shëtitje ishte magjike. Në rrugë, rreth nesh, hidhnin fëmijët fishekzjarre të mbledhura nga nata e Vtitit të Ri, të dehurit këndonin dhe ishin paqtorë, vetëm njëri na uroi 'ju

vdektë burri, kaq të mira jeni!', parreshtur dëgjoje 'Gëzuar!' majtas, djathtas, sa s'mund të mos ndiheshe dot e gëzuar! Mua m'u shkrep t'i flas asaj për Ilirin. E njoha në mbrëmjen e Vtit të Ri te restorant 'Arbëria'. Ishte kimist dhe nuk u tregua indiferent ndaj meje. Ai u bë i gjallë aty nga mesnata dhe ne kërcyem disa herë bashkë. Herën e parë me bezdi, sepse mua nuk më pëlqeu ironia e tij në tavolinë. Thuaqse për gjithçka që rrëfehej, ai do ngulte kunja në fund. Kulmi ishte kur i tha një biondeje të lezetshme, një shoqes së punës të Silvës, që po na shiste mend se nuk e hante dot peshkun, po mos ia qëronte njeri: 'Ke të drejtë, duket je mësuar të hash vetëm mish me kocka. Ndonjë brinjë! ...'. Edhe mua ma ngjeshi një batutë nga pas, kur u mburra si budallaqe me këpucët e reja që sapo kisha bërë te Porosia ... Këto janë tamam këpucë, tha seriozisht, bie shi në mal të Dajtit, të fusin ujë në Tiranë! ...

Ana u shkri.

- Paska qenë numër! - tha.

Ku e ke xhelozinë, gati sa nuk ulërriva nga dhimbja, sepse në atë mungesë xhelozie, makar, zilie, ngrihej përsëri nëna dhe mësuesja, ajo distancë makabre, të cilën e vendos mosha. Kurse ajo ishte vetëm pesë vjet e pak muaj më e madhe se unë!

I tregova pastaj kulmin fare, kur Iliri kishte shkuar në WC, por i pati gjetur të gjitha dyert të kyçura nga brenda. Ai fillimisht qe habitur, veç shpejt e kuptoi se në banjë po ndërronin fustanet sqimataret, ato që kishin ardhur me valixhe e garderobë me vete për t'u dukur sa më të lezetshme në mbrëmjen e shënuar, dhe kishte nisur të trokiste në çdo derë dhe të bërtiste me të madhe:

- Vajza të dashura, mos harroni të vishni mbathjet! Vajza të dashura, ju kujtojmë mbathjet! Mbathjet! ...

Ana u mek nga e qeshura.

- Fantastike! - tha.

I flisja për Ilirin si e dehur në atë vorbull njerëzish e të qeshurash. Ajo më dëgjonte pa më ndërprerë, pastaj më puthi duke ecur.

- E di që më duket se e do? Mbarove edhe ti! - qeshi.
Askush nuk do të mund të ma thoshte këtë, ajo ma tha.
Një lukuni njerëzish, po të panë të lumtur, të pyesin si me shqetësim: ç'ke që je e mërzitur? ... Xhelozë ordinerë!
Unë nuk i thashë se ishte pikërisht ashtu, siç vuri re ajo, por indirekt ia pohova rënien time me të dyja këmbët brenda, kur pshërëtiva me gjithë shpirt:
- Mbase fejohemi të dyja këtë vit!
- Mbase, - pohoi, - mbase njohim njerëz për së mbari!
Do shkonte të flinte te halla dhe m'u lut ta përcillja një copë rrugë. Në shtëpinë e prindërve kishte qenë për darkë, po nuk deshte të flinte atje ...
- Më mërzit vëllai, - tha, - edhe kujtimet më trishtojnë shumë ...
U pendova që e ngava bisedën dhe m'u mbyll goja. Ç'm'u desh, shava veten, megjithë edukatën morale! ... Gjyshja ime do tundte kokën: mos e zbulo bythën, se ta cimbisin galat! ... Anës iiku dëshira e të folurit. Po pikërisht atëherë ajo thirri befas:
- Koli!
U takuan me një ndjenjë të dukshme gjëzimi dhe mua m'u duk sikur Sokoli e puthi lehtë në faqe kur u përqafuan. Ndoshta e puthi edhe Ana. Ndoshta ... E ç'rëndësi ka, iu hakërrova vetes, bash atij sektori feudal. Shkëmbyem pyetjet e para të zakonshme, pastaj ai na kapi të dyjave përkrahu.
- Hajdeni t'ju jap ndonjë gjë te 'Tirana'!
- Mos u shpenzo! - i tha Ana.
- Vërtet, s'e ke keq, - ia ktheu ai, - tani jemi në moshën që duhet të imitojmë lypësit! Duhet të mbledhim edhe qindarkat, për pajën e martesës në prag ...
- Paske mendje të mirë sivjet, - e ngava unë.
- Natën e Vtit të Ri e kalova me fisin e afërt të babait. Dyzet xhaxhallarë, halla e fëmijë, plus nipërit e rritur dhe prindërit e mi. Katërqind herë më uruan unanimisht: Në dasëm tani, boll prite! ... Apo nuk uronin me figura letrare e profesionale! Një vajzë halle, ekonomiste mizerabël, më tërroqi vëmendjen me dolli se tani akumulimi im kaq i

gjatë duhet të investohet në martesë të favorshme ... Xhax-hai, një inxhinier i thekur i pyjeve, më uroi t'i ngaj plepit, që për shtatë vjet mbin e hyn në prodhim. Mos i ngaj pishës e bredhit në këto punë, që të thinjin e të mbulojnë e mezi bëhen pemë! ... Ç'pyet!

Dhe queshte pa pushim. Pastaj i la qyfyret e tavolinës familiare dhe filloj të vëzhgojë Anën.

- E di që je zbukuruar, - i tha. - Nuk tallem! - shtoi.

- E di, - ia ktheu Ana. - Janë forcat e fundit të bukirisë.

Kam zbritur të shitem në pazarin e Tiranës!

- Me çfarë çmimi? Ta dimë, të kontrollojmë gjendjen financiare, se ku i dihet!

- Falas fare!

- Po! - tha ai, dhe unë nuk e mora vesh pse duhej ajo 'po' aq absurde.

Nuk dinte ç'të thoshte, do më shpjegohej më pas Ana, i erdhi e gjithë biseda së prapthi, unë ia njoh pikat e dobëta atij ...

Qeshi mbytur.

- Gjej ndonjë plakaruq dhe mos na harro ne!

Sytë e Anës ishin të butë, plot lëng. Dhe ai humor aq i zi! Mendova se Ana, për shpagim, do niste nga ironitë, por ajo mbeti po aq e butë e paqësore sa në fillim.

- Më ke parë ndonjëherë në ëndërr? - e pyeti Sokolin.

Tjetri qeshi me trishtim.

- Kam ardhur para një muaji në mbrëmje deri te dera jote, atje u pendova me dorën nderur për të trokitur dhe u ktheva në Tiranë ... Harrova se mosha jonë nuk është më e para. Tani, në vend të qeshim, qajmë ...

- Ne kemi qarë dikur!

Ai tundi dorën.

- Ti je një nga ata që qahen të gjallë, - vazhdoi ajo, - unë për veten time të kam qarë ...

Sokoli futi dorën në xhep, nxori lekët, pastaj shkoi në banak dhe pagoi te kamerieri, që po priste mbushjen e porosisë së hedhur në sportel. Mori restin dhe iku pa na thënë asnjë fjalë.

- Ç'pate, - e pyeta e çuditur.
 - E meritonte, - tha. - Ca gjëra unë i di më mirë!
- Pastaj pa gurosjen time dhe qeshi:
- Mos u mërzit! Do vijë prapë! U inatos me veten e tij, prandaj ia mbathi ...

Ai erdhi vërtet, atëherë kur Ana ishte duke notuar në ujërat e fejesës e më në fund po i dilte në breg asaj pune dhe kush e di me ç'mendje trokiti te ne, sepse sytë i shkëlqenin tmerrësisht. Unë ngriva. Nuk dija si ta prisja dhe as mund ta imagjinoja se si do sillej Ana me të tanë, në prag të fejesës. Ajo e mbajti Sokolin për darkë, por që në trokitjen e parë të gotave i tha se do fejohej. E vuri kufirin, mendova.

- Të trashëgohesh! - u ngazëllye ai, por u ndie se si iu fikën në çast të gjitha dritat.
- Nga njëra anë më erdhi mirë që u mërzit, - më tha pasi iku Sokoli. - Ç'u pa, po nuk pagove diçka!

Dhe që në atë dolli darka u prish. Atij i shteroi humori tërësisht dhe vetëm kur po kapërcente pragun e po na uronte natën e mirë e pushtoi Anën, e puthi mirë e mirë, shtruar e më qejf të tij, dhe i tha:

- Mirupafshim, motra!

Ana i tundi dorën në ajër, pastaj pëllëmbën e nderur e nisi për te vendet ku e puthi ai. Duket donte t'i fshinte të puthurat, por nga buzët e çoi dorën menjëherë te ricat, sepse Sokoli e ktheu kokën në zbritje e sipër. Atë ditë mua më erdhi përfundimisht tmerrësisht keq që ata të dy nuk i lejuan të martoheshin bashkë. E njihnin njëri-tjetrin me rrënje. Mbaj mend që ai qeshi ëmbël e me zë kumbues dhe i tha:

- Fshiu, motra, se nuk ofendohem!

Ku e mori vesh ai se ajo donte të fshinte pikërisht gjurmët e puthjeve të tij?

- Fshiu, motra, fshiu! - kumboi edhe një herë zëri i tij nëpër shkallë. Pastaj u zhduk. Fshihu! ... Pse e përdori këtë folje të dykuptimit? T'i thoshte Anës, fshiji puthjet e mia përfundimisht, apo atë tjetrën, fshihu nga sytë e mi, se nuk mbaj asnje përgjegjësi për sjelljen time ndaj teje ...

2

U kthyem në punë pas pushimeve të Vtitit të Ri dhe jeta jonë sikur rihyri në atë ritin e parë. Ana po e përfundonte mësimin e anglishtes, Vera e Salvadore vinte rregullisht dhe ne thuajse nuk dilnim fare pas përfundimit të punës. Të priste era e detit, kurse klubet ishin të pushtuar vetëm nga burrat. I vetmi mashkull që hynte e dilte rregullisht te ne ishte Salvadorja. Nuk shkelte kurrë në dy ditët kur mësonte Vera. I dukej sikur vajza do ta merrte ardhjen e tij për survejim, kurse ai qe betuar një herë se nuk do ta bënte këtë gjë. Do sillte diçka me vete Salvadorja, o lajme të çuditshme, o peshk ... Në dimër ujërat janë të turbullta, na shpjegonte mbarësinë e gjuetisë së tij, peshku bie kollaj në grackë ... E qëronte gjahun vetë në banjë, e lante vetë, e skuqte fare pak, pastaj Ana ia rregullonte në një piatancë të madhe me sallatë dhe i vinte përpara shishen e verës. Ai pinte, ne i rrnim zakonisht nga të dyja krahët.

- C'bëhet, Salvadore? - e pyesnim.

- Luftë! - thoshte si fillim, pastaj na tregonte për jetën e qytetit, për të burgosurit që qenë kthyer nga amnistia e madhe, për atë tipin që doli pas dhjetë vjet burgu dhe kur shkoi në shtëpi e takoi gruan tha të nesërmen se ia kishin ndërruar zonjën. Unë e pata të re fare ... Për atë fantastikun tjetër, që i binte të dilte nga burgu në vitin 2004 dhe që atëherë në gjyq i kërkoi prokurorit t'ia ulte dënimin, që ai të lirohej në vitin 2000 ... Pse në 2000, e pati pyetur gjykatësi, një djalë naiv ... Po, sipas Biblës, më 2000 do shembet bota dhe unë, si njeri i ndershëm që jam, nuk dua t'i ngelem shtetit katër vjet burg borxh! ...

- Ç'është ky? - qeshte Ana.
- E ke në punë! - thoshte Salvadorja. - Për dy-tre ditë do paraqitet në fabrikë. Do ta njohësh! ...

Në fakt Ana e njohu të amnistuarin e Biblës. Ai i tha në mes të klubit:

- Po ti, nuse, te ne punon?
- Po! - iu përgjigj Ana.
- Të dhëntë zoti shëndet, se qenke e mirë! Kur të shikon ty, të rritet respekti për veten! Po të ra kush në qafë, mos më kurse, më ke mik! ...

Salvadorja na tha se tek ai mund të mbështeteshe vërtet. Nuk fliste në erë, ai tip! ... Dhe, teksha ne ia hymë me Salvadoren filozofimeve që, si ka mudësi që një tip ordiner, që do kalbej burgjeve, i del në çast në mbrojtje bukurisë, kurse ca intelektualë e minojnë atë, Ana i tregoi një fustan Salvadore:

- Të pëlqen? - e pyeti duke e nderur në trupin e saj. Ai e pa mirë e mirë. Pastaj ia hodhi sytë Anës.
- I bukur, - tha, - po a të bën ty? Nuk ka për të të rënë pak i shkurtër?

Ana qeshi.

- Dëgjo, Salvadore! E kam qepur për Verën! Po t'u duk shumë modern, nuk ia jap! Po të pëlqeu ty, do t'ia dhuroj!

Ai më pyeti mua, a bënte mirë ta vishte Vera?

- I bukur është, - i thashë.

Bëri me dorë.

- Ju e dini ç'është e mirë për atë! Jepjani, po të doni! Paçi e dhënçi! - uroi në fund.

Ana e palosi fustanin, e vendosi në gjunjët e saj, pastaj hapi gojën dhe tha atë gjë që më çuditi krejtësisht:

- Salvadore, sa vjeç është Vera?
- Tetëmbëdhjetë! Pse?

S'iу përgjigj për një çast. Donte siguri që nuk do të keqkuptohej. Si u bind, ia nisi me kujdes:

- E kam vënë re nga dritarja se vjen e pret një djale, kur del që këtej nga mësimi i anglishtes. Ai tekniku i frigoriferëve ... Mua Vera nuk më ka treguar gjë, por unë

atë që kam parë nuk dua të ta fsheh! Nesër mund ta marrësh vesh nga burime të tjera dhe m'i var mua kusuret në qafë!

...

Salvadorja u bë mehit. I ngeli gota e verës në dorë dhe s'kishte fuqi as ta shpinte në gojë e as ta ulte në tryezë.

- Ai balashi?

- Biondi! - tha Ana.

- E ç'rëndësi ka ngjyra! - tha ai, pastaj shau.

Na shihte të dyjave në sy, si i goditur. Kur unë mendova se do kërkonte hollësira për fajësinë e Verës, ai e pyeti befas Anën:

- Ti, si thua?

- Mua mos më pyet, - qeshi Ana, - mua mund të më pëlqejnë zeshkanët dhe për biondët mund të kem alergji ... Për këtë nuk urdhërohet dot Vera: mos më rri me atë flokëverdhin, se nuk më pëlqen ngjyra e flokëve të tij! ...

Mua më tha Vera më vonë, ca muaj pas kësaj bisede, se i pati ngelur hatri nga spiunimi që i bëri Ana te babai, por nuk foli e s'tha gjë, se nuk e kishte zakon të shkëmbente llafe.

- Po ti, a e kupton se ç'mund të më bënte babai mua? Ktheu me E njeh mirë Salvadoren? E di që ta përdredh qafën si të zogut për këto punë? Apo, punë e madhe, se qafa e Verës është! Ajo nuk deshte telashe dhe unë e kuptoj një farë soji, por nuk është mirë që telashet t'i heqësh nga vetja e t'ia varësh tjedrit peshqesh në qafë! ...

- Jo thjesht telashe, - ia ktheva, - nuk donte të mëritej me Salvadoren! ...

Ajo tundi kokën, si të deshte të thoshte 'lere këtë bisedë, u morëm vesh! ...'. Pastaj tha duke më vështruar pjerrtas:

- Kaq shumë e do ajo babën?

Tunda kokën.

- Ai ia ka mbajtur krahun pa e njohur fare, kur të njohurit ia mbanin shkelmin në fyt! ...

Por edhe mua më pati habitur paditja që i bëri Verës Ana. Ishte rasti i vetëm që u tregua egoiste dhe kur ia thashë një herë këtë gjë, ajo ngriti supet:

- Po si të bëja unë, sipas jush? Të respektoja me fanatizëm sjelljen teorike, që të më fuste pastaj praktika në varr?

Nuk dija si t'i përgjigjesha, ndërkokë që ajo më shihte provokueshëm në sy. Më ranë djersë nga sikleti, ashtu siç i ranë djersët edhe atij burri para Anës. Mbaj mend me ç'trishtim e uli gotën në tryezë, si futi dorën në xhep e nxori shaminë, fshirjen e qafës me një lëvizje të ngadaltë e të gjatë të dorës dhe pshërëtimën e thellë:

- Bëla!

Nuk dinte, bile s'kishte as idenë më të vogël se ç'duhej të bënte në ato çaste.

- Gjakun s'e ka të keq, - mezi shqiptoi, - po ...

Dhe fjala i ngeci prapë në grykë.

- Salvadore, - ndërhyra unë, - të dy janë të mirë. Po e pëlqyen shoku-shokun, do martohen ...

- Unë e di që një e një bëjnë dy, - ma preu ai, - po nuk u ndanë, do martohen! ...

- Unë them mos hysh ti në këtë mes, - ndërhyri Ana në ndihmë time, - Vera është vajzë e mençur! Di t'i rregullojë punët e veta ...

- Po sikur ... - dhe Salvadores nuk i bëri goja ta thotë foljen 'të ndahen', - a kam veshë unë me mbajtë fjalët e qytetit? Vetëm me vra gjysmën e robve!

- Nuk do flasë njeri! - këmbënguli Ana. - Ata nuk janë njerëz që e bëjnë veten përfjalë!

Salvadorja përtipej. Kushedi i kujtohej Ana, që sa bëhej gati të fliste, e qepët gojën në çast. Kushedi ...

- E dini, - tha më në fund duke i përtypur fjalët, - nuk do t'i bie në sy! Edhe po i pashë në rrugë të dy, megjithëse ruhet prej meje ajo dreq! ... Jam betuar përfjetë bukë që ha se ajo vajzë do ta bëjë vetë jetën që ka risk! Nuk dua të më zerë buka! ... 14 vjeç kam qenë kur më qiti plaku në punë dhe ja ku jam! Dy klasë shkollë kisha, dhe dita me ecë! ... Ajo ka shkollë tamam, mbase nuk ia ka nxjerrë mendtë! Ju ka edhe ju ...

Ana e kapi përfqafe me një hedhje të plotë të krahut në supet e tij, pastaj u ul në dorezën e kolktukut ku qëndronte ai.

- Salvadore, a tē tē puth pak? - e pyeti.

- Ç'i ra njeriut dhe s'e mbajti! - tha ai.

Ajo qeshi me tē madhe dhe e puthi pranë syve.

Ai e shtyu lehtë me parakrah.

- Ik, - i tha. - Shyqyr që nuk je e martuar e nuk lyhesh me tē kuq, se nesër Salvadoren e gjeje copash! Kish për ta therrë Maria si berr! ...

Gurgulloi e qeshura jonë. Ana u ngrit, mori dy gota tē tjera, duke e ngacmuar Salvadoren që mos hiqej më katolik se Papa, se ia dinte mirë aventurat që kishte bërë, pastaj u kthye në kohën që Salvadorja po mbrohej me atë klasiken ‘flasin gojët e liga’, dhe, si i mbushi gotat me verë, ma zgjati njérën mua dhe e trokiti me zhurmë me ne:

- Gëzuar!

E ktheu gotën me fund. Fshiu buzët me pecetë dhe qeshi përséri. Kur Salvadorja iku, ajo nuk më la ta ngrija tryezën.

- Na fërgo ndonjë peshk, pijmë edhe ne pak verë, - tha.

- ... E di, ti, Vera, - i thashë më në fund Verës së prekur në sedër në bisedën e mëvonshme për spiunimin që i pati bërë Ana, - atë natë, kur u bindëm se Salvadorja nuk do tē lëvizte as gishtin e vogël tē dorës ndaj teje, ne pimë verë dhe Ana u deh vetëm për gjëzimin tënd!

- Ama, egoiste u tregua! - tha Vera.

- Më pëlqen që ju s'térhiqeni nga e vërteta, sado e hidhur qoftë ajo! - i thashë.

3

Një mbrëmje vonë ra dera.

S'ishin trokitje të lehta, të fshehura nga veshët e fqinjëve, tinzare. Dikush godiste fort në portë me monedhë. Zgjohuni, thoshte ai gjëmim! ...

Sapo ishim zhveshur dhe qemë futur në shtresa dhe Ana pyeti që nga dera e dhomës se kush trokiste.

- Salvadorja! - gjëmoi i gëzuar zëri i njohur për ne.
- Avash, se theve derën, - e paralajmëroi Ana.

Dhe shtoi:

- Mos i bjer më, se të dëgjuam! Prit sa të vishemi!
- E shemb dhe e bëj të re! - briti Salvadorja që matanë.

Dukej si i dehur dhe Ana më pa me çudi. Kur trokiste te ne, ai nuk kundërmonte kurrë erë alkool.

U veshëm dhe hapëm derën. Pa pritur të hedhë këmbët mirë brenda në korridor, Salvadorja e rrëmbeu Anën në krahë, e ngriti pupël lart dhe filloi ta rrotullojë në korridor.

- Sonte s'ka gjumë! - thirri. - Maria ju pret në shtëpi me gjithë krushqit! Janë shtruar tavolinat! ...

- Vërtet! - klithi Ana.

Salvadorja e lëshoi.

- Erdhën dhe kërkuan sonte dorën e Verës!
- Na përqafroi me një gëzim prekës. Sa nuk qante.
- Le nam! - i tha Ana duke i rënë me grusht në sup. - Sikur ke kapur ndonjë levrek dy-tre kilosh bën! ...

Atij i rroddhi një lot i vetëm, siç bie një pikë uji nga rubineti i çezmës i shtrënguar me forcë menjëherë.

- Pasha bukën, ju e qitët në dritë Verën, se Salvadorja ia kishte zdruguar kokën tani! ...

Ishte tmerrësish i lumtur. Nuk i pushonte goja atij tipi përgjithësisht të heshtur dhe, ndërkohë që ne filluam të visheshim me rrobet më të mira, unë në kuzhinë e Ana në dhomë, ai na tregonte duke qeshur që nga korridori se si erdhën krushqit në mbrëmje krejt pa lajmëruar, si e gjetën Marien të veshur me përparësen e punëve ...

- Ha,ha! - queshte. - Maria nuk e deshte veten! E gjetën me një derr peshku në dorë, sa u trembën të shkretët, kushedi si iu duk, mbasë si fëmijë i therrur! ...

- Na e shpife, Salvadore, - i bërtisnim ne.

- ... Po Verën, ta shikoni si është bërë me atë fustanin që i dhatë ju! Si me qenë rreze dielli në majë malit! ...

- Pse në majë malit pikërisht? - e pyeti Ana, që doli e para në korridor.

- Atje është më e pakët dhe më e ndritshme, - shpjegoi Salvadorja. Dhe u tall me Anën, kur shtoi me ton shkençtari: punë këndesh të rënies së diellit në majën e malit!

...

Në rrugë mbaj mend që tundeshin nga era plepat e njomë të porsambjellë, bregu dërgonte një gjëmim të mbytur dallgësh, duhej të ecje me kokën të kthyer anash nga pallatet e qytetit, që të shpëtoje nga futja e grimcave të pluhurit në sy. Unë fillova të këndoju me zë të ulët, e dehur nga gjëzimi, kurse Ana qau në kohën që po ktheheteshim në shtëpi gati në të gdhirë nga ajo festë familjare. I shpërthyen lotët që në shkallë, pa duruar të hapë derën e të kyçet brenda mureve, të verë kujën pastaj deri në kupë të qiellit e të qajë sa të ngopet. Unë nuk e pyeta pse i shpërtheu gjithë ai rënkim e shpërthim lotësh. Nuk zotëroja aq fuqi fizike e morale, që ta formuloja atë pyetje.

4

- Mos qaj, - iu përgjërova Anës atë natë, - si ka thënë Naimi: Lum kush të rronjë, ta shohë zonjë ...

- Ai ka dhënë këshilla për ata që dinë të lexojnë - ma ktheu, - e jo për analfabetët!

E kundërshtova butë.

- Edhe për ata që dinë të dëgjojnë, Ana!

- Po, - tha krejt papritur, duke fshirë lotët. - Ma recito pak edhe atë vjershëن tjetër, 'Jakë, o ditë e uruar ...'!

Tunda kokën.

- Atë një herë tjetër, - ia preva.

S'bëri fjalë.

- Si të duash, - u tërhoq, - unë për të mirën e Naimit ta kërkova, meqë atë e ka vjershëн më gjeniale ...

Pastaj mërmëriti edhe një herë 'Lum kush të rronjë' dhe e qepi gojën. S'kishte dëshirë të fliste më.

Ditët tona ishin të bukura vërtet. Erërat sa vinin zbuteshin, në qytet po shfaqeshin gjithmonë e më dendur gjahtarët e rosave me çifte në krahë e zagarë që u vërtiteshin nëpër këmbë. Sytë e Anës ftoheshin papritur, me të pikasur zagarët. Asaj i përngjanin me ata frymorët pseudonjerëz, të cilët patën ëndërruar me pasion e fantazi njëherësh, që ta bënin Anën të tillë, të lëvizte bishtin orë e çast e t'u lëpinte këmbët. Kjo metamorfozë e tmerronte dhe mbërt hej nga melankolia e Brutit, siç mundohesha të tallesha unë për t'iа larguar mendjen e keqe. Por nuk qe nevoja as për njohuri nga lashtësia e as për teatër, se zagarët zhdukeshin pas bërryilit të rrugës, ashtu siç ishin shfaqur, dhe sytë e saj zbuteshin e bëheshin femërorë përsëri. Bile, kur të

ktheheshin në muzg apo të nesërmen gjahtarët me bisht ndër shalë e qen të mërzitur ndër këmbë, ngaqë nuk kishin plagosur, e jo më vrarë ndonjë gjë, Ana do të shkrihej fare në dritare e do të më thërriste mua:

- Ema, eja, më qafsh! Mos e humb rastin! Shikoji trimat! Ha-ha! Kur s'ke mend, ke këmbë! ... Ku e dinë këta fakirë se gruri, ai grurë socialist që bën një lek kilogrami, i ka fshirë me kullota e i ka ngrënë me rosa e derra të egër! ...

5

Pikërisht në këtë kohë në jetën time filloj të ngrihej e të zinte gjithmonë e më shumë vend figura e Ilirit. Ai më priste rregullisht ditëve të shtuna te stacioni i trenit dhe unë fillova të mendoj se është vërtet fatkeqësi e madhe kur nuk të pret njeri në stacion në kthimin prej udhëtimit të largët. Kisha harruar menjëherë se për vite me radhë nuk më priste askush në çfarëdolloj stacioni, ose, më pamëshirshëm, askush nuk denjonte të çante kokën përmua. Por kështu ndodh. Dashuria shkakton rrëmujë në kujtesë. Gjithçka mes meje e Ilirit filloj si rastësisht, por ajo rastësi binte erë një orë larg që nuk qe krejt ashtu si servirej. Dukej èndërr. Ai më takoi për herë të parë në rrugën e trenit, nga ku kthehesha të shtunave në shtëpi. Më tha se kishte patur punë në laboratoret e Fakultetit të Shkencave të Natyrës dhe unë bëra sikur e besova, megjithëse nuhatja s'më kapte kund aromë shkence. Më vinte pak për të qeshur, sepse e dija gati pikë për pikë skenarin e mëtejshëm, vetëm lokalini ku do të më ftonte për akullore s'po e përcaktoja dot saktësisht, te 'Arbëria', apo te 'Rinia'... Më ftoi te 'Rinia'. Duket ishte hollë nga të hollat, ose atje e mori guximin të bënte ofertën. Kushedi! Po unë hëngra një alamet torte të shoqëruar me limonatë të ftohtë, kurse ai filloj të më flasë për punët që kishte nëpër duar. Tak, më kërciti zemra. E mora vesh se ai nuk do humbiste, si ca portrete të tjera, e u binda aq më tepër kur e pyeta për diçka e ai m'u përgjigji moskokëçarës 'këtu jemi, do të flasim prapë'. Java ime e ndërrroi tani në kalendar ditën me të kuqe. Vendin e së dielës e zuri e shtuna dhe e diela u bë edhe një herë

monotone e bajate si në gjimnaz e fakultet, kur shoqet shkonin në plazhin e Durrësit e më linin fare vetëm, duke kullotur sytë në tavanin e dhomës sime, për të ruajtur virgjérinë nga dielli e uji e dreqi, siç urdhëronte heshturazi im atë. E shtuna tani pritej me padurim. E shtuna ofronte dashurinë, besimin te njeriu, te botë. Ana më përcillte në stacion, priste derisa hypja në vagon, nisjen e trenit pastaj, që qëndronte vetëm tre minuta në qytetin tonë, pastaj kthehej ngadalë e ikte njëherësh me nisjen e trenit përpara. Të dielën në darkë më priste me tryezën shtruar dhe, si nxirrja ushqimet e ëmbëlsirat e marra prej nënës, ulesha e i tregoja fill e për pe se ç'kisha bërë me Ilirin, ku qemë futur e ç'patëm ngatërruar ... Kështu pyeste, ku u futët e ç'ngatërruat, dhe fjalët i dilnin natyrshëm, pasi në këto punë atë e kishte ekzekutuar egërsisht legalizimi ... Të gjitha ia tregoja, bisedat e mia me Ilirin, puthjet në kinemanë e zbruzur me një dhjetë çifte dashnorësh brenda, vetëm takimin me Sokolin një të diel të lagësht ia fsheha. Ne gati u përplasëm te dera e një bonbonerie, ku ai po hynte e unë po dilja me ca amareta për djalin e Silvës. Kishim një copë rrugë të mirë për të ecur bashkarisht, prandaj e prita në trotuar sa bleu diçka edhe ai. Ajo ishte një e diel pa quell e diell, e zymtë, me biseda të hirta.

- Ç'bën Ana, - më pyeti.

- Mirë është, - ia ktheva.

U ruajtëm mos spërkonteshim nga autobusi që na kaloi përbri e që dukej se shoferin e kishte nga ndonjë familje me origjinë detarësh, se joshej vazhdimisht nga pellgjet e rrugës.

- Ajo është e mrekullueshme, - më tha me një zë të trishtuar, - sillu mirë me të, se ty të ra në hise kjo punë. Nuk besoj ta ketë më sistemin nervor të dikurshëm ...

Mua diç më gjerrici në gjoks. Pse ma tregonte ai që ajo na ishte e mrekullueshme dhe me nerva të dobësuara, dhe nuk ia shkoqiste këto gjëra vetes së vet? Unë s'kisha ndërmend t'i predikoja atij t'i hypte trenit me mua në muzg e të vinte t'i shfaqte dashurinë Anës. Në ca aspekte ai

ndodhej më pranë Anës nga unë. Po as largimin e tij me përdhunë s'mund ta mendoja dot e ndoshta s'më vinte as mirë ta kuptoja, meqë tani ndodhej Iliri në këtë mes. Jam e bindur si buka që ha se dashuria nuk mbahet dot më këmbë pa lëshime reciproke. Dhe këtë e them për dashurinë në përgjithësi, jo vetëm për atë mes dy njerëzve, por për dashurinë e përgjithshme, dashurinë e njeriut për punën. Mendo, as balona, që balonë është, dregi ta hajë, nuk ngrihet lart po nuk i lëshove e tërhoqe fillin e as peshku nuk del në breg, kur i bie grepit, vetëm duke i tërhequr filispanjën. Dhe ia ktheva:

- Nuk ma ha mendja se ajo është bërë për mëshirën tonë.

Qeshi hidhur, më dha dorën për t'u ndarë, pastaj tha:

- Sidoqoftë, Anës mos i thuaj që u takuam bashkë, por, të lutem, kujdesu për të! Eshtë bërë si iriq, kurse ajo është njeri dhe çfarë njeriu, apo jo?

Nuk ia zgjata dhe, kur iku, për herë të parë se ç'ndjeva një hidhësi prej atij mashkulli. Se si m'u duk, si zdroms! Një burrë që qan, e ka vendin në dhomën e grave!

Pastaj, kur mbeta vetëm, befas m'u krijuat gjithmonë e më ngulshëm ideja se ai pohoi një të vërtetë mizore kur krahasoi Anën me iriqin, në atë kryqëzim rrugësh të shpëlara nga shiu. M'u shfaq qjë iriq që qëllohet nga çdo anë barbarisht, që i sulen kafshë të tmerrshme nga çdo anë dhe ai mbyllët përfundimisht në gjembat e tij e s'guxon të çlirohet më. Kështu, deri sa asfiksohet dhe mbytet nga mungesa e ajrit në vetminë vrasëse ... Kush ishte mbytur kështu, i izoluar nga natyra e shoqëria. Ana? Unë? Ne? ... Nuk flas dot, nuk shkruaj dot, duart s'i binden logjikës e logjika njëherësh preferon të mbyllë gojën si ai iriqi tragjik, për të vetëvdekur edhe ajo, por për një gjë jam e bindur prej asaj të diele: Anës ne të gjithë i kishim hapur një varr të bollshëm para këmbëve. Një varr i hapur duke marrë parasysh gjithçka, edhe madhësinë e pazakontë të kufomës e të arkivolit mbajtës, një varr gëllabërues, varr varrosës! Ky varr ishte e mira të mbyllej urgjentsht, duke vigjeluar njëherësh me sytë katër pas shpinës së Anës, se mos atë e

shtynte nga prapa ndonjë dorë tinzare e mizore brenda në gropën thithëse të pambyllur ende. Unë e di fare mirë se si vdiq ai fotografi i parqeve të kryeqytetit, që ishte ndoshta banori më pak i prekur nga sëmundjet në rruzullin tonë tokësor. Ai ra gabimisht drejt e në një gropë varri në varrezat e Shtish-Tufinës, gjatë një varrimi të pallogaritur mirë në orë, kur procesionin e kapi nata mes varreve me arkivol mbi supe. Që atë ditë ai burrë i hekurt u bë si i goditur, ecte në rrugë pa e patur mendjen, paguante përditë nga një gjobë te policët e trafikut, aq sa atyre filloi t'u vinte keq për të dhe e pyesnin me bllokun e gjobave në dorë: e, ta vuri ndonjë polic para meje gjobën sot? Dhe, më së fundi, pa u mbushur muaji nga ajo rrokullisje për së gjalli brenda në varr, u shtyp nga një autobus i linjës Bankë-Kinostudio, mu në mes të sheshit 'Skënderbej'. Enët e tij të gjakut mahnitën anatomo-patologët gjatë autopsisë, aq sa njëri prej tyre deklaroi se ky burrë, me këto enë gjaku pa pikë skleroze, do të rronte të paktën një 150 vjet të mira! S'qe e thënë as për gazetarët të shkruanin sensacionin se sa gjatë rron njeriu në Shqipërinë Socialiste! Po pse ta pësonte edhe Ana si ai fotografi?!

Megjithatë, e përsëris, Sokoli më la një shije të keqe. M'u duk vërtet tip zdromsi dhe më vonë jam penduar si dreqi që nuk i tregova atë paradite se ç'ndjenja ushqente Ana për të. Zdroms, njeri pa eshtra, ashtu më dukej mua, kurse Anës ... U pendova që nuk e tundova të kalonte ndonjë të shtunë andej, kur unë zbrisja në Tiranë dhe lija pas kushte ideale për një prehje e paqe të madhe. Çdo luftë ka nisur prej burrave që nuk shkonin mirë me gratë dhe çdo paqe, anasjelltas ... Edhe Silva m'i futi xixat më keq, kur më tha atë të diel, pak minuta pasi isha ndarë nga Sokoli:

- Bëre gabim që nuk e joshe. Po vajti një herë të vetme ai, nuk shkulet më! E bën Ana t'i bjerë në gjunjë e të kërcejë pupthi! ...

Ai është friks, ia ktheva unë Silvës. Shkulet, nuk shkulet ... Enigmë e madhe! Veç një gjë dukej qartë që atje tej,

Sokolin e prangonin ca vargonj tē tmerrshëm, ndryshe ... Po pérderisa nuk vinte jo duke kënduar, po as duke u térhequr zvarrë, një perëndi e dinte se ç'mund t'i kishin dëgjuar veshët, ç'legjenda monstruoze pér karakterin e tē dashurës së tij. Dhe, meqë nuk pëlqeу tē përgojohej nga njerëzit ca ditë, mori veten e tij nëpér këmbë, që mos them e shkeli dhunshëm pér gjithë jetën. Seç bëjnë ca llogari groteske frikacakët: do fitoj kaq, ama, një dyleksh nuk investojnë! Edhe Sokoli pér mua mbetet një frikacak klasik, trembet nga rrënim i duke u hequr se është altruist! Edhe kjo është një lodër kalamajsh me mekanizëm tē prishur që kur është blerë: unë bëj sikur fal e nuk flas ç'di, që mos i prish jetën tjetrit!... Kur na erdhi herën e fundit në apartament, mua seç m'u shkrep dhe ia përplasa në sy tē gjitha këto mendime që kisha filluar tē ushqjeja pér tē. Ai m'u përgjigj se nuk rrëfehej jo pér hir tē altruizmit, por se nuk e lejonte fakti që ishte ateist, bile, më ironizoi hapur, kur shtoi: megjithatë, ti mos u mërzit, sepse fonetikisht ke qëlluar pranë fjalës së vërtetë... Po qe puna pér ateizëm, ia ktheva, aq më keq pér ty që identifikon kishën me rrëfimin, sepse rrëfimi ka ekzistuar dhjetëra shekuj para formimit tē kishës. A nuk rrëfehen trimërisht heronjtë e Homerit?...

- Ç'na ngatërron me heronjtë, - ma preu butësisht, - po tē qemë heronj do ishim tē pasur e jo kështu siç jemi, tē neglizhuar edhe nga vështrimet e qenve tē uritur!...

- Ti nuk je trim? - e provokova.

- Unë jam si gjithë tē tjerët, dhjer...

Po e la fjalën në mes e nuk e ndyu gojën.

- ... jam friks, - plotësoi.

E njihte veten pér mrekulli. Ndoshta, pas nja njëzet vjetësh, kur t'i jenë vjetëruar shqisat e mos t'i arrijnë tē kthjellta në vesh dërr-dërrret e kësaj bote gri, pra, kur t'i krijohet përshtypja se bota u moderua e nuk tē keqkupton si në rininë e hershme, ai mund tē ulet e tē hedhë në letër rrëfimin e tij heroik. Në arriftë ta bëjë këtë, në arriftë, ëë, bota do tē verë kujen kur ta lexojë. Fat tē madh do tē

ketë ai udhëheqës që do të vdesë në atë kohë! Do thonë: shiko sa e ka dashur populli i tij! S'janë fare pa vlerë edhe tragjeditë!

6

Po ditët bëheshin gjithmonë edhe më të këndshme, fluturuese, dhe, si ato sitat e dendura, nuk e mbanin në rrjetë pluhurin e trishtimit. Anën e gjeja po aq të bukur në apartament dhe askurrë nuk e mendoja vyshkjen e saj. Iknin ditët, ama, së prapthi, drejt rinimit. Çudi, por kështu ka qenë vërtet. Dhe një pasdite erdhi te ne Iliri. Ai u shkëput sa zuri vend në hotel, pastaj u kthyte sërisht në apartamentin tonë. Unë desha ta përqafaja, ta puthja, ta mbaja në krahë e ta përkëdhelja parreshtur. Për herë të parë e ndjeva veten keq nga prania e Anës. E gjetën shumë shpejt gjuhën e përbashkët dhe unë e humba shpresën e ngeljes vetëm me Ilirin. Por Anës nuk kishte gjë t'i shpëtonte. E pikasi padurimin tim dhe e këputi në çast bisedën duke i hedhur një vështrim orës së dorës.

- Ju, rrini, - tha, - unë po ngrihem, se kam lënë një takim... Punë modelesh, - i qeshi Ilirit, pastaj m'u kthyte mua e më tha se do më priste te Salvadorja...

- Sikur e përzure me përdhunë, - tha Iliri me të kërcitur dera e jashtme nga tërheqja e Anës.

Ndërsa ajo do të më thoshte diçka tjetër të nesërmën: unë nuk do të largohem më, kur të vijë Iliri, po ti ke dhomën tënde dhe mund të qëndroni atje ditë e natë bashkë, po të keni dëshirë. Tani nuk ka më kuqtim për lojëra. Mua ai më pëlqen dhe them se do të bësh jetë me të. Duket tip që lahet...

Meqë ajo i ndante njerëzit në dy kategori, në të pastër dhe zhulsa, ky ishte komplimenti më i madh që mund t'i bënte një mashkulli. Edhe atëherë kur e gjeta të mërzitur

dhe e pyeta se ç'kishte ashtu, m'u përgjigj thatë:

- Hiç, më kruhet trupi, se kam ca ditë pa u larë!...

Po tjetër ishin pastërtitë dhe tjetër qe vetmia, ajo që kishte mundur Ana me ndihmën time e që tanë, me daljen e Ilirit në dritë, do t'i nënshtrohej përsëri. Unë e shihja me trishtim, por çuditërisht ajo s'e prishi gjakun. Vetëm nënqeshte dhe bënte një 'ncuk' të herë pas hershëm, derisa arriti e më tha: budallaqe, as unë nuk kam ndërmend të plakem këtu. Halla sikur ka rënë në gjurmë të bashkëshortit tim!...

Përplasa duart nga habia dhe e shtyva me shpatull në mosbesim.

- Mos u tall!

- Për kokën tënde! - m'u betua.

Shkëlqente e tëra, dukej në qejf dhe u ngrit në këmbë e nisi të merrete poza prej modelisteje, herë duke vendosur duart në bel e herë duke i lidhur pëllëmbët pas qafës mjellmore.

- A mbahem akoma? - queshte.

Dukej hyjnore. Ishte edhe 18 vjeç edhe 28... Sikur të spërkasin me freski, i kisha thënë një herë, je si ato zarzavatet që i lagin me ujë fshatarët, për t'u dukur deri në darkë si të porsakëputura në kopësht.

- Je në formë të shkëlqyer! - e sigurova. - Po t'u tek të shkosh e të punosh në teatër, i le aktoret pa punë...

- Edhe ajo më duhet, - u shkri, - t'i kem armike edhe ato vajza që të nxjerrin bojën pa iu bërë gjë...

Pastaj kukurisi.

- Nga ato aktoret, zot na ruaj! Në vend që aktorja t'i thotë heroinës batutën e radhës, 'ah, Maro Mokra, Maro Mokra, e fortë je, për besë...!', do hiqet sikur do shqiptojë një lapsus fatal, kur të ulurijë sikur i ka dalë një mi para këmbëve: 'Ah, Ana Lika, Ana Lika, më je ndarë edhe nga i fejuari, le pa le!... Fund me nder, pastaj, ta paguash litarin dhe plumbin me flori në dorë!

Ha-ha, queshte me të madhe. Moskokëçarja e bën njeriun të fortë e të bukur. Ajo ashtu ishte. Të trembte.

Atë natë, megjithë teoritë që ekzistojnë për gjatësitë disa sekondëshe të ëndrrës më seriale, kam parë gjërë e gjatë një ëndërr jo si film, por si roman epope. Pashë hollësisht sikur u martuam të dyja bashkë në një kohë e në një vend. Kishte dalë i gjithë qyteti në të dy anët e rrugës ku ne kalonim dhe na hidhnin lule mbi supe e taksi. Vetëm ftyra e burrit të saj nuk më mbeti e fiksuar. Ishte pas një mali me lule, ishte një masë e zezë, si një tavë me byrek të zhuritur dhe, ndoshta pikërisht pse ai njeri aq i dëshirues-hëm m'u bë i padeshifrueshëm me gjithë torturën time për ta dalluar, u zgjova me një gojë të hidhur prej ulçerozeje. S'e merrja dot vesh se ç'pjesë e trupit më dhimbte e prej nga më derdhej ai helm, që më hidhëronte të gjithën.

7

Kjo lumturi e afroi dhe e ktheu të përvjavshëm Ilirin në apartamentin tonë, e bëri tip periodik. Ana, me ta parë në derë, ia tundte dorën normalisht, pa asnje ceremoni, siç veprohet me një njeri të shtëpisë, dhe kthehej nga unë:

- Erdhi gazeta 'Drita'!

Në të vërtetë Iliri ishte një biçim gazete, sepse nga ai do të mësonim të rejtat kryeqytetase të mesjavës, koncertet më interesante dhe paradat e modës në hollet e operës, aksidentet dhe ndonjë lindje a vdekje të çuditshme, siç ishte për shembull lindja e atij djalit nga provinca me peshë diçka rrëth 10 kilogramëve, apo vdekja e atij pacientit, të cilit mjeku i hoqi gabimisht veshkën e vetme, pa e ditur se pacienti i shkretë jetonte prej vitesh me një veshkë të vetme, e kështu me rradhë. Qëllonte të vinte në mesjavë të qeta, me ditë monotone, të zbrazta nga lajmet. Atëherë ngrinte supet dhe thoshte:

- Ky numur ka dalë i dobët. Janë mbyllur arkivat...
- Kaq i vlerësoni arkivat? - e pyeti një ditë Ana, duke u tallur, ç'ka dukej që në shumësin e përdorur.

Ai buzëqeshi hidhur.

- Unë jam që e gjithë Shqipëria të shpallet arkiv, - tha ngadalë, - dhe ky arkiv të hapet mbas 100 vjetësh, kur as ne e as fëmijët tanë mos jenë gjallë, ndryshe, keq e kemi! Më dendur se fjalën 'bukë' do përdorim atë të tmerrshmen, 'hakmarrje'! Edhe ti, për shembull, - përfundoi pa ia ndarë sytë e ftohtë Anës, - je e gatshme të lash ca hesape në mënyrë kanibaleske... Po të lanë, natyrish!

- Natyrish! - përsëriti në mënyrë monotone Ana.

Dhe që të dy nuk i zunë më në gojë arkivat nga ajo pasdite. Ana rrinte diçka me ne, sa për të kaluar rradhën e pér të mos u treguar e paedukatë, pastaj merrte një libër e kyçej në dhomë. Megjithatë, Iliri nuk fjeti kurrë në atë apartament. Kur më tha njëherë se s'duhej ta linim Anën gjatë andej në dhomë, se mund të mërzitez, e unë iu përgjigja mos e vinte ujin në zjarr, se ajo lexonte, ai ma ktheu buzagaz se i bëhej qejfi që ne po ndikonim kështu në kulturimin e mëtejshëm të Anës, por s'duhej harruar edhe ajo tjetra, që leximi i gjatë e pa ndërprerje të prish sytë, prandaj... Dhe çohej e ikte.

Ai njeri dukej praktik, i fortë, megjithëse dhëmbët i kishte të prishur dhe kjo më bënte të dyshoja në përfundimin e mësipërm. Në fakt, një njeri që mezi e detyrova pas njëqind lutjesh të shkonte te stomatologu e të rregullonte dhëmbët e veta, s'mund të shihte në fokus vetëm hallet personale. Atë natë që unë desha ta mbaja në apartament dhe ai iku e kuptova se i dashuri im më shumë mundohej mos t'iu bënte keq të tjerëve. Të paktën, fitova diçka me vlerë të qëndrueshme, mendova tek po e përcillja nëpër shkallë, duke menduar se do ta kisha shok të përjetshëm jete.

8

Pastaj erdhi ai telefon i hallës. Jo lajmëthirrje, si zakonisht, por një kërkim urgjent në numrin e fqinjitet tonë. E kërkonte menjëherë në Tiranë. Hipi trenit, unë po dal të tè pres në stacion, e urdhëroi që andej fillit halla dhe Ana iu përgjigj si ushtar shembullor 'po nisem', uli receptorin në fole e më tha mua tè hidhesha një vrap deri në ambulancë, mbasë i rregulloja një tre ditsh pushim mjeku.

- Nuk fejohen njerëzit me raport mjeku! - qesha unë.
- E ke gabim, - qeshi, - ne jemi në Evropë, dreqi ta hajë!... Me atë tè parin prandaj u ndava, se nuk dëgjova mjekun!...

Pastaj u bë serioze.

- Sikur ta kem tè sigurt se fejohem, - tha, - as po e çaj më kokën për raportin!

Shkova si e çartur në ambulancë, e gjeta raportin për një dhembje enigmatike shpine te një shoqja ime kirurge, që më ndoqi deri poshtë shkallëve duke më porositur 'urinon gjak, ëë, se më fike! Ku i dihet ndonjë kontrolli...' dhe shpërtheva derën e apartamentit si furtunë e hyra me raport në dorë në kuzhinë.

- Tre dite! Ke dhimbje mesi, urinon gjak, me një burrë tè mirë që nuk tè di diagnozën!...

Mirëpo s'qe më ajo krijesë me humor e qejf e dhjetë minutave më parë. Qe tjetërsuar. Ishtë bërë si me magji shushkë. Vinte vëdallë kot. Merrte tè rregullonte ndonjë gjë dhe e prishte fare. Derisa u ngrit e filloi tè përgatitej, ishte e kotë t'i flisje, sepse nuk tè përgjigjej dot. Thashë një herë ta le tè qetë e mos ta ngas, por ndërrova mendje tek

e pashë aq të vrarë e të frikur. Mora një rrip të bardhë, i shkova pas, ia kalova në ballë dhe ia lidha me kujdes.

- Ç'bën? - më pyeti.

- Të të shoh pak? - i thashë duke e kthyer nga vetja ime.

Ajo u kthye. Rripi i qëndronte për mrekulli, por sytë i kishte të përlotura.

- Fillove? - e pyeta duke e përqafuar.

- Jo, - ma ktheu, - vetëm se më shkoi mendja tek ai tipi...

Po sikur të jetë ndonjë shëmtaraq?... Me një fjalë, unë tani jam e mbaruar, pa të drejtë vote e vetoje?

- Ç'prallis! - i thashë. - Mirë e kishte Iliri, nuk duhej të të lija të lexoje gjatë...

Ajo s'ia vari humorit tim. Atëhere mblođha mendjen në alarm dhe iu ula përballë. I trembesha mendjeshkrepjes së saj në çastin e fundit për ta anulluar nisjen në Tiranë, çka do shkelte e do shembte gjithçka. Ndërsa ajo duhej të shkonte, urgjent, bile! Ka shumë gjëra që njeriu nuk duhet t'i bëjë, por që i dalin për mirë kur nuk i kundërshton. Pse ta flasim fjalën e fundit në fillim? A jemi për investime, dreqi ta marrë? Kush qenka ai që fiton pa investuar filimisht? Nuk do ta hante Anën ajo e parë kalimthi me një mashkull të panjohur e as litar në fyt, o prano o s'ka, nuk do t'i vinte njeri. Ajo nuk do të humbte asgjë po të udhëtonte, siç i premtoi hallës në telefon, dhe unë e sulmova fare copë:

- Ti, Ana, sivjet mbush 29 vjeç. Me dashuri është e vështirë të martohesh, jo vetëm se këtej është zor të gjesh ndonjë beqar mbi këtë moshë, po s'gjen as moshatarin tënd. Të gjithë studentët që emërohen në qytetin tonë nuk të rrinë më shumë se tre-katër vjet dhe transferohen në rrethet ku banojnë me prindërit, kështu që asnjë nuk arrin të festojë 29 vjetorin këtu. Teorikisht, për të gjetur bashkëshortin me dashuri, ti duhet t'i biesh Shqipërisë kryq e tërthor më këmbë. E bën dot këtë? Jo! Po beqare, ama, s'ke pse ngrysesh! Rrethanat e tua jetësore të çojnë normalisht te njojja me ndërmjetës dhe në këtë mes nuk ka kurrfarë anakronizmi e tragedizmi. Pastaj, ti do ta njoftesh kandida-

tin e nuk do të shkosh derr në thes...

- Më duket vetja e poshtër, - ma ktheu pas një pauze jo fort të shkurtër.

- Nuk je e para! - ia preva.

- E qartë! - tha dhe zgjati dorën e më kapi lehtë në gju. Pastaj ndolli hundët duke myllur sytë. Ç'ëndërronte në atë perde të zezë që nderi brenda qepallave? Ndoshta filmi pati fund të lumtur, sepse hapi sytë e tha:

- Jam vërtet budallaçkë! Ndonjëherë më ngatërrohet mendja për hiç gjë...

U ngrit të përfundonte tualetin e të bëhej gati për nisjen historike drejt stacionit dhe, me të hypur në tren, unë i futa një kokërr hudhër në xhep.

- Fat! - i thashë me ton urdhërues.

Ajo qeshi.

- Më e bukurja do të jetë sikur halla të ketë ndonjë hall të vetin, për shembull, mos do të shikojë ajo ndonjë burrë për vete - kukurisi, - atëherë fillon tamam komedija!

- Hap sytë, - i thirra unë kur u nis treni, - se halla vuan nga tensioni dhe mos kërkon të ta hajë hudhrën!

- Nuk është aq egoiste! - thirri ajo.-Megjithëse ç'farë s'pret nga shqipëtarët.-qeshi.

Pastaj treni e shtoi shpejtësinë dhe koka e saj e humbi diçka formen e u zhduk brenda dritares me ca xame si të palara.

9

Pas dy ditësh unë ia ndjeva hapat që në korridorin e shkallëve dhe e trokitura e saj më kapi kur vrapova t'ia hapja derën. Ishte po ajo e para, pa asnjë ndryshim, si ato portretet e përjetshme të të vdekurve në maskën e allçiut të hedhur fill pasi i ikuri i ka lënë shëndenë kësaj bote. Flaku çantën në tavolinën e vogël, pastaj u lëshua si thes në kolltuk. Nuk gjaje as gëzim, as dëshpërim tek ajo, as lodhje, as prehje. I hodhi një sy tavolinës së madhe ashtu siç ishte, e shtrirë sa gjerë gjatë shkujdeshëm në kolltuk dhe vuri buzën në gaz.

- Do ta festojmë?

- Fol! - i thashë. - Na plase!

Po rrija zemërngrirë, si kallëp akulli ishte bërë, e përcaktoi më pas ajo pamjen e ankthshme që kisha marrë.

U ngrit e u rregullua në kolltuk. U bë serioze.

- Kardiolog! - tha. - Në spitalin e Tiranës, simpatik, më i zgjuar se unë. Mund të shtoj gjithashtu: Figurë e njohur aq, sa pacientët ia kanë hequr të drejtën të paguajë në lokale. Profesionist në zanat. E shihte qetësish kamarieren kur i thoshte: 'doktor, janë të paguara!'. Hante dhe s'liste. Sa për dijeni, dinte të hante!

Tip kompjuteri, i serviri të dhënat me një rregull indiferent.

- Nuk tallesh?

- Për kokën tënde!

- Kot u drejtova te dashuria! - thashë me pikëllim paksa komik. - Sakrifica të kota! Mëshihu rrënzave me një të puthur në xhep...

Ajo u ngrit dhe më puthi. Por ose qe tepër e lodhur, ose nuk ishte e lumtur. Po bëja tre vjet me të në një apartament dhe nuk e ndjeva njëherë të këndonte, kurse zërin e kishte të ngrohtë dhe vetë më tha diku në një bisedë se në moshë të njomë shihte ëndrra se do të bëhej këngëtare me nam. Por u ftoh me ëndrrën e saj, apo i hyri tmerri nga torturat që pësoi në një Dekadë Maji, ku ajo do këndonte me grupin e Pallatit të pionierëve. E mbajtën tetë orë qiri më këmbë në prapaskenë. Dhe nuk shkeli më në Pallatin e pionierëve. Atë natë u betova se do ta bëja të këndonte. Zbulova se ruaja të paprekur një dell kllouni brenda vetes dhe kulmi i euforisë sime arriti kur deklarova:

- I duruari, i fituari!

Qeshi më në fund tamam, me gjithë shpirt, siç e lëshonte zërin rrallë herë. Atë natë e cyta parreshtur të pinte verë, derisa u turbullua diçka. Atëherë më tha duke futur gishërinjtë e saj të gjatë nëpër ricat e flokëve:

- Gëzohem vetëm që do të bëhem nënë! Do lind një vajzë dhe një djale! Jo, nuk dua! Në asnjë mënyrë!... Nuk besoj të më prishet trupi, ëë?... Djalin do ta vesh me rrobe të bardha, le të bëhet pis!... Do ta bëj si veten, më të bukur, ke për të parë! Do mbaj gjatë barrës mollë të mëdha përrpara! Del fëmija i bukur, thonë...

Nuk duroja dot më! Më hynin fjalitë në kokë si freza e dentistit drejt e në nervin e pangordhur të dhembit.

- Mos ma prish, - iu luta, - këndo një këngë!

- Ehu, i kam harruar! - tha.

- Një për mua e mban mend! - këmbëngula.

Më pa njëherë, duket iu prish mendja, se filloj të mendohje me ç'këngë të ma plotësonte tekën, pastaj papritur i gurgulloj zëri: 'Ti, moj vajzë, që rri te porta, mos dëgjo se ç'thonë bota!...' E këndoi me gjithë shpirt deri në fund.

Dhe unë u pendova në çast për kokëshkrepjen ta bëja të këndonte! Ajo e mbaroi këngën dhe tha gjithashtu edhe mendimin që po më rrullohej mua në kokë. Tha pikërisht:

- Kjo këngë sikur është bërë për mua!

S'bëhej dot lojë fjalësh. Nga pozita e vështirë të nxjerr faqebardhë filozofia.

- Sepse jeton problemi, jeton dhe kënga, - ia nisa unë. - Sot këndohet gjithmonë e më pak, si duket fenomeni po reduktohet... A nuk të tingëllon edhe ty si diçka arkaike?

- Jo! - ma ktheu shkurt.

Unë thashë me vete: si duket është koha kur filozofia nuk pi ujë! Tani, t'i lutem mëmës natyrë mos prishet darka, të paktën!

IO

Pas asaj mbrëmjeje ne filluam t'i bënim bashkë udhëtimet për në Tiranë. Ngrnim shtëpinë të premten, e bënim xixë, pastaj dushin e gjatë dhe të shtunën niseshim për te të dashurit, siç më pëlqente të thosha unë. Anës po i hynte tamam në zemër kardiologu; ai nuk dilte gjithmonë në stacion. Njëherë u zhduk nga dy javë në një Konferencë Ndërkombëtare, njëherë qëllonte roje, pa harruar urgjencat, por ato dy-tre herë që e pashë figurën e tij elegante në sheshin para stacionit i dhashë Anës të drejtë. Ajo ndahej nga unë dhe nisej drejt tij. Kardiologu nuk e priste pa lëvizur nga vendi atje në skajin e tij, por nisej në çast ta shkurtonte rrugën e takimit. Mua më pëlqente respekti i tij për Anën dhe më dukej se ata do të përqafoheshin natyrshëm e dora e tij do të vendosej ngadalë në flokët e saj, si dora e Salvadore. Veçse qenkësh e vështirë të bëhet njeriu Salvadore! Që t'i përvendetësh njerëzit ‘mirëmëngjes’ e ‘mirëmbërma’, t'i pyesësh ‘si u gdhité’ e ‘keni ndonjë hall’, që t'i përqafosh pa epsh dhe që t'ia vesh shoqes dorën plot delikatesë te flokët, ashtu siç preket foshnja e porsalindur, ehu, duhet kulturë! Jo nga ajo e librave, por nga ajo e qumështit dhe e përrallave të nënës. Kështu nuk mendoj vetëm unë, se edhe një kamarier te hotel ‘Tirana’, kur një klient e thirri si vandal në mes të lokalit e i çuditit të gjithë të pranishmit atje, na tha mua dhe Ilirit me qetësine më të madhe: ‘Ky nuk duhet të ketë pirë qumësht gjiri. Do të jetë rritur me ushqim të përgatitur nga të pazarit!...’. Kirurgu kardiolog i mrekullueshëm e joshës, fatkeqësisht, nuk hëhej dot Salvadore. Ndoshta i qenë ftohur ndjenjat nga gjithë

ai gjak që kishte derdhur në ato therrijet e vazhdueshme makabre që u bënte zemrave njerëzore.

II

- Ç'ka ndodhur? - pyeta me të futur këmbët në prag.

Rrinin krejt të ngurosur, aq sa im atë me nënën më përngjasuan me një grup skulptural dhe do besoja se do qenë vërtet të tillë, po të kishin ca përmasa trupore nja tre-katër fish më të mëdha, si të atyre monumenteve që peshonin tonelata e që sikur na qe mësuar syri me to. Në guzhinë ishte ndezur drita dhe terri ua shtonte monumenteve pikëllimin... Grup skulptural qenë, se pyetja ime ra në shurdhëri. U përplas qorrazi nëpër muret e patinuar, mbasë edhe krisi ndonjë suva, megjithatë veshë për ta dëgjuar pyetjen e alarmtë 'ç'ka ndodhur' nuk u hapën. Vëllai nuk gjendej dhe papritur m'u bë e qartë si drita e diellit se në këtë shtëpi apo kishte trokitur vdekja. Një telegram... Firmosni pak poshtë, ju lutem!... Të rroni vetë!... M'u mblodhën lotët. Kë të qaj më parë, pyeste ai vargu i këngës popullore. As unë nuk dija për cilin njeri të gjakut tim duhej të qaja. Vëllai me siguri është vërsulur si i çartur jashtë të përhapë vakinë, mendova, dhe m'u drodh zemra më keq akoma nga kujtimi i kobshëm i Esmeraldës, shoqë sime të gjimnazit, që e shtypi një kamion në kryqëzimin e '21 dhjetorit' kur ishte nisur të shpërndante ftesat për martesën e vëllait... Ku nuk i shkon mendja njeriut kur ndodhet përballë vdekjes! Kurse unë pak çaste më parë, pa parandjerë asgjë, a thua kisha një gen idioteje të zhvilluar këndshëm, ndjehesha aq e gëzuar nëpër shkallë, kur ëndërrroja martesën e bujshme me Ilirin, ç'muaj do zgjidhja përmuajin e mjaltit...

- Ku ishe ti? - e ngriti befas zërin im atë.

Ngrita supet. Pyetja ishte e çuditshme.

- Si ku ishe?

- Ku ishe? - uluriu. - Ku bredh?

E kuptova menjëherë e kthjelluar tërësisht nga kjo rrjedhje e vrullshme dialogjesh se vdekja paskësh emrin tim. Megjithatë, ndoshta e varur te shpresa e sqarimit të një keqkuptimi fare banal, m'u duk aq absurde ajo ulurimë. Nuk mund ta kuptoja pse prindi duhej të cirrej në atë farë feje, se dikush apo ai vetë na paska parë vajzën e tij 25 vjeç të hajë me një mashkull një akullore. Dhe u përpoqa të buzëqesh, për të zbutur gjendjen e tensionuar e për t'i thënë babait: e shkele pak, por unë, megjithatë, ta fal!...

- Kujt i zgërdhish? Ku ishe? - uluriu prapë dhe unë atëherë e kuptova se zëri i tiranit ishte mrekullisht në formë e i zotëronte të gjitha oktavat, si dikur, a thua ishte incizuar me pastërti shembulllore e konservuar përfjetësisht në një disk të klasit të parë. Mbusheshin tre vjet e ca muaj që unë isha ç'ambientuar me atë zë dhe dalëngadalë veshët e mijë ishin dyllosur e trupi e pati rifituar vertikalitetin, aq sa ca kolegëve të tim eti në çështje tiranije e diktati kisha filluar t'i dukesha 'mendjemadhe' dhe 'firifiu'.

- Tani u ktheva! - thashë ftohtë.

Atëherë u hodh nëna dhe tha të vetmen fjali që i mbaj mend në atë budallallëk me brirë:

- Treni ka tre orë që ka mbërritur, ne pyetëm me telefon në stacionin e udhëtarëve...

- Ju keni kohë që nuk udhëtoni me trena, po nuk ka tren aktualisht që të mbërrrijë pa dy orë vonesë në stacion, bille është lumturi kur arrin të mbërrrijë brenda ditës që është nisur nga rrethi tjetër...

Ndërsa me vete thashë: Ana, çdo fytyrë individuale ka një përsëritje homologe në botë. Por që ka edhe jetë homologe, nuk e dija!... Unë paskam qenë homologia jote, kopja, më e keqe se originali, ajo që nuk i hyn më në xhep askujt...

U bëra pak tragjike vërtet, por kaosi më çoi atje. Më dukej se do t'i fyeja prindërit e mi të dashur me hollësitë

që do t'u tregoja, por, mjerisht, qaja një hall fare të vockël, duke harruar se im atë i kishte veçmas për zemër goditjet e mëdha... U bëra gati t'u thosha: Hëngra akullore me një shok që ka dëshirë të shoqërohet me mua! Kaq!

Më hypi një tërbim i madh. M'u mblodh gjithë urrejtja ime për atë tiran, që më ka shoqëruar si hije e trupit gjatë gjithë jetës... Inxhiniere, ti? Lëri llafet! Do shkosh në anglisht!...

Shkova në anglisht.

Ke qejf të bëhesh mësuese?! Për të fituar dyzet ditë pushime?! Ti do bëhesh shoqëruese e turistëve! E perfek-sionon edhe gjuhën...

Fillova punë në shoqërinë turistike.

Tani: do martohesh ti me atë kastravec?! Po ç'të duhen këto telashe ty? Mos m'u shqetëso, ta kam gjetur unë një burrë ideal!?

Mjaft, uluriva me vete, nuk dorëzohem më! Mezi isha bërë njeri, tani, ja!

- Kjo vonesë ju ka shqetësuar kaq shumë? - i pyeta me një zë të akullt dhe me një inat me veten time, nga që nuk ma mbante ta shihja në sy babain.

- Kkuuuu iiisheeeee!

Këtë herë britma doli e llahtarshme, përngjau me ato majekrahet e konkursit të rapsodëve dhe e kaloi në çast nënën në kampim tim.

Uluriu tamam tirani, si vrasës. Uluriu në atë farë feje, që e bënte tjetrin grusht dhe të gatshëm të qarravitej e të binte ndër gjunjë hundë e buzë, duke belbëzuar me ngut: Urdhëroni, merreni fatin tim dhe përcaktojeni, se unë jam budallaqe dhe do ta marr veten në qafë!...

- Aman! - iu lut nëna. - Ul zërin se u bëmë për turp! Po na dëgjon gjithë lagjia!

Ai i hodhi një vështrim të tërbuar nënës, nga ato vështrimë që kanë lindur shprehjen idiomatike 'e pa, sikur do ta hante të gjallë' dhe unë u tmerrova. M'u duk si Lekua, ai krimineli i metë që kisha pasur nja dy vjet në një klasë në gjimnaz, derisa ngeli përfundimisht. Ai e hëngri atëherë

harabelin me gjithë pupla në klasë për një bast prej 10 lekësh të reja dhe bëri vetëm një pyetje, kur ia servirën kushtin: 'Me gjithë sqep ta ha, apo pa sqep?' Edhe im atë ashtu e pa nënën, aq sa unë s'do çuditesha po t'i thoshte egërsisht: 'hajde, këputi komçat, se do të të ha me gjithë lecka, kurse komçat nuk t'i tres dot!' Në fakt diçka me përbajtje të tillë, kanibaleske, tha kur riuluriu:

- Le të dëgjojë lagjia! Kjo atë qejf ka, të na bëjë ne skenë estrade, se e lagjes është, e botës, nuk është vajza jonë, derisa bredh e nuk na ve në refene!...

Mua, nga tensioni i madh nervor dhe pafuqia për t'ia mbyllur gojën e për ta sqaruar, më shpërthyen lotët. Kurrë, as në ato fantazirat e mijë teorike, ku kisha shetitur me kuaj race, kisha pirë çaj me ledi Dajanën e pata fituar Oskar-in si aktorja më e mirë femër e vitit nuk e kisha imagjinuar se mund të zhvillohej një dialog i tillë absurd, brutal. Kur më tregonte ndonjëherë Ana për skenat e zhvilluara në familjen e saj atëherë, në ditët e ferrit, që ishin pak a shumë analoge me tmerrin tim, thellë vetes i bëja skonto atyre rrëfimeve. Mendoja se në tregimet e saj dëshira për t'u bërë e besueshme fuste nga pak edhe hiperbolën e ekzagjerimin. Por isha nxituar. Të vërtetëtë njériu e thoka të fundit, pra, të bie rasti ta dëgjosh shumë rrallë. Dhe e vërteta kësosoj tingëllon gati gjithmonë si një histori e trilluar paks. U përlota edhe sepse vetëtimthi i kujtova vetes se e dashuroja Ilirin, dhe s'pata hyrë në bataqe epshi me të, vetëm nga respekti që kisha për prindërit e mi, nga dëshira për të mos ua prishur askund qejfin atyre në këtë punë.

- Isha me një shok, - fola mes ngashërimeve, e fyteri deri në palcë që prapë se prapë u ktheva ta ajo gungaçja frikake që jepte llogari për gjithçka. - Dhe nuk jam rrugacë! Nuk kuptoj ç'iu bëra, xhanëm?

Po kë të prekja me lotët dhe fjalët e mia? Padreja sikur kishte punuar një jetë të tërë infermier në morg!

- Ke bërë kurvërira! - uluriu.

- Jo! - thirra.

- Ke bërë! Je mbyllur në shtëpinë e asaj qelbësirës dhe

ke bërë ç'të ka dashur qejfi! Po unë do ta diskreditoj atë deri atje ku s'ia pret mendja! Në Komitet Partie, në...

Deshalbe shaj 'shpifës', por në gjithë atë pështjellim përsëri nuk ma mbajti ta shaja. Vetëm uluriva për hesap tim:

- Kush ju tha se është ashtu!! Unë nuk jam mbyllur... Ajo është e mirë!... Ju nuk do të ankoheni për atë...

Ah, po! Nëna foli edhe një fjali, atë që më vrapë përfundimisht, kur tundi kokën pikëllueshëm dhe tha ngadalë:

- I pamë të mirat e asaj! Pastaj ti vetë e ke thënë se është ashtu!

Shtanga. Lotët më rridhnin.

- Unë?!

- Ti! Nuk i ke thënë Meritës? Ne shkuam me tët atë dhe jot kushërirë na sqaroi...

- Jo, jo! - bërtita çmendurisht. - Atëherë nuk e njihja fare! Nuk e njihja fare!... Ajo... Unë...

Më gjëmoi gjaku në kokë, m'u ngrit një zhurmë e tmerrshme. M'u zbeh gjithçka para syve. Një dhembje e llahtarshme më rrëmbeu prapa kokës dhe ma shkëputi duket lidhjen me fjalët, sepse u bëra gagaçë, megjithëse më kujtohet shumë mirë se po i kërkoja fjalët me ankth, nga tmerri mos nuk do të arrija të flisja më kurrë. Ah, ky egoizmi i vockël. Nuk ia venë veshin kokës që po të ikën me gjithë fjalë e sy e vesh e vrima hunde, por llahtarohesh se nuk do flasësh më!... U ngrita si e droguar, shkova, as vetë nuk e di se si e bëra këtë, në dhomën time dhe u plasa mbi krevat. Nuk dëgjoja më asgjë, kurrrfarë gjëje, vetëm një qysqi sikur më shkallmonte kafkën dhe nëpër zgavrat që hapeshin, ku hynte ajo fjalia mizerabël e sakate 'dava prostitute!'. Nuk qaja, por qëndroja me pamje mehitit, siç më tha më vonë nëna, me sytë në tavan. Kush e di ç'transformime do kishte pësuar fytyra ime brenda pak çastesh, që nuk më ngacmoi më askush. Turbull pastaj dëgjove nënën që cirrej:

- Po më ikën vajza!...

Nuk merrja më vesh asgjë se ç'ndodhë përreth meje. Hapeshin ca dyer dhe mbylleshin apo mua më zbehej dhe

forcohej pamja si me një relé të brendshme? Ta zemë se qenë dyer, po ku ishin ato? Në kokën time? Të shtëpisë sime? Apo qenë dyer spitali? Më vonë mora vesh se isha fiksuar gjashtëmbëdhjetë ditë të mira në shtrat, po t'i numurosh si ditë udhëtimi, edhe me gjysma ditësh, numurim që duhet ta ketë bërë xhaxhai im, ai që i ka rënë qark gjithë botës e ka shkuar deri në Burkina Faso, sa do ta kishte zili edhe vetë Kristofor Kolombi, dhe që përsëri ka mbetur një shkresan i pandreqshëm, lakmues i parasë. Ai pati futur xixat i pari, kur i pati thënë babait se njihet një djalë, nip milioneri andej nga Korça, të vetëm ,me gjysh në Amerikë, që... Deshte të më dhuronte dhe klimë malore, veç milionave, le pa le! Nejse, më vonë mësova se më patën mëkuar si foshnje në shtrat me supëra të shtypura në rende e se më kishin larë e pastruar po aty si fëmijë të vdekur, sa iu kishte ardhur shpirti në majë të hundës. Si é vdekur... Si foshnje... Merre si ta marrësh, të dyja metamorfozat qenë të rënda përmua. Nuk dëshiroja të më fliste askush. Kurkujt nuk desha t'ia dëgjoja zërin. Vetëm njëherë iu luta ftohtësisht nënës, se asaj nuk ia falja atë kunjin që më luajti mendsh, të gjente Ilirin dhe ai erdhi të hënën e parë. Filloj të tallej me nënën time, sa herë më drejtohej mua, pastaj qërrroi zërin e tha:

- Do të ishte ideale sikur të të kërkoja dorën përmartuar bashkë në krevatin e spitalit!

Qesha!

- Dhe në vend të dhuratave simbolike, siç quhen unaza, ora etj., të të sjell përmishane një kamion me ilaçe!

Nëna sa nuk shpoi tavanin. Sëmundja ime e trembi përvdekje atë jo thjesht nga shqetësimi i natyrshëm prindëror, kishte frikë mos Iliri gjente shkakun përmëtë prishur lidhjen me mua. Më pas, kur unë ia përplasa në sy se pse i pati hyrë data atëherë që u sëmura, ajo u përtyp e ma ktheu se sot nuk duhet t'i zesh besë as hijes së trupit tënd. Ajo ka fatkeqësinë e madhe që nuk rrezikon dhe, pa investuar, është një ekonomi e mbetur në vend në rrënim gradual. I gjykonte njerëzit me psikologjinë e rinisë së saj të hershme,

kohë që Iliri e cilësonte ‘koha e qepës’.

- Ajo është për bukurin, - kërceu nëna e cytur nga psikologjia e kohës së qepës, - koka i dhembti një çikë, siç iu dhemb gjithë dynjasë, po ne vumë alarmin se nuk jemi mësuar të na zerë krevatin çupa. Ja, hera e parë...

Iliri më shkeli syrin.

- Bëra shaka, - i tha, - koka nuk është gjë! Sikur t'i dhimbte ndonjë gisht i këmbës ndryshonte puna. I vogli, për shembull, sepse nuk do të vishte dot këpucën!...

M'u shpif e qeshura dhe për herë të parë qesha me gjithë shpirt pas aq ditëve gjysmë e vdekur e gjysmë e droguar nga ilaçet, që vinin në gjumë pa frikë edhe një stallë kuajsh. Më kaloi gjithçka vërtet. Paskësh qenë vetëm një ëndërr e keqe ajo sëmundje. Dolëm që atë pasdite bashkë me Ilirin dhe një muaj më pas u fejuam pa rradhë, në lokalin e celebimeve pas Muzeut Kombëtar, ku duhej të regjistroje emrat nga një muaj më parë e të prisje pastaj të të vinte rradha. Mbaj mend se morëm si dëshmitarë dy kamarierë të lokalit ngjitur dhe që nuk na shngjiteshin llokumet për t'ua shpérndarë celebritesve dhe dëshmitarëve tanë. Pastaj Iliri bëri pak llafe me atë burrin që na pyeti si hetues: ‘e doni njëri-tjetrin?’. Sherrin e shkaktoi Iliri që nuk u përgjigj ‘po’, por ‘vdes’.

- Nuk më duhet vdekja mua! - e ngriti zërin ai burri havdall. - Ti daç vdis për të, daç vdis atë! Mua më duhet ‘po’ apo ‘jo’!

Iliri filloi të shante rregulloret strikte që nuk njihnin sinonimet dhe ngjyrimet emocionale, pastaj u detyrua të thotë ‘po’ nga vështrimi im përgjérues, ndërkohë që burri llomotiste ‘vdes! Punë e madhe! Dhallë pa kripë! Po! Celebrohu! Kjo më duhet mua që ta hap regjistrin!...’.

Më erdhi oreksi dhe humori. Vetëm me babain përpinqesha të kryqëzohesha sa më pak. Ai ishte prerë dhe kishte rifilluar duhanin, që ia hëngri përfundimisht dhe kokën, siç thotë tani nëna. Në fakt, ai i hëngri kokën vetes dhe e ndjeu veten papritur dhe pakujtuar të braktisur nga të gjithë. E kuptoi se ne nuk e llogarisnim më dhe kjo ia tregoi

qartë se atij burri i kishte vdekur vitaliteti i parë. Duket nuk deshte të jetonte më ashtu, i papërfillur dhe i pafuqishëm, dhe i thirri të gjitha sëmundjet. Ato ia bënë qejfin. Kështu mbaroi ai, i mbaruar. Kur e varrosëm, binte shi me gjyma. Mua Iliri nuk ma tha me gojë, ama e ndjeva se edhe ai mendonte si dhe unë që mbi babanë ne nuk hodhëm dhë mbi varr, por baltë. Tek e fundit, ky ishte vullneti i natyrës. Baltë meritonte, sipas saj, baltë i hodhi!

Ai njeri në tretje arriti t'i mbledhë forcat e fundit duke thirrur gjithë ndërgjegjen e mbetur në trup dhe antikorpet ku i kishte dhe ku s'i kishte dhe kërkoi falje me një zë të tjeteruar. Më preku, sepse edhe unë kam ca mikrobe budallallëku në trup, që na bën të harrojmë e të falim, a thua nuk bëhet fjalë për një hapje grope varri, por për 10 qindarka, megjithatë, nuk arriti të më qetësonte. Mua më interesonte tjetër gjë: a do t'i falte Ana prindërit e mi e bashkë me ta edhe mua? Kjo pyetje ma merrte shpirtin, më torturonte, më linte natën pa gjumë. Kam folur ato kohë netë të tëra me Anën. I jam shfajësuar në dhjetëra variante. I lutesha të më falte, i tregoja me fjalë e vepra se e doja. Ajo gjithmonë më falte në fund. Dhe vetëm atëherë më zinte gjumi. Por, ama, qëndrimit real në një apartament me të, i trembesha për vdekje.

- Interesohu mos më tërheq qendra turistike këtu - iu luta babait. - Nuk shkoj dot tek Ana, nuk mundem!

Ai u bë shtatëqind copash dhe kjo ishte dhurata e fundit që më la. E rregulloi që unë të filloja punë pas përfundimit të raportit mjekësor në Tiranë dhe dendësoi duhanin. Më pas e piu shumë, aq sa, siç më thanë, edhe kufoma mbante erë duhan.

II

Po Ana erdhi vetë një pasdite për vizitë bashkë me Marien dhe me Salvadoren. Ishte hequr pak, ishte bërë më e bukur. Të gjithë rrinim si mbi gjemba. Im atë për herë të parë u tremb dhe nuk doli nga dhoma deri sa u bind që ajo jo vetëm kishte zbritur nga shkallët, por mundësish të kishte arritur te kryqëzimi përtetj. Nëna sa nuk qante me duart lidhur në prehër, Maria rrinte si dru, kurse Salvadorja nuk dinte ku t'i conte duart, aq sa do të ketë mallkuar veten që nuk e pinte duhanin. Të bënte sikur merrej me diçka, të paktën!

- Kur do të fillosh punë? - më pyeti.
- Muajin tjetër! ...

Por guxova t'i them se nuk do shkelja më kurrë në atë apartament aq të dashur për mua, në atë korridor 16 pllaka të gjatë dhe 10 të gjerë, me dyer të pavajisura, që kërcisinin kur i hapje e i mbyllje, me një dush luftarak me vajguri, që gjëmonte me tërbim kur e ndizje ...

Ra një heshtje e keqe. Unë e pyeta Marien se ç'bënte Vera, Maria m'u përgjigj se po iu nxirrte veshët. Këndonte gjithë ditën nëpër shtëpi. Salvadorja shtoi 'na çmendi', pastaj lëshoi fjalinë më të trishtuar që mund të thuhej në praninë time:

- Punë dreqi! - psherëtiu. - Prift! Bëj si them unë, mos bëj si them unë!

Ana kukurisi. Donte ta zhdukte atmosferën e keqe që mund të mbillte fjalia e fundit që shqiptoi miku ynë.

Unë i thashë Anës se që hequr pak. Ajo më tha se tani që ishte vetëm, përtonte të gatuante. Unë e pyeta duke

qeshur se si ndihej me zemrën. Ajo m'u përgjigj duke rregulluar fundin mekanikisht se ai specialisti ishte përsëri jashtë shtetit në një konferencë ndërkombe, kështu që përgjigja e analizave do të vononte pak, por nuk besonte të kishte ndonjë diagnozë serioze. Unë do ta pyesja përsëri, po s'më la Salvadorja, që kërceu në mes:

- Ti sëmurë?!
 - U plakëm, Salvadore! - qeshi Ana. - Filluam të ankohermi, nuk po na ndahen therjet ...
- Ai bëri shpërfillshëm me dorë.
- Nuk plaket dhe Maria ime si ty! Le t'i thonë plakë, nuk bën zë Salvadorja! ...

Ne qeshëm, pastaj ata ikën, kurse im atë e zuri më fuqimisht krevatin. Nga ajo heqje e menjëhershme e Anës mua më rifilloi dhembja e kokës. Kisha një masë që më shtypte nga pas në trurin e vogël dhe nuk ndieja pikë fuqije. Ftesa më absurde më dukej kur më ftonin të haja bukë. Më dukej sikur më thoshnin:

- Hajde të hamë këmbët tonë!

Mund të rrija ditë pa ngrënë, pa më shkuar mendja te ushqimi. Përfundova në një kremastar të gjallë, asnjë fustan nuk më rrinte më në trup. Fundet rrotulloheshin tip kushtinete në belin tim dhe u çudita kur gjeta në valixhe një fund të vjetër, të cilin e pata qepur për ditëlindje kur mbusha 15 vjeç dhe nënës ia hëngrën të gjithë bakllavanë shokët e klasës sime e ajo u bë me zemër kur pa atë tepsi madhështore vetëm me ca anë ëmbëlsire. Ky fund i hershëm më rrinte vërtet pak i shkurtër, ama, në bel, tamam! Atëherë vendosa të vizitohem te mjeku. Deri në ato ditë para vizitës nuk doja ta dëgjoja as emrin e mjekut. Ai i pari më kishte zhveshur thuajse lakuriq e nuk kishte lënë vend pa më prekur, sa m'u neverit vetja, por mjeku i dytë e kuptoi gjendjen time dhe filloi të qeshte.

- Ky është profesioni! - më tha. - Në këtë shtratin tim te vizitave ti nuk je femër!

Pastaj shtoi në intimitet:

- Si je dobësuar ti, kujt i shkon mendja të përfitojë nga

rasti? Fillo të hash rregullisht, se do të të braktisë yt shoq!

Ai më vizitoi mirë e mirë dy herë në klinikë, doli disa shëtitje me mua dhe Ilirin dhe në fund, kur po pinim kafe në lokalin përballë hotel ‘Dajtit’, konkludoi qetësisht se unë kisha kaluar një depresion të fortë nervor.

- Mund të përsëritet, - më paralajmëroi, - dhe kalon në forma gati të pashërueshme, prandaj ti duhet të ndërrrosh mjedisin.

Iliri do qe zbrazur patjetër te ai!

- ... Në qoftë se ke ndonjë irritim në mjedisin familiar, martohuni sa më shpejt!

- Po ne sa u fejuam!

Ai qeshiëmbël. Të bënte budalla kur të duash!

- Martohuni një herë, pastaj, po të doni, fejhuni prapë! As rrëmuja e dasmës nuk i bën mirë, - iu kthyesh ai Ilirit, - kështu që shpëtoni edhe nga ajo zallamahi e mori shpenzimesh!

- Nuk ka të keqe pa një të mirë! - tha Iliri qetësisht.

Ai mund të bënte humor në çdo kohë. Bile edhe në çastet kur unë ndihesha shumë keq, ai gjente rastin të lëshonte ndonjë nga ato thumbat e tij. Herën e fundit, kur hyri mjeku me alarm, u përplas me Ilirin në korridor dhe e pyeti me ankth:

- Si duket?

- Mua më duket e bukur! - iu përgjigji bukuroshi im.

E çmeriti mjekun, që më gjeti mua në shtrat duke qeshur. Hajde ta besonte ai se unë po luaja mendsh!

- Jam shumë keq, doktor, - i thashë, - por po qesh me atë dialogun tuaj në korridor ...

Nejse, pas asaj bisede, ne filluam me ngut nga përgatitjet e dasmës. Ana duhet të jetë çmeritur kur e ka marrë ftesën time për darkën e dasmës, sepse të nesërmen ia behu në Tiranë dhe e mbajti vrapin tek unë.

- Si ndodhi kështu? - pyeti. - Mos je shtatzanë?

- Jo! Urdhri i mjekut! - i thashë.

- Budallalëqe! Unë nuk i besoj mjekët!

Dhe më tregoi se një herë, kur ajo ishte dobësuar, megjithë-

hë oreksin e mirë që gjëzonte, mjekët thanë në kor: kjo ka krimba në zorrë!

- Këtu u bashkuan vërtet, - qeshte ajo, - por u ndanë te lloji i krimbit. Mendo, tridhjetë mjekë thoshnin me siguri të plotë: ka këtë parazit! ... Të gjithë kishin krimbin e tyre! Doli se unë duhej të strehoja tridhjetë lloje krimbash në zorrë, gati gjithë familjen e parazitëve, aq sa koleksioni im ishte më i pasur se ai i kopshtit zoologjik të Nju Jorkut! ...

Këtë histori e ruajti për ta treguar te restorant 'Tirana', ku unë me Ilirin e ftuam për darkë. Kemi qeshur me lot, sa lamë kokrrën e namit.

- Po pastaj? - pyeti Iliri.

- Pastaj doli një mjek që më pyeti: Mos ke rënë në dashuri? Sa i lezetshëm ishte! Atëherë më pëlqente Sokoli. Ehë, ia ktheva gjoja si me turp ... Po pse s'flet, tha ai i shkreti, se na nxore bojën! Nuk ka më qenie karagoze se mjeku, kur fillon e flet me hipoteza! ... Për kokë të Emës, kështu më tha! ...

Si nuk mbaronte humor i asaj nate! Ana thoshte se vazhdonte të vizitohej te kardiologu, por vetëm me sy. Imitonte kryevepër!

- S'kenka doktor i hajrit! - tallef Iliri. - Të paktën, stetoskopin mund të ta vinte një herë!

- Ka shumë zhurmë në zemër në stinën e njohjes, - qeshi Ana. - Rrezikohet ekzaminimi i saktë!

- Pse nuk thua, - qeshte Iliri, - në kardiologji duhen ngjitur lajmërimë: 'Vizitohen vetëm njerëz që nuk dashurojnë!'. Atëherë nuk do vizitohej asnjë burrë, se do ta priste sherri në shtëpi: 'Mizerje! Domethënë, ti nuk më ke dashur asnjëherë! Ku janë ato fjalët eëmbla? Apo vetëm në krevat i thua? Të vdisje si qen dhe mos ma nxirrje mua bojën, që shkove u vizitove!' ...

Pastaj i kthehej Anës duke i shkelur syrin:

- Mbaroi edhe një partizane e martesës me dashuri!

- Mbaroi, - pohonte ajo.

Qeshte ëmbël duke e çuar deri në fund talljen:

- Jam 28 vjeç. Në kombinatin ku punoj unë, s'ka asnjë

beqar në këtë moshë të paktën, se, nga e keqja, hajde, po preferoj bashkëjetesën me moshatarët! Të marr ndonjë çunak më të vogël se veten? Atëherë emri im nga historia gojore do të kalojë në atë dokumentare ...

Qeshte me të madhe duke imituar të folmen e vjetër: Bash n'at mot qi ka nez n'qill yll i agut n'pisk dite, asht hudh i cuc me vul e gisht n'kart me punu ke drut. Kjo cuc e ardhme pri bërthame s'venit ka qenë fort e çuditshme. Ajo ka pas kenë lidh n'bes me i zotni burr t'bredh n'bot e me qese plot, sa t'han qent e micat bashk, po e ka shky besën me durt e veta pér ...

- Ha-ha! Nuk e ka ditur fjalën 'emacipim' kronikani im!
- Emancipim! - e korrigjoi Iliri. Dhe shtoi: as ti, e dashur, nuk e di fort mirë këtë term!

I2

Ndihesha shkëlqyeshëm fizikisht e shpirtërisht, aq sa nëna m'i ngulte sytë me dyshim. Mos kisha luajtur teatër me ta kur u sëmura e u thashë më pas se mjeku mendonte se shërim ishte për mua dasma? Vrapoja te rrobaqepësja e te Silva për bizhuteritë, shfletoja katalogë e nuk rreshtja së bëri inventarin e imët të dyqaneve. Kështu deri në ditën e dasmës. Pastaj u gdhi një mëngjes i mrekullueshëm me fustanin e bardhë, me lule gjithfarë ngjyrash, me blice fotoreporterësh, me njerëz, urime e të qeshura pa fund. Vetëm Ana nuk po dukej në atë mori uruesish. Më në fund, kur në po prisnim nga minuta në minutë ardhjen e taksisë që do më çonte në lokalin ku do bëja dasmën, ajo u shfaq me një tortë të madhe. Qeshte, por unë nuk mbaja mend ta kisha parë ndonjëherë aq të trishtuar. Më puthi me kujdes, që mos më prishte makiazhin, pastaj zuri vend ngjitur me mua.

- Ke dalë nuse fantastike, - më tha.- Ky fustani të trika mrekulli, sikur është qepur për trupin tënd! ...
- Dukesh e mërzitur, - i thashë.
- Jo!. Jam pak e lodhur!
- Po mua nuk ma hidhte dot.
- Ç'thonë vizitat te kardiologu?
- Keq! - tha, pas një heshtjeje të shkurtër.
- Si keq?
- Baltë fare! Duhej të dilte sot te treni ... Nuk doli ... As të shtunën tjetër nuk u duk. Thotë nëpër ca telefona se ka shumë punë aktualisht ...
- Zëri i saj ishte i thatë.

- Kushedi sa e kanë fryrë, të shkretin! - shtoi, pastaj bëri një lëvizje harkuese me dorë, prapa diellit vaftë! ...

U përpoq ta retushonte mërzinë me një buzëqeshje, por s'e njihte atë zanat. I shpërtheu një e qarë e rëndë, e papërbajtshme, dhe më pushtoi fort. M'u lag fustani nga lotët e saj. S'përbahesha dot për vete. Ajo e qarë ishte e lebetshme. As të vdekurit shpesh nuk qahen ashtu.

Njerëzit shtangën. Nëna ime më bënte ca shenja të ruaja makjazhin, mirëpo ajo s'e ruajti dot për vete tualetin e saj, se u përlot e wzhgërryer nga lotët.

- Janë si motra, - u tha njerëzve duke ndjellë hundët, - Duhen shumë! ... Ajo çupa është e pamartuar ...

Ana e dëgjoi. Fshiu lotët dhe po aq papritur u kthjellua. Por nuk pushoja dot unë. Atëherë ajo filloi të më puthte e të më lutej të pushoja, pa pyetur më për ruajtjen e tualetit tim nusëror. Ai u dreqqos nga lotët. Duhej bërë nga e para.

- Mos u mërzit, - më tha, - ai duhet të ketë pasur vërtet punë, po mua këto kohë mendja vetëm për keq më shkon ... Ti e kuption vetë ... Unë pyeta ... Do vijë, me siguri! Do të të lajmëroj vetë ...

Dhe iku.

Nuk erdhi në darkë, por ky ishte një ngushëllim i madh për mua. Asnjë arsyë s'mund ta pengonte atë të vinte në dasmën time, veç ndonjë takimi me kardiologun. Vetëm për një takim të tillë unë nuk do t'i mbaja mëri dhe ajo e dinte këtë gjë.

I3

Ana nuk u bë e gjallë. I dërgova fjalë një dy herë, por përsëri ajo nuk u duk, a thua ndodhej në skajin tjetër të globit. Më në fund vendosa të shkoja një herë te halla e saj. Se pse druhesha të trokisja vetëm në derën e asaj gruaje të mrekullueshme e fatkeqe dhe iu luta Ilirit të më shoqëronte. Pas asaj vizite më rifilloi dhimbja e fortë e kokës, dhimbja e tmerrshme e kokës, dhimbja e padurueshme e kokës, ajo, e cila dëshmonte se të paktën unë kisha kokë.

- Lëmsh! - iu përgjigj halla pyetjes sime se ç'bënte Ana.

Mjekët ma fashiten dhimbjen e kokës, po trishtimin nuk ma dogjën dot.

- Doktor, - iu luta njërit prej tyre, - le të më dhembë koka, vetëm e trishtuar nuk dua të jem. Nuk qesh dot, as flas dot! Më vjen për të qarë.

Ai ishte tip Adhamudhi.

- Mos qesh, mos folë dhe qaj! - më këshilloi.

- Rrofsh, doktor! - ia ktheva me mirësjellje. - Po marr vesh se edhe unë e paskam brenda vetes një damar mjeku ...

Ai qeshi dhe ishte pa dyshim i pari që bëri durim e arriti ta ftilloente me rrënje hallin tim dhe që ma shtiu në vesh punën e rrëfimit.

- Por mos iu rrëfe mjekut, as priftit, as bashkëshortit, apo asaj shoqes sate! - shtoi. - Rrëfeju një auditori më të gjerë, se sinqueriteti e mbyt ndjesinë e krimit!

Pastaj, kur më përçollli, më kapi për supesh.

- Edhe mua më vjen për të qarë, - më tha. - Edhe unë shqiptar jam...

I4

Unë shkruaj tani vazhdimesht. Prish ato radhë ku gënjej dhe që dëshmojnë se i kam ende ca doza mashtrimi në gjak. Zgjeroj ato faqe ku nuk jam treguar maksimalisht e sinqertë. Shkruaj dhe prish ... Dhe, teksha shkruaj, më mbushet mendja se kësaj pune unë vërtet i kam hyrë për të shpëtuar shpirtin tim, por ama edhe për t'iu vënë gishtin ca të tjerë njerëzve me pamje e jetë të rregullt, me rregullsi tejet të rregullt, që kanë, megjithatë, plot ditë kriminelësh në jetën e tyre.

Ja, Ana! Tani, m'u përgjigjni, ju lutem: pse e vramë?

1988 - 1990